



Muhamed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM XHA'FER

SADIKUT

(Paqja gotë mbi të!)

I

Titulli: Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) I

Autori: Muhamed Xhevàd Mugnijeh

Përktheu: H. Selim Stafa (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: H. Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Perkujdesja garfike: Sabrie Feza

Kapaku: Sabrie Feza

Botoi: Shoqata FLLADI

FJALA E BOTUESIT

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirplotit

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Shkenca e Jurisprudencës (Fikhu) konsiderohet prej shkencave më të rëndësishme islame. Ajo është prej shkencave më të hershme në histori dhe me përmbajtje më të gjerë dhe me degëzime më të shumta. Kjo shkencë e ka zanafillën në lindjen e Islamit. Ka vazhduar, vazhdon dhe do të vazhdojë deri në fund të kësaj jete. Përgjatë historisë së kësaj shkence madhështore janë shfaqur shumë dijetarë, juristë (fukaha), të cilët kanë shkruar libra të ndryshëm e të shumtë jurisprudence. Kjo tregon interesimin e madh e të lartë të myslimanëve për këtë shkencë dhe për rëndësinë e lartë të saj në mendimin e tyre. Kjo shkencë përmban gjithçka që nevojitet në fushat e jetës së përditshme të njeriut dhe përcakton dispozitat e legjislacionit islam (Sheriatit) për çdo çështje të jetës. Ajo përcakton të lejuarat, të ndaluarat, të pëlqyeshmet, të përbuzurat, të drejtat e njeriut, adhurimet, bashkëveprimet reciproke, si: tregtia, martesat, dënimet etj.

Në gjuhësi, fjala *fikh* ka kuptimin e njohjes së diçkaje dhe të kuptuarit e saj. Pra, fjala "Fikh" do të thotë: kuptim dhe dije.

Në Kur'anin e Shenjtë, fjala *fikh* përdoret në disa vende me kuptimin e saj gjuhësor. Prej tyre përmendim:

قال تعالى: ﴿هُم قُلُوبٌ لَا يَفْقَهُونَ بِهَا﴾

“...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë...” (Sure “A’raf”, ajeti 179)

Dhe: “Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut.” (Sure “Teube”, ajeti 122)

﴿فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ﴾

Dhe: “dhe zgjidhna nyjen e gjuhës sime, që ata të kuptojnë fjalën time!” (Sure “Ta Ha”, ajetet 27-28)

﴿وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِّن لِّسَانِي * يُفْقَهُوا قَوْلِي﴾

Dhe: “Ata thanë: ‘O Shuajb, ne nuk kuptojmë shumë nga ato, që na thua ti dhe të konsiderojmë të dobët midis nesh.” (Sure “Hud”, ajeti 9)

﴿قَالُوا يَا شُعَيْبُ مَا نَفَقَهُ كَثِيرًا مِّمَّا تَقُولُ وَإِنَّا لَنَرَاكَ فِينَا ضَعِيفًا﴾

Edhe në hadithet profetike përmendet fjala *fikh* në kuptimin e saj gjuhësor.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Cilido person prej ymmetit tim që mëson dyzet hadithe, për të cilat ka nevojë në çështjet e fesë së tij, Allahu do ta ringjallë atë në Ditën e Kiametit të ditur (fakijhen).”

Transmetohet se imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush memorizon dyzet hadithe prej hadiethëve tona që flasin për hallallin dhe haramin, Allahu do ta ringjallë atë në Ditën e Kiametit njohës, të ditur dhe nuk do të dënohet.”

Në terminologji fjala *fikh* ka kuptimin e shkencës rreth dispozitave të shariatit. Dijetarët kanë thënë: Fikhu është shkenca

që merret me dispozitat praktike të sheriatit dhe me argumentimet detajuese, me qëllim arritjen e lumturisë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër.

Sigurisht, fikhu është faktor bazë në lidhjen e njeriut me Allahun e Madhëruar, sepse bazat themelore të fikhut janë Kur'ani i Shenjtë, synneti i Profetit dhe Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ata!*). Përveç këtyre, në Medhhebin Xha'ferrij, janë intelekti (el akl) dhe konsensusi (el ixhmau).

S'ka dyshim se nevoja e fikhut është madhe në jetën e myslimanit. Për këtë është detyrë e çdo myslimani që të njihet me jurisprudencën islame. Duke qenë se feja e pastër islame është e përhapur në të gjithë rruzullin tokësor, sepse ajo është fe e natyrës së njeriut, shohim se jurisprudenca islame është përkthyer në shumë gjuhë të ndryshme.

Falë mirësisë së Allahut të Madhëruar dhe bashkëpunëtorëve të sinqertë e të palodhur të Shoqatës **Flladi**, u bë e mundur që të përkthehet në gjuhën shqipe libri me titull: "**Jurisprudenca e imam Xha'ferr Sadikut** (*Paqja qoftë mbi të!*)".

Me këtë rast, Shoqata **Flladi** i shpreh mirënjohjen më të thellë e më të përzemërt përkthyesit të palodhur në rrugën e përhapjes së fesë së pastër islame, Haxhi Selim Stafa (*Allahu e mbuloftë me mëshirën e Tij!*).

Gjithashtu, Shoqata **Flladi** falënderon dhe vlerëson kontributin e vyer të të gjithë bashkëpunëtorëve që ndihmuan në përgatitjen e kësaj vepre të madhe. Shpresojmë që të gjithë të përfitojmë nga kjo literaturë me vlera të mëdha për jetën tonë.

Allahu na e pranofte! Sigurisht, Ai është Mbarësuesi, Mbështetësi dhe Dhënësi i suksesit dhe i shpërblimit!

Shoqata FLLADI

PARATHËNIE

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve. Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për Muhamedin e për pjesëtarët e familjes së tij të mirë e të pastër.

Ky libër është hartuar për këdo që nuk ka asnjë njohuri për fik'hun e Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), por dëshiron të njihet e të mësojë këtë fik'h, edhe pse nuk ka gjetur rrugën për të arritur deri në këtë njohje, jo për shkak të mungesës së burimeve, apo ngaqë këto burime janë të pakta, por për faktin se këto burime përmbajnë hollësi e terminologji juridike që mund të jenë në një nivel më të lartë nga sa është në gjendje të kuptojë njeriu i zakonshëm. Krahas shkaqeve të tjera, ky krahasim është plotësisht i drejtë, madje ai mund të mos e kuptojë, edhe për shkak të shprehjeve të paqarta, ose për shkak të metodës së vështirë të arsyetimit, ose për shkak të mosrenditjes në pjesë e në kapituj, si dhe për shkak të keqnxjerrjes së argumenteve, ose për shkak të zgjatjes së perifrazimeve, ose për shkak të thjeshtësimit në citimin e thënieve dhe të kundërthënieve, të cilat janë tepër larg për të qenë pjesë e mendimit të lexuesit dhe të mënyrës së kulturës së tij, pa përmendur të tjera gjëra, me të cilat ai nuk është mësuar, gjëra

që nuk e tërheqin lexuesin “bashkëkohës”, edhe nëse ai ka dëshirë¹ ta mësojë e ta njohë këtë fik’h.

Jam munduar, duke kërkuar ndihmë vetëm prej Allahut, që jo vetë ta bëj sa më të lehtë rrugën e njohjes për këtë njeri të pasionuar, që të mësojë, por edhe ta ndihmoj atë të ndjekë pa ndonjë vështirësi fik’hun e nderuar të Ehli Bejtit (familjes profetike), qoftë nga shprehjet (fetvatë), qoftë nga argumentet. Kam treguar kujdesin më të madh që origjinali dhe nxjerrja e tekstit të jetë vetëm prej Ehli Bejtit, pasi kjo është rruga më e drejtë për t’u njohur me dispozitat e Allahut të Lartësuar dhe të ligjit të fesë së gjyshit të pjesëtarëve të Ehli Bejtit, të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), bazuar në dëshminë e hadithit “Eth’thekalejn” dhe të ajetit të nderuar, numër 83 të sures “En’Nisa”:

«وَلَوْ رَدُّوهُ الرَّسُولَ وَإِلَى أُولِي الْأَمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ»

“...sikur t’ia linin atë (lajmin) Profetit dhe përgjegjësve të tyre, ata do ta merrnin vesh dhe do të nxjerrin përfundime...”

Kur mua më është dashur të mos mjaftohem me tekstin përkatës, të marrë nga libri i Allahut e nga hadithet e Ehli Bejtit, atëherë jam kthyer te origjinali, ose në bazën ku mbështeten fukahatë e Ehli Bejtit (juristët e ligjit të fesë), të cilët, çdo rregull dhe çdo tekst origjinal, e referojnë në Kur’anin Famëlartë dhe te shprehjet e imamëve të pastër.

¹ Të shumtë janë ata që mbajnë libra fik’hu. Madje ka prej atyre që i studiojnë këto libra në Nexhef e në qytete të tjera dhe pretendojnë se janë të fushës së fik’hut. Përsëri të shumtë janë ata që nga këto libra dinë vetëm emrin dhe trashësinë, pasi kuptimi i këtyre librave është privilegj i zotëruesve të aftësive dhe i atyre që janë afër këtyre të privilegjuarve.

Kam mënjeluar përmendjen e vargut të përcjellësve njëri pas tjetrit (filani prej filanit...), pasi saktësinë e tekstit e kam vërtetuar duke u mbështetur në vërtetimin që i kanë bërë atij fukahatë dhe punës së tyre, sipas tekstit në fjalë dhe jo sipas transmetuesve dhe burrave të besueshëm... Kam vepruar në këtë mënyrë, për faktin se fik`hu i Imam Sadikut, ndryshe fik`hu i Ehli Bejtit, shpreh të vërtetën e parimeve në të cilat është përqendruar interesimi i veçantë i fukahave të Ehli Bejtit, të cilët i kanë shikuar këto parime me seriozitetin më të madh, si fetva dhe si praktikë dhe kanë vazhduar të hulumtojnë mbi këto parime gjatë qindra viteve, pa vërtetuar asgjë, qoftë edhe në formë alegorie mbi tekstet e vdekura, edhe pse gjendeshin të shkruara në tekstet e librave dhe të transmetuara prej njerëzve të mirë... Tekstet s`janë më shumë se shkronja të ngrira, në të cilat s`mund të ketë jetë veçse me praktikimin e me punën sipas asaj që shpreh shkrimi. Por ndryshon puna, nëse supozojmë se një brez i ri fukahash do të punonte me tekste të rralla groteske, të cilat i kishin lënë pas dore dijetarët e famshëm, atëherë emërtimi do të ishte i saktë.

Gjithashtu, në shumicën e rasteve, unë nuk kam paraqitur thënie të fukahave të vjetër e të rinj, por i diskutoj ato dhe i gjykoj thëniet e tyre, bazuar në metodën e njohur të autoriteteve të njohura, që janë thelluar aq shumë në ligjin e fesë islame (sheriati islam), sa e kanë ngritur këtë fik`h deri në majat më të larta, njëkohësisht janë lartësuar edhe vetë si dijetarë...

Këtë unë nuk e kam bërë për dobitë e përfitimet që ka si metodologji, por thjesht nga frika se mos lexuesi pëson ndonjë tronditje në mentalitetin e tij, për pasojë do të heqë dorë nga leximi i këtij libri, por heqja dorë prej çështjeve të fik`hut është si heqja dorë e atij që s`ka mundësi, ose si ai që lexon kalimthi.

Qëllimi numër një i librit tim është që ai të tërheqë sa më shumë lexues, sidomos atyre joarabë e atyre që janë larg, njëkohësisht ky libër të jetë një ndihmesë në përhapjen e këtij fik’hu të çmuar e besnik.

Pavarësisht nga dyshimet e mia, gjithmonë kam qenë i vetëdijshëm se dobia e librit nuk mund të matet me teoritë, polemikën dhe grumbullin e fjalëve që ka, por me përhapjen që ai ka dhe me lexuesit e shumtë që e marrin këtë libër. Libri, çdo libër, s’është gjë tjetër veçse një copëz prej trupave të ngurtë. Libri merr jetë, kur ai lëviz dhe kalon nga njëra dorë në një dorë tjetër, kur përmbajtja e tij lakohet nëpër gjuhët e njerëzve, kur atë e perceptojnë zemrat e veshët. Për të arritur këtë qëllim, në ditët e sotme, nuk ka mjet tjetër përveç faktit që libri të jetë i lehtë për t’u kuptuar dhe i qartë.

Sipas zakonit që kam, një herë hyra në librarinë “Irfan” në Bejrut, pronë e Haxhi Ibrahim Zejn Asijit, ku pashë një djalë të ri biond. Haxhi Ibrahim i tha djalit: “Ja, ky është ai...”

Ishte një orientalist gjerman. Djali më afrohet me dashuri e më tha: “Ne nuk e kemi ditur se edhe shi’at kanë fik’h, derisa lexuam librin tënd “Fik’hu sipas pesë medh’hebeve”.

I thashë: “Ajo që kam shkruar, s’është për t’u përmendur në krahasim me fik’hun e shi’ave. Fukahatë tanë e kanë hetuar sheriatin islam në bazat e në degët e tij, kanë studiuar në mënyrë të hollësishme thesaret e tij, nga të gjitha anët dhe janë thelluar aq shumë në të, sa e kanë lartësuar mbi të gjitha legjislacionet e vjetra e të reja. Gjithashtu, fukahatë tanë kanë bërë aq shumë botime në

fushën e fik'hut, sa nuk mund të numërohen dhe sot qarkullojnë në çdo dorë.”

Ai më tha: “Ne e mësojmë gjuhën arabe si gjuhë të huaj, por me gjithë lehtësinë që ka metoda e re e mësimit të kësaj gjuhe, ne e kuptojmë arabishten me vështirësi. Kjo është për gjuhën e re. Por si do jetë puna për gjuhën e vjetër? Ne e lexuam atë që ju keni shkruar dhe e kuptuam. Prej këtij libri ne mësuam se edhe shi’at kishin fik’h, ashtu siç kanë edhe ndjekësit e medh’hebeve e tjera.”¹

Që nga çasti që dëgjova prej këtij orientalisti këto fjalë, vendosa të shkruaj një cikël të plotë të fik'hut të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), adhurimet, veprimet, gjendjen civile dhe penaltitet, sipas metodës që tregova më sipër, me qëllim që, nga shtypshkronja, libri të dalë në disa pjesë, që mund të arrijnë katër ose pesë pjesë... Allahu e bëri mbarë të dalë pjesa e parë dhe me lejen e Allahut të Lartësuar, do të pasohet nga pjesa e dytë.

Kam punuar jo pak për nxjerrjen e për studimin e referencave dhe për paraqitjen e përmbajtjes së tyre me një metodë të këndshme, e cila, brenda mundësive, e bën librin të jetë sa më i realizuar.

Mbase mund të mendohet se të shkruash në fushën e fik'hut është punë e lehtë, pasi lënda është e gatshme dhe burimet janë të shumta e të shumëllojshme.

¹ Fjala e këtij orientalisti më frymëzoi të shkruaj atë që kam thënë në kapitullin e pestë të këtij libri, që është burimi më i mirë, ku del në pah ndihma e imamit për të caktuar mësues të aftë për të dhënë mësim e për të mbajtur leksione në fushën e fik'hut të Ehli Bejtit në universitetet perëndimore e lindore të kohës.

Po, edhe forcat e natyrës janë të gatshme dhe, gjithashtu, janë të shumta. Por cili është ai që i zbulon ato dhe ndriçon rrugën për të shkuar deri te ato? Kur dijetari specialist i nje këto forca, vallë, a do të ketë mundësi të nxjerrë atë që njohu dhe ta adaptojë atë sipas nevojës pa makineri e pa mjete? Edhe fik'hu i Ehli Bejtit është plotësisht si natyra që vërshton, me jetë e me fllade. Por cili është ai që do ta kuptojë këtë fakt në formën që ka dhe të përqendrojë kuptimet në linjat e gjera e të qarta të sendit aq lirshëm, sa të tërheqë lexuesin dhe të ngopë dëshirën e tij të flaktë?!

Vetëm Allahu i Lartësuar ka përgjegjësinë që punën time ta bëjë ndihmesë në këtë rrugë dhe vetëm Atij i kërkoj ndihmë, vetëm për Atë është falënderimi e lavdërimi, fillim e mbarim.

Paqe e shpëtim për Muhamedin dhe për pjesëtarët e pastër të familjes së tij!

* * *

UJËRAT

Uji në përgjithësi (el màul mutlak)

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً طَهُورًا”

“...dhe Ne lëshuam prej qielli ujë të pastër.”¹

Imam Xhafer Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo ujë është i pastër, përveç atij uji që ti e di që është i ndotur.” Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur shikonte ujin, thoshte: ‘Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, i cili e bëri ujin të pastër dhe nuk e bëri atë ndyrë.’”.

Çdo ujë i mirë natyror është zbritur prej qiellit, ose buron prej tokës, ose është borë e shkrirë. Ujin e ëmbël dhe ujin e kripur, sipas origjinës së krijimit, fukahatë e kanë quajtur ujë në përgjithësi (el màul-mutlak), domethënë, për këtë lëndë, është e

¹ Sure “El Furkan”, ajeti 48.

drejtë të përdoret fjala “ujë”, pa i shtuar ndonjë fjalë tjetër, që do ta ndryshonte qëllimin e kësaj fjale. Madje vetëm emërtimi ujë është i mjaftueshëm për të njoftuar të vërtetën e tij.

Përveç ujit në përgjithësi, që thamë (*el màul mutlak*), ujë konsiderohen të gjitha ujërat minerale, siç janë burimet e ujërave sulfurore e të tjera ujëra të kësaj kategorie, uji i lumit, i përzier me llum e me barishtet që janë me shumicë në ujë për shkak të qëndrimit për një kohë të gjatë, uji i moçaleve dhe uji i pellgjeve të mbetura pas largimit të rrjedhës, uji që ka pësuar ndryshim, për shkak të qëndrimit në një vend për një kohë të gjatë, ose për shkak të peshqve që kanë lindur në këtë ujë, ose për shkak të myshqeve e algave që janë formuar dhe qëndrojnë si masë e gjelbër mbi sipërfaqen e ujit, ose uji që ka pësuar ndryshim, për shkak të gjetheve e të gjërave të tjera që hedh era mbi këtë ujë. Është e pamundur të ruhesh prej këtyre gjërave të rëna në ujë.

Uji është i pastër dhe pastrues

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَيُنَزِّلُ عَلَيْكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ مَاءً لِّيُطَهِّرَكُم بِهِ”

“...Ai lëshoi mbi ju prej qiellit ujë për t’ju pastruar me të...”¹

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) transmeton: “I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: ‘Uji pastron dhe nuk pastrohet.’” Uji i zakonshëm (*el màul mutlak*) heq papastërtitë materiale, si gjakun e urinën,

¹ Sure “El Enfal” ajeti 11.

gjithashtu, largon edhe papastërtitë morale, që do të thotë se me ujë lejohet të merret abdes, të bëhet gusli (larja sipas rregullit të fesë islame prej gjendjes xhunub), me ujë lejohet të bëjë gusël gruaja pas menstruacioneve, gjithashtu, me ujë lahet edhe i vdekuri. Ky është edhe kuptimi i fjalës së fukahave (juristët e ligjit të fesë), që uji i zakonshëm (*el màul mutlak*), është i pastër në vetvete dhe pastrues i papastërtive prej trupave të tjerë. Me termin “*khubth*”-“ndyrësirë” kuptojmë papastërtitë materiale, kurse me termin “*hadeth*”-“papastërti” kuptojmë papastërtitë morale.¹

Dallimi ndërmjet “*khubth*” dhe “*hadeth*” (në gjuhën shqipe “papastërti”) rrjedh nga fakti se uji i paktë ndikon, pasi njeriut i priset pastrimi (tahàreti), kur ai prek papastërti materiale, si: gjak, urinë e ngordhësirë, por ai mbetet me i pastër (tahàret), nëse ai prek një njeri të cilit i është prishur pastrimi i vogël (abdesi), për shkak të daljes së gazrave, ose për shkak të jashtëqitjes e të urinimit, ose kur prek atë që i është prishur pastrimi i madh (gusël) për shkak të xhunubllëkut e të menstruacioneve.

Gjithashtu, edhe për larjen e rrobave nga papastërtitë nuk është i nevojshëm nijeti i afrimit të Allahu i Lartësuar, kurse për larjen prej xhunubllëkut (gusl) dhe për marrjen abdes, nijeti është i domosdoshëm.

¹ Është thënë: Pastrimi për papastërtitë “*khubth*” thuhet vetëm për trupat dhe jo për zemrat, prandaj në pastrimin prej papastërtive materiale kundërshtohet nevoja për nijetin e afrimit, që është prej cilësive të zemrave. Fjala “*hadeth*” (papastërti, si jashtëqitja e dalja e sekrecioneve) përdoret për trupat e për zemrat. Nisur nga kjo fjali, është i nevojshëm nijeti i afrimit.

Uji i shtuar (*el màul mudàf*)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), nëse mund të merret abdes me qumësht. Ai është përgjigjur: “Jo, abdesi merret vetëm me ujë, ose me tokë të pastër.”

Me përjashtim të ujit të zakonshëm (*el màul mutlak*), lëngjet e tjera, si uthulla, lëngjet e dala nga shtrydhja e frutave, e perimeve, çaji e pijet e tjera, apo uji i trëndafilave, janë ujë i shtuar (*el màul mudàf*). Në terminologjinë e fukahave, ujë i shtuar quhet lëngu i shtuar mbi ujin e zakonshëm dhe që e nxjerr ujin e zakonshëm prej origjinës së krijimit, siç është për shembull lëngu i dalë nga shtrydhja e portokajve, e karotave, etj.

Ujë i pastër, por jopastrues (*tàhirun gajru mutah'hirun*)

Ti mund të pish ujë të shtuar dhe ta përdorësh këtë ujë si të duash, por ti nuk mund të marrësh abdes me ujë të shtuar, ose të bësh gusël me ujë të shtuar, për t'u pastruar prej xhunubllëkut, ose të pastrosh papastërtinë më ujë të shtuar. Gjithashtu, me ujë të shtuar nuk mund të lahen enët, rrobat dhe as trupi, kur në trup kanë rënë papastërti (*nexhaset*). Këtu qëndron edhe kuptimi i fjalës së fukahave, se uji i shtuar është i pastër në vetvete, por ai nuk është pastrues për të tjerët nga pastërtitë materiale e morale.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Argumenti për pastrimin me tokë të pastër (tejemum) është fjala e Allahut të Lartësuar: “فَلَمْ يَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا” - “...dhe nëse nuk gjeni ujë, atëherë bëni tejemum...”¹

¹ Sure “El Maide”, ajeti 6.

Sic shihet, tejemumi bëhet detyrë, kur nuk ka ujë të zakonshëm, pasi uji është e vërteta e pastrimit dhe fjala ujë, detyrimisht, duhet të mbartë të vërtetën e ujit. Si përfundim, nëse abdesi do të ishte i lejuar me ujë tjetër, përveç ujit të zakonshëm (*el màul mutlak*), nuk do të ishte bërë detyrë tejemumi, në rastet kur nuk ka ujë.

Këtu kemi edhe një argument tjetër në lidhje me papastërtinë (nexhàsetin), e vërtetuar me tekstin e ligjit të fesë, prandaj ne nuk mund të gjykojmë në lidhje me pastërtinë e një njeriu pa u bazuar në tekst. Në ligjin e fesë është vërtetuar se uji i zakonshëm është pastrues për trupat e tjerë, por kjo nuk është vërtetuar për ujin e shtuar, prandaj është detyrë të vazhdohet me detyrën e bërjes tejemum, madje edhe pas larjes me ujë të shtuar.

Ndërmjet ujit të zakonshëm dhe ujit të shtuar

Kur ti shikon një ujë dhe nuk e di, nëse ai është ujë në përgjithësi, që heq papastërtitë dhe se me këtë ujë mund të bëhet pastrimi, apo ky është ujë i shtuar, që as nuk heq papastërtitë e as nuk mund të pastrohesh me të, atëherë si do të veprosh? A ka ndonjë rrugë për të vepruar me njërin prej këtyre dy lloje ujërash?

Përgjigje:

Në një gjendje të tillë, patjetër duhet t'i referohesh vetvetes dhe të shikosh: Nëse paraprakisht e ke ditur se ky ujë është ujë në përgjithësi, në karakteristikën e tij origjinale dhe më pas mbi këtë ujë ka ndodhur një ndryshim i paktë prej sapunit, bojës, brumit,

ose prej atyre lëndëve që i bëjnë ujit një ndryshim të lehtë, por ti pas këtij ndryshimi dyshon dhe thua: Vallë, a ka dalë uji nga e zakonshmja e tij? A është bërë ujë i shtuar, apo ka mbetur ujë në përgjithësi, ashtu siç ishte? Nëse çështja qëndron kështu, atëherë për këtë ujë do të vazhdojë dispozita se ai është ujë në përgjithësi. Ti ke qëndruar në këtë mendim, sepse njeriu, me natyrën e tij të krijimit, kur miraton ekzistencën ose mosekzistencën e një sendi, do të vazhdojë sipas miratimit që ka bërë në fillim, derisa për atë të vërtetohet e kundërta, me fakte të qarta e të besueshme, pasi faktin e besueshëm e fshin vetëm një fakt tjetër i besueshëm dhe faktin e besueshëm është e pamundur ta fshijë dyshimi, sepse dyshimi është i dobët si fakt. Për të gjitha këto, kur njeriu pyetet se përse veproi sipas miratimit të tij të parë dhe tani dyshon, ai përgjigjet se nuk është vërtetuar e kundërta.

Fukahatë e kanë ruajtur me kujdes këtë bazë dhe e kanë konsideruar prej bazave të ligjit të fesë. Duke u mbështetur mbi këtë bazë, ata kanë nxjerrë dispozita të shumta për të gjithë kapituajt e fik'hut. Këtë parim e kanë emërtuar "Shoqërim" (*istis'hâb*), për faktin se njeriu mbetet i shoqëruar me miratimin e tij të parë, derisa të vërtetohet e kundërta. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"E sigurta nuk priset me dyshim, por ajo priset me të sigurtën."*

Një shembull plotësisht të ngjashëm do të kishim, nëse uji do të ishte ujë i shtuar dhe pastaj njeriut i kalon në mendje dyshimi se uji është bërë ujë në përgjithësi. Prandaj ai ka detyrë të qëndrojë në miratimin e tij të parë, domethënë në miratimin se uji është i shtuar, gjithnjë duke u bazuar në parimin e shoqërimit. Me një fjalë, shoqërimi është veprim prej shoqërimit, që, në ligjin e

fesë, do të thotë vijimësi në atë çka është e vërtetuar, ose vijimësi në mohimin e asaj që është mohuar.

Kur ti shikon një ujë prej ujërave dhe dyshon, nëse ai është ujë në përgjithësi natyror, apo është ujë i shtuar, ose ujë që ka kulluar prej ndonjë trupi të njomë, duke theksuar se, që në fillim kishe dyshim për llojin e këtij uji, megjithëse më parë nuk kishe marrë vesh ndonjë gjë në lidhje me llojin e këtij uji, nuk mund të japësh gjykimin as për ujë të zakonshëm e as për ujë të shtuar, pasi në tekstet e ligjit të fesë nuk gjendet asnjë argument që të vërtetojë se origjina e ujërave është e zakonshme ose e shtuara.

Ujë i rrjedhshëm dhe ujë që nuk rrjedh

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) transmeton: “Nuk ka problem që burri të urinojë në ujë të rrjedhshëm, por është e urryer që ai të urinojë në ujë të ndenjtur.”

Nga ana gjuhësore, ujë i rrjedhshëm është uji që ecën nëpër tokë, qoftë uji që del nga burimi, qoftë uji që nuk buron, kurse ujë i ndenjtur është uji që qëndron i rrethuar në një pus, në një moçal, ose në një pegg të mbetur pas tërheqjes së rrjedhës.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Qëllimi me ujë të rrjedhshëm është uji që del nga burimi, sepse ky ujë ecën.” Sipas fjalës së përbashkët të të gjithë dijetarëve, uji që ecën, s’është komponent prej pjesëve të ujit të ndenjtur. Kjo do të thotë se fukahatë kanë një terminologji të veçantë për kuptimin e ujit të rrjedhshëm dhe ujit të ndenjtur, që është e kundërta e kuptimit që kjo fjalë ka nga ana gjuhësore. Sipas fukahave, ujë i rrjedhshëm do

të thotë uji që buron, edhe nëse faktikisht nuk ecën, por në atë ujë gjendet mundësia e aftësia për të vazhduar ecjen.

Uji dhe kontakti me papastërtinë

Transmetues të shumtë kanë përcjellë prej të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) këtë hadith: “Allahu e krijoi ujin të pastër dhe atë nuk e ndot asnjë send, më përjashtim të sendeve që i ndryshojnë atij ose shijen, ose ngjyrën, ose erën.”

Prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: “Nëse ujit i ka ndryshuar era, ose shija, ky ujë nuk pihet dhe me atë nuk merret abdes. Por nëse ujit nuk i ka ndryshuar as era e as shija, atëherë atë ujë pije dhe merr abdes me të.”

Gjithashtu, prej Imami Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: “Uji i pusit është i gjerë dhe atë nuk e prish asnjë send, veçse kur i ndryshohet ose era, ose shija. Kur ujit i ndryshon shija ose era, atëherë nga pusi nxirret aq ujë, derisa ujit t'i shkojë era dhe t'i përmirësohet shija, sepse uji ka një lëndë.”

Kur në ujë bie papastërti, për këtë ka disa raste:

1- Nëse papastërtia bie në ujë të rrjedhshëm, por prej kësaj papastërtie ujit nuk i ndryshon as shija e as era, uji mbetet në pastërtinë e tij, qoftë edhe i paktë. Këtë e miraton edhe fjala e Imam Sadikut: “...sepse uji ka lëndë.” Gjithashtu, rrjedhja është pengesë për ndotjen e ujit nga papastërtia me anë të kontaktit. Nuk ka asnjë dallim, nëse uji është shumë ose pak, përderisa uji nuk pëson ndryshim nga kontakti me papastërtinë.

2- Papastërtia bie në ujë dhe i ndryshon ujit ose shijen, ose ngjyrën, ose erën. Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, ky ujë është i ndotur dhe, bazuar në transmetimin e mësipërm, nuk ka dallim, nëse uji është pak ose shumë dhe as nëse është ujë i rrjedhshëm, ose ujë jo i rrjedhshëm.

Fukahatë kanë venë si kusht që ndryshimi të jetë nga lloji i sendit që ka rënë në kontakt me ujin. Sikur pranë ujit të ngordhë një kafshë dhe uji merr erë, pa pasur kontakt me ngordhësirën, uji mbetet në pastërtinë e tij.

Gjithashtu, dijetarët kanë vënë si kusht që ndryshimi të ketë cilësitë e papastërtisë dhe jo të sendit të ndotur me papastërtinë. Kur në ujë bie një rrëshirë e ndotur me papastërti dhe uji merr ngjyrë të kuqe ose të verdhë, uji mbetet në pastërtinë e tij.

Gjithashtu, fukahatë kanë kushtëzuar që ndryshimi të jetë i dukshëm dhe i kapshëm nga shqisat. Sikur të supozohet se papastërtia është prej ngjyrës së ujit dhe nuk ka ndodhur ndryshim, por, kur më pas ngjyra e tij ndryshon, sikur të supozojmë këtë ndryshim, uji përsëri mbetet në pastërtinë e tij, sepse në konsideratë merret ndryshimi i ndjeshëm dhe jo supozimi.

3- Ndyrësira bie në ujë të paktë, jo të rrjedhshëm. Me fjalën e përbashkët të të gjithë dijetarëve të fesë, uji bëhet i papastër, edhe kur uji nuk pëson ndryshim. Në lidhje me këtë çështje, flasin edhe hadithet e transmetuara prej Ehli Bejtit. Sipas asaj që thuhet, janë 300 hadithe.

Për sa i përket ujit që nuk rrjedh dhe që është në sasinë e një "kurr'rri" (njësi matëse, sasia e një "kurr'rri" do të shpjegohet më poshtë), atëherë ky ujë hyn në dispozitën e ujit të rrjedhshëm e nuk ndotet. Por ai ndotet, nëse i ndryshon ngjyra, ose shija, ose merr erë. Kjo dispozitë është bazuar sipas asaj që është vërtetuar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe është transmetuar me varg përcjellësish të pashkëputur dhe të besueshëm, të cilët njoftojnë se ai ka thënë: "Kur uji arrin sasinë e një "kurr'rri", atë nuk e ndot asnjë send."

Uji i paktë në mes të ujit të rrjedhshëm e ujërave të tjerë

Më sipër thamë se papastërtia (*nexhaseti*), kur bie në kontakt me ujin që nuk rrjedh, ai ujë ndotet, edhe kur uji nuk pëson ndonjë ndryshim, kurse, kur papastërtia bie në kontakt me ujin e rrjedhshëm, uji nuk ndotet, por uji i rrjedhshëm ndotet, kur ai pëson ndryshim. Kur kontakti me papastërtinë ndodh në një ujë të paktë dhe ne dyshojmë, nëse ai ujë është i rrjedhshëm deri në atë shkallë sa të mos ndotet vetëm për shkak të kontaktit me papastërtinë, apo uji nuk është i rrjedhshëm dhe ndotet nga kontakti me papastërtinë, si të veprojmë?

Përgjigje:

Problemi i ndotjes se ujit me papastërti përbëhet nga dy çështje: e para, kontakti i papastërtisë me ujin e paktë dhe e dyta, uji nuk është i rrjedhshëm. Për çështjen e parë, që ishte kontakti i papastërtisë me ujin e paktë, kjo çështje vërtetohet me anë të

shqisave, kurse çështjen e dytë, që ishte mosrjedhja e ujit, ne e vërtetojmë sipas parimit të shoqërimit, pasi ne e dimë mirë dhe është plotësisht e vërtetuar se para ekzistencës së këtij uji, në këtë vend nuk kishte burim uji. Por nëse dyshojmë edhe pas këtij vërtetimi, atëherë kërkojmë mbështetje në parimin e shoqërimit¹ për mosekzistencën e burimit. Kur plotësohen dy çështjet, kontakti i papastërtisë me ujin e paktë dhe mungesa e burimit, atëherë është vërtetuar ndotja e ujit.

Uji i shiut

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo send që i ekspozohet shiut, në të vërtetë është pastruar.”

Për këtë shkak, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët: Dispozita e shiut, në kohën e zbritjes së tij prej qiellit, është si dispozita për ujin e rrjedhshëm, i cili nuk ndotet nga kontakti me papastërtinë, qoftë kur papastërtia bie në ujë të rrjedhshëm, qoftë kur ky ujë kalon mbi papastërtinë.

¹ Ky problem dhe probleme të ngjashme të përbëra, kanë dy anë. Njëra anë vërtetohet me anë të shqisave, kurse ana tjetër e tij vërtetohet sipas parimit të shoqërimit. Këtë shoqërim, fukahatë, herë e kanë emërtuar shoqërim i përjetshëm dhe herë tjetër jo origjinal. Në lidhje me këtë problem, fukahatë kanë folur shumë gjatë dhe është një problem mjaft i vështirë për t'u kuptuar nga masa e njerëzve, me përjashtim të specialistëve të fushës përkatëse.

Kontakti i papastërtisë me ujin e shtuar

Është pyetur Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) për miun që bie në dhjamë dhe aty ngordh. Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Nëse dhjami është i ngrirë, hiqe miun dhe pjesën e dhjemit poshtë e rreth miut, kurse pjesën tjetër që mbetet, haje. Nëse dhjami është i shkrirë, atëherë nuk hahet, por përdoret për ndriçim. Edhe për vajin është e njëjta gjë.”*

Fukahatë kanë thënë: “Kur papastërtia bie në kontakt me ujin e shtuar, ai ujë ndotet, sapo papastërtia bie në të, pak ose shumë qoftë.” Këtë argumentim ata e bëjnë duke u bazuar në transmetimin që u tha në lidhje me vajin dhe dhjamin e shkrirë, megjithëse vaji e dhjami i shkrirë nuk kanë asgjë të përbashkët me ujin e shtuar.

Fukahatë kanë thënë se vaji e dhjami i shkrirë kanë disa cilësi të përbashkëta me ujin e shtuar. Kjo e përbashkët konsiston në ecjen e papastërtisë dhe depërtimin e saj në të shkrirën. Pikërisht, ecja dhe depërtimi i papastërtisë është shkaku që këto lëndë hyjnë në dispozitën e ndotjes, për shkak të rënies së papastërtisë në to. Transmetimi që tregonte për ndotjen e dhjemit e të vajit nga kontakti me papastërtinë, tregon, gjithashtu, edhe për ndotjen e ujit të shtuar nga kontakti me papastërtinë, mbase uji i shtuar qëndron në radhë parë, pasi dhjami e vaji janë lëndë me viskozitet më të madh se uji.

Prej fjalës që thotë Se’j’id El Hakijm, në librin “El Mustemsek”, del qartë dallimi mes ujit të shtuar të shumtë e ujit të shtuar të paktë: Kur uji është pak, ai ndotet, sapo papastërtia bie në kontakt me këtë ujë, për shkak të mos rrjedhjes së ujit. E dyta, kur uji është shumë, uji i shtuar ndotet për shkak të pranisë së

lëvizjes së ujit dhe depërtimit të papastërtisë. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë nxjerrë një nëndegë të kësaj dispozite, në lidhje me mosndotjen e burimeve të naftës nga kontakti me papastërtinë.

Ne nuk dyshojmë se nafta ndryshon të vërtetën e origjinën e saj prej ujit të shtuar. Kështu mendojnë fukahatë dhe kështu pohon edhe Sej'jid El Hakijm, kur flet për këtë çështje.

Pastrimi i ujërave të ndotur

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo send që i ekspozohet shiut, në të vërtetë është pastruar.” Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Uji i lumit pastron njëritjetrin.”

Për pastrimin e ujit të ndotur janë disa gjendje

1- Uji është i rrjedhshëm, por papastërtia i ka ndryshuar ose ngjyrën, ose shijen, ose i ka dhënë erë. Për pastrimin e këtij uji mjafton vetëm heqja e ndryshimit spontanisht, ose me ndërmjetësim, pak ose shumë qoftë ky ujë, pasi qenia e ujit i rrjedhshëm është e mjaftueshme për pastrimin e tij. Këtë e bazojmë në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Për ujin ka lëndë.”, fjalë të cilën ne e kemi përmendur në nëntitullin “Uji dhe kontakti me papastërtinë”.

2- Uji është i paktë dhe jo i rrjedhshëm. Nëse ky ujë nuk ka pësuar ndryshim nga kontakti me papastërtinë, është e

mjaftueshme rënia e shiut mbi këtë ujë, që ai të pastrohet, ose që ky ujë të bashkohet me një sasi uji të pastër, të barabartë me një "kurr'rr", ose të bashkohet me një ujë të rrjedhshëm, në atë mënyrë që të dy ujërat të bëhen një ujë i vetëm. Por, nëse uji është i ndotur me papastërtinë dhe ka pësuar ndryshim nga kjo ndotje, së pari, duhet të hiqet ndryshimi dhe pastaj të bëhet pastrimi i ujit sipas mënyrës së treguar: Ky ujë i paktë të hidhet në ujë të shumtë, ku ai përzihet dhe prej tij nuk mund të dallohet asnjë gjurmë.

3- Ujë me shumicë dhe jo i rrjedhshëm. Nuk ka dyshim se edhe ky ujë ndotet nga kontakti me papastërtinë, kur këtë ujë i ndryshon ose ngjyra, ose shija, ose merr erë. Edhe ky ujë pastrohet vetëm me heqjen e ndryshimit, ose me rënien e shiut mbi të, ose me bashkimin e tij me një "kurr'rr" ujë të pastër, ose me ujë të rrjedhshëm, me kusht që të dy ujërat të bëhen një ujë i vetëm.

Fukahatë nuk kanë vënë kusht që çdo pjesë e ujit të ndotur të përzihet me pjesët e ujit të pastër, gjithashtu, ata s'kanë vënë kusht as për barazinë e sipërfaqeve të dy ujërave. Pastrimi është i vlefshëm, me kusht që uji pastrues të jetë më lart, kurse uji që do të pastrohet të jetë më poshtë dhe jo e kundërta.

Gjithashtu, fukahatë nuk e kanë kushtëzuar zhdukjen e ndryshimit paraprakisht dhe pastaj bashkimin e ujërave, por kanë thënë se për pastrimin mjafton heqja e ndryshimit dhe arritja e bashkimit të të dy ujërave.

Dyshimi dhe ngurrimi

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Uji, i gjithi, është i pastër, derisa ti mëson se ai është i ndotur me papastërti.”

Kur ti shikon një ujë dhe nuk ke dijeni se si është ky ujë, është i pastër, apo ujë i ndotur me papastërti, bazuar mbi këtë transmetim të veçantë, në lidhje me ujin, rezulton se ky ujë është ujë i pastër. Gjithashtu, bazohu mbi transmetimin që përfshin transmetimin e mësipërm, si dhe në transmetime të tjera që thonë: “Çdo send është i pastër, derisa ti të mësosh se ai send është i papastër, veçanërisht kur për ty është vërtetuar se uji është i pastër.”

Por, nëse ti, paraprakisht, ke dijeni se uji është i ndotur me papastërti dhe pastaj dyshon se mos mbi këtë ujë kanë kaluar faktorët pastrues, atëherë bazohu në parimin e shoqërimit, në lidhje me ndotjen nga papastërtitë.

Përngjasimi i ujit të pastër me ujin e ndotur me papastërti

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me një njeri që ka dy enë dhe në njërën prej dy enëve ka rënë papastërti, por ai nuk e di se në cilën prej dy enëve ka rënë ajo. Për më tepër, ai s’ka ujë tjetër përveç ujit që është në këto dy enë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “T’i derdhë të dyja enët dhe të bëjë tejemum.”

Kur janë dy enë me ujë dhe njëra enë është me ujë të pastër, kurse tjetra me ujë të ndotur me papastërti dhe ti s’ke mundësi të dallosh enën me ujë të pastër nga ena me ujë të ndotur, është detyrë që të dyja enët të largohen së bashku, sipas urdhrit për të

mënjanuar papastërtinë. Largimi i papastërtisë, në këtë rast, realizohet vetëm duke larguar të dyja enët. Në rast se personi në fjalë s'ka ujë tjetër përveç ujit të këtyre dy enëve, për faljen e namazit është detyrë të bëhet tejemum.

Shumimi

Kur uji është i paktë dhe në të njëjtën kohë është i ndotur, por më pas mbi këtë ujë kalon një ujë tjetër dhe me këtë shtim arrihet sasia e një "kurr'rrri", uji i ndotur, a bëhet i pastër apo vazhdon të jetë i ndotur?

Përgjigje:

Po, uji është i ndotur, sipas fjalës së Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): "Kur uji arrin sasinë e një "kurr'rrri", atë nuk e ndot asnjë send.", që do të thotë se, së pari, patjetër duhet të realizohet sasia e një "kurr'rrri" dhe më pas në ujë bie papastërtia, domethënë që objekti patjetër duhet të ketë përparësi ndaj dispozitës, pasi uji i dytë, nëse është i ndotur, tërësia e dy ujërave nuk e bën ujin të pastër. Madje, edhe nëse uji i shtuar është i pastër, ai do të bëhet i ndotur për shkak të kontaktit.

Uji i përdorur për abdes e për gusël

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Profeti (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur merrte

abdes, të tjerët merrnin ujin që kullonte prej abdesit të tij dhe me këtë ujë ata merrnin abdes."

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Në lidhje me ujin me të cilin ka marrë abdes burri dhe me atë ujë ai ka larë fytyrën e duart e tij, s'ka problem që dikush tjetër të marrë këtë ujë dhe të marrë abdes me të."

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për ujin me të cilin është larë burri xhunub, nëse mund të lahet dikush tjetër me këtë ujë. Ai ka thënë: "S'ka problem, nëse dikush tjetër lahet prej xhunubllëkut me këtë ujë. Edhe unë kam bërë gusël me ujë të tillë."

Nga kjo thënie e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) nxjerrim si përfundim se uji nuk ndotet me prekjen e trupit të burrit xhunub, madje këtij uji nuk i hiqet as cilësia e pastrimit. Për këtë arsye, fukahatë kanë thënë se uji me të cilin njeriu merr abdes, ose uji me të cilin ai bën gusël të pëlqyeshëm (*mustehab*), siç është gusli për ditën e Xhuma, me këtë ujë lejohet të kryhet pastrimi prej (*khubth-it*), domethënë jashtëqitjes. Gjithashtu, me këtë ujë lejohet edhe pastrimi moral i detyrueshëm (*hadeth*), që do të thotë se me këtë ujë mund të merret abdes dhe të bëhet gusël për herë të dytë.

Në lidhje me burrin që bën gusël të detyrueshëm, si gusli për xhunubllëk, ky ujë, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, është pastrues për jashtëqitjen. Sipas fjalës më të përhapur, është pastrues edhe për pastrimin moral të detyrueshëm (*hadeth*).

Kurr'ri

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur uji është në sasinë e një “kurr’ri”, atë nuk e ndot asnjë send.”

Në lidhje me caktimin e sasisë së një “kurr’ri”, me anë të sipërfaqes, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur uji është në sipërfaqe tre shibr (pëllëmbë) e gjysmë dhe tre shibër e gjysmë thellësi, kjo sasi uji është një “kurr’rr”.”

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) kemi edhe përcaktimin e sasisë së një “kurr’ri” me peshë. Për këtë ai ka thënë: “‘Kurr’ri’ që nuk e ndot asnjë papastërti është 1200 ritll.” Ka edhe transmetime të tjera në lidhje me përcaktimin e sasisë së “kurr’rrit”.

Për transmetimin e parë, ka një prononcim që duhet përmendur: Uji që është më pak se një “kurr’rr”, këtë ujë e ndot sendi me papastërti. Por, dispozita e nocionit gjithmonë është në kundërshtim me dispozitën e prononcuar në pjesën më të madhe të anëve, veçanërisht kur prononcimi është i përgjithshëm, ashtu siç jemi tani me prononcimin në fjalë, sepse ideja në vijim të përfitimit të përgjithshëm, nuk e bën të detyrueshme që edhe nocioni të jetë i përgjithshëm, në atë mënyrë, si në rastin tonë, kur uji nuk e ka arritur sasinë e një “kurr’ri”, prandaj i gjithë uji, jo vetëm që është i ndotur, por ai ndot edhe çdo send tjetër. Për këtë arsye është thënë: Për nocionin s’ka përgjithësim.

Nga sa thamë, mësohet qëllimi i përdorimit të shprehjes se uji nuk ndotet, kur është në sasinë e një “kurr’ri” me anë të

kontaktit me papastërtinë, me kusht që uji nuk pëson ndryshim prej këtij kontakti, kurse për sasinë më pak se një "kurr'rr", uji ndotet nga kontakti me papastërtinë, edhe nëse nuk ndryshon as ngjyra, as shija e as era e këtij uji.

Ka mbetur çështja e përcaktimit se sa është sasia e "kur'rrit". Në lidhje me këtë përcaktim, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) kanë ardhur dy transmetime. Njëri flet për përcaktimin me anë të sipërfaqes, kurse transmetimi tjetër flet për përcaktimin me anë të peshës. Më e pëlqyeshme mbetet të mbështetemi në përcaktimin me anë të sipërfaqes, domethënë në hapësirën e pëllëmbëve (shibrave) dhe, kjo për disa arsye:

1- Në kohën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk dihej me saktësi sa ishte masa e një ritlli.

2- Ujërat ndryshojnë në ana e peshës dhe e dendësisë, janë të lehtë e të rëndë.

3- Shumica e njerëzve e kanë të vështirë të bëjnë përcaktimin me anë të peshës, sidomos në rastet kur ata gjenden larg qendrave të banuara. Por ndryshe qëndron puna me sipërfaqen, pasi vlerësimi i sipërfaqes është i mundshëm, qoftë edhe përafërsisht, me anë të një shikimi të vëmendshëm.

Dyshimi e ngurrimi

Ti sheh ujë dhe nuk e dije më parë, nëse ky ujë është në sasinë e një "kurr'rr", apo është më pak. Nëse ti e ke ditur se ai ujë ishte në sasinë e një "kurr'rr" dhe pastaj dyshon se uji është pakësuar, atëherë vendos sipas parimit të shoqërimit, domethënë

që uji ka mbetur në sasinë e një *"kurr'rrri"* dhe pastaj mbi këtë gjykim sistemo të gjitha rrjedhojat për mosndotjen e këtij uji nga kontakti me papastërtinë, si dhe për pastërtinë e sendit të ndotur, të larë në këtë ujë.

Nëse ti e ke ditur më parë se uji është më pak se një *"kurr'rr"* dhe pastaj dyshon se ai është shtuar, përsëri vendos sipas parimit të shoqërimit, domethënë që uji nuk e ka arritur sasinë e një *"kurr'rrri"* dhe mbi këtë gjykim sistemo të gjitha rrjedhojat, siç janë ndotja e ujit nga kontakti me papastërtinë dhe papastërtinë e sendit të ndotur, të larë në këtë ujë.

Nëse në fillim ti dyshon dhe s'kishe dijeni paraprake që uji është shumë ose është pak, ti nuk mund të gjykosësh e të vërtetosh që uji është në sasinë e një *"kurr'rrri"*, por as nuk e mohon dot¹ që uji nuk është në këtë sasi. Nëse ti lanë në këtë ujë diçka të ndotur me papastërti, uji mbetet në pastërtinë e tij, derisa ai nuk ka pësuar ndryshim prej papastërtisë, pasi supozimi ishte ndërtuar mbi dyshimin. Nëse uji është apo nuk është në sasinë e një *"kurr'rrri"*, dyshimi për sasinë e ujit quhet dyshim në pastërtinë. Me intuitë mjafton vetëm dyshimi për të vendosur në lidhje me pastërtinë e ujit, për pasojë, trupi i ndotur me papastërti, i larë në këtë ujë, do të mbetet i ndotur, sipas parimit të shoqërimit. Në

¹ Thuhet: Atje kemi një bazë që vërteton ndotjen e këtij uji të dyshimtë. Por ky është vendim sipas parimit jo të përhershëm në lidhje me sasinë e një *"kurr'rrri"*, atëherë thuhet se uji më pak se një *"kurr'rr"*, ndotet sapo uji të bjerë në kontakt me papastërtinë dhe ky është ujë vetëm për faktin që është ujë, por në të mund të ketë rënë papastërti. Gjithashtu, thuhet se, nëse nuk është vërtetuar që sasia e ujit arrin masën e një *"kurr'rrri"* dhe më pas ne dyshojmë, atëherë vendosim sipas parimit të shoqërimit se uji është më pak se një *"kurr'rr"*, bazuar në transmetimet për kapitullin e përbërësve. Njëra prej dy pjesëve vërtetohet me intuitë, kurse pjesa tjetër me origjinën. Ka edhe thënie të tjera në lidhje me këtë problem.

këtë gjykim nuk ka kundërthënie mes pastërtisë së ujit dhe mbetjes së papastërtisë në trupin, ku ajo ka rënë. Është kështu për shkak të shumëllojshmërisë së problemit, pasi problemi për pastërtinë në origjinë, është uji, kurse problemi i shoqërimit të papastërtisë është trupi që ka prekur papastërtinë.

* * *

LLOJET E PAPASTËRTIVE

Allahu i Lartësuar thotë: “وَيْبَاكَ فَطَهَّرَ” - “Dhe rrobat tuaja pastroi” (Sure “El Mudeth’rhir”, ajeti 4), përsëri Allahu thotë:

“ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ ” “Allahu i do ata që pendohen dhe ruhen prej veprimeve të ndyra.” (Sure “El Bekare”, ajeti 222)

Në gjuhën arabe, fjala “nexhàset” - “papastërti” përdoret për ndërgjegjen e keqe, për punët e liga, kurse në terminologjinë e fukahave, do të thotë papastërti materiale, e cila është detyrë e domosdoshme të hiqet, kur myslimani do të falë namaz, ose do të bëjë tavaf farz në Qabe.

“Nexhaseti” - “papastërtia” është disa llojesh:

Urina

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për rrobën ose për pjesën e trupit, ku ka rënë urinë. Çfarë duhet të bëhet? Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: “Laje atë dy herë.”. Kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.

Feçet

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për miellin ku ka rënë kakërdhia e miut, nëse lejohet ngrënia e këtij mielli. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur prej saj ka mbetur diçka, s’ka ndonjë problem, vetëm hiqet pjesa e sipërme e miellit.”

Gjithashtu, fjala e përbashkët e fukahave është se urina e feçet të jenë prej njeriut ose prej një kafshe, të cilës nuk i hahet mishi, por që ka gjak të rrjedhshëm. Është fjala për gjakun që grumbullohet nëpër damarët dhe del me fuqi e me vrull, kur priten damarët. Është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Laje rrobën tënde prej urinës së kafshës që nuk i hahet mishi dhe mos e laj rrobën prej urinës se atyre që u hahet mishi.”

Shejhu El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Papastërtia e urinës dhe e feçes së njeriut, si edhe e disa lloje kafshësh, si macja e qeni, ose të ngjashme me këto, për çështje që janë domosdoshmëri, siç është pastërtia e ujit, nuk është e nevojshme të zgjatet fjala e të përmenden transmetimet e veçanta e të gërshetuara që tregojnë se ato janë papastërti.”

Shpendët

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “S’ka problem për glasën e urinën e çdo shpendi që fluturon.” Domethënë se glasa e urina e çdo shpendi është e pastër, qoftë edhe shpend që nuk i hahet mishi.

Disa kanë thënë: Ky transmetim, që vërteton se jashtëqitjet e çdo shpendi, madje edhe të shpendëve që nuk u hahet mishi, siç

është lakuriqi i natës, nuk është në përputhje me transmetimin e mësipërm, që vërteton se jashtëqitjet e kafshëve që nuk u hahet mishi, janë papastërti, madje edhe të kafshëve fluturuese, siç është lakuriqi i natës. Para kësaj kundërthënieje, cilën prej dy transmetimeve të marrim?

Përgjigje:

Do të marrim transmetimin që vërteton se ato janë të pastra dhe jo transmetimin që vërteton se ato janë papastërti. Ne do të vendosim për pastërtinë e jashtëqitjes së shpendit, madje edhe të atij shpendi që nuk i hahet mishi, sepse transmetimi që vërteton papastërtinë, ka ardhur për kafshët jofluturuese. Bazuar mbi këtë kundërthënie, krahas supozimit të moslargimit, kundërthënia mes dy transmetimeve është e dukshme, prandaj ne i japim përparësi transmetimit që vërteton pastërtinë, pasi ky transmetim është me argument më të fuqishëm, krahas supozimit të barazimit me argumente. Bazuar mbi rregullin për të zgjedhur njërin ndërmjet dy transmetimeve kundërthënëse, ne pëlqejmë transmetimin që vërteton pastërtinë. Gjithashtu, bazuar mbi fjalën për të përzgjedhur mes dy transmetimeve, ne i referohemi thënies përgjithësuese: *“Çdo send është i pastër, derisa të mësojmë se ai send është i papastër.”*

Kafsha që ha feçe dhe kafsha me të cilën njeriu ka kryer marrëdhënie (el xhel'lâl uel muetù')

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mos e hani mishin e kafshëve që hanë feçe. Nëse të kanë prekur jargët e kësaj kafshe, laje menjëherë vendin e prekur.” Kafsha që preferon feçet, në terminologjinë islame, thirret me emrin “*xhel'lâl*”.

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: “Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për kafshën me të cilën njeriu ka kryer marrëdhënie dhe ai është përgjigjur: “*Është haram mishi e qumështi i asaj kafshe.*”

Kafshëve që u hahet mishi, sipas ligjit të fesë, janë kafshët që njerëzit e kanë bërë zakon t’i hanë, siç është: deveja, lopa, buallica, delja e dhia. Por ka edhe kafshë që njerëzit nuk e kanë bërë zakon të hanë mishin e tyre, megjithëse e dinë që mishi i atyre kafshëve është hallall të hahet, siç janë: kali, gomari e mushka. Njerëzit kanë hequr dorë nga ngrënia e mishit të këtyre kafshëve që në kohët e hershme, pasi ishin mjetet më të rëndësishme për transport dhe kishin frikë, se ngrënia e këtyre kafshëve, do të çonte në zhdukjen e tyre, ose do të bëheshin shumë të rralla dhe atëherë do të ndodhte krizë.

Cilës kafshë lejohet t’i hahet mishi, sipas ligjit të fesë, prej këtyre dy kategori kafshësh: kafsha ha feçe, për pasojë mishi i saj është forcuar dhe kafsha thirret *xhel'lâl*. Për këtë shkak, është haram të hahet mishi i saj, derisa ajo të lërë ngrënien e feçeve dhe të hajë bar të mirë për një kohë të gjatë, derisa të shërohet plotësisht nga vesi i të qenit *xhel'lâl* dhe derisa ky emër të hiqet

prej saj, sepse dispozitat ndjekin emërtimin. Gjithashtu, është haram mishi i asaj kafshe me të cilën njeriu ka kryer marrëdhënie. Atëherë, derisa është haram ngrënia e mishit të kafshës për shkak se ajo është *xhel'lâl*, ose për shkak se me të njeriu ka kryer marrëdhënie, patjetër që edhe urina e jashtëqitja e saj është papastërti, gjithashtu, është haram të pihet edhe qumështi i këtyre kafshëve.

Sperma

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me spermën që ka rënë në tesha. Ai është përgjigjur: “Nëse e di vendin, ku ka rënë, atëherë laje vetëm vendin dhe, nëse ti nuk e dallon vendin, ku ajo ka rënë, atëherë laje të gjithë rrobën.”

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se sperma e çdo gjallese me gjak të rrjedhshëm, është papastërti (*nexhâset*), qoftë nga ato kafshë që u hahet mishi, qoftë nga ato kafshë që nuk u hahet mishi. Për sa u përket gjallesave që s’kanë gjak të lëngshëm, sperma e atyre gjallesave është e pastër, ashtu siç është i pastër edhe gjaku i tyre.

Sekretioni uretral dhe sekretioni prostatik (El medhij uel vediju)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për sekretionin uretral (*medhij*), kur ai bie në rroba. Ai ka thënë: “S’ka problem për të.”

Sekrecioni uretral (*medhij*) është uji i bardhë, i trashë që del gjatë përkëdheljeve, ose gjatë mendimit në marrëdhëniet intime. Njeriu edhe mund të mos e ndiejë se ky sekrecion ka dalë prej tij, kurse sekrecioni prostatik (*el vedij*) del pas urinimit. Që të dy këto sekrecione janë të pastra.

Gjaku

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse në rrobën e njeriut bie gjak dhe ai fal namaz pa e ditur se i ka rënë gjak në rrobën e tij, ai nuk e përsërit namazin. Por nëse ai e di, para se të fillonte faljen e namazit, por harron dhe fal namaz me këtë rrobë, ka detyrë të përsërisë namazin.”

Kur është pyetur për gjakun e pleshtave, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për këtë gjak s’ka problem.” Mirëpo pyetësi tha: “Ai është me shumicë dhe e keqja e tij shtohet shumë.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Edhe nëse është shumë.”

Çdo kafshë me gjak të rrjedhshëm, gjaku i saj është papastërti (*nexhis*) dhe është e barabartë, qoftë kafshë që i hahet mishi, qoftë kafshë që nuk i hahet mishi. Gjithashtu, është e barabartë, kur gjaku është pak, ose është shumë. Me këtë dispozitë dhe me dispozitat e tjera që pamë më sipër, për ne bëhet e qartë se kafshës që i hahet mishi, urina dhe jashtëqitja e saj, janë të pastra, kurse gjaku i saj, me fjalën e përbashkët të të gjithë dijetarëve të fesë, është papastërti (*nexhis*).

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë e kanë tjerë fjalën gjerë e gjatë. Por çështja reduktohet në faktin: A ka atje një bazë të ligjit të fesë, që të vërtetojë se gjaku për të cilin dispozita thotë është papastërti, me përjashtim të atij gjaku që e ka nxjerrë jashtë këtij rregulli dispozita, siç është gjaku i kafshës që s'ka gjak të rrjedhshëm, si dhe gjaku që ka mbetur te kafshët e therura. Me qëllim që ne t'i referohemi kësaj baze ligjore, do të gjujkojmë se është papastërti çdo gjak për të cilin ne dyshojmë pastërtinë ose papastërtinë e tij. A ekziston një bazë e tillë e ligjit të fesë?

Shumica e fukahave e mohojnë ekzistencën e një baze të tillë ligjore, por disa janë shprehur për ekzistencën e kësaj baze, duke e nxjerrë argumentin prej fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Abdes merret me çdo ujë që ka pirë shpendi, me përjashtim të rastit, kur ti shikon gjak në sqepin e shpendit.”* Pra, duke gjujkuar se gjaku është papastërti, por edhe ky gjujkim shkon krahas mosdijes në lidhje me të vërtetën e atij gjaku.

Përgjigje: Ky s'është shpjegim për dispozitën e gjakut, pasi, në të vërtetë, është vetëm një deklaram për dispozitën në lidhje me kontaktin e gjakut me një objekt. Por ti më sipër mësove se gjaku ishte papastërti.

Kafshët e therura

Pjesa më e madhe e fukahave, madje thuhet se të gjithë fukahatë kanë thënë se gjaku që mbetet në kafshën e therur, pas daljes së gjakut në sasinë e zakonshme gjatë therjes, është i pastër. Madje fukahatë kanë thënë edhe mohimin e mëkatit. Edhe unë nuk jam njohur me asnjë tekst të veçantë në lidhje me këtë çështje.

Cofëtina

Imam Sadikui (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me ujin e një pusi, ku bie një cofëtinë, ka thënë: *“Nëse uji mban erë, prej atij pusi nxirren njëzet kova ujë.”*

Është pyetur për brumbullin, mizën, karkalecin, milingonën dhe për insekte të tjera të ngjashme me këto që ngordhin në pus, në vaj e në dhjamë. Ai ka thënë: *“Për çdo gjallesë që s’ka gjak të rrjedhshëm, nuk ka problem.”* Në një transmetim tjetër, ka thënë: *“Uji nuk prishet, veçse kur gjallesat e rëna në ujë kanë gjak të rrjedhshëm.”*

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se çdo cofëtinë me gjak të rrjedhshëm është papastërti, qoftë kafshë, ose njeri, para bërjes gusël dhe i ka dalë shpirti në ujë, por pastaj ato janë nxjerrë prej pusit. Nëse nuk i ka dalë shpirti në ujë, në origjinë, hyn në dispozitën e fëmijës së dështuar.

Të gjitha gjallesat që s’kanë gjak të rrjedhshëm, si: gjarpri, karkaleci e miza, cofëtinat e këtyre janë të pastra. Gjithashtu, të pastra janë edhe pjesët e cofëtinës në të cilën nuk shkon gjak, si: qimet, briri, thonjtë, puplat, leshi dhe kocka. Këto janë të pastra, përveçse në qofshin prej kafshësh të papastra, si qeni dhe derri.

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Nuk ka problem të falet namaz mbi postiqen e cofëtinës, sepse në lesh s’ka shpirt.”* Fjala e tij *“në lesh s’ka shpirt”*, justifikon pastërtinë e çdo pjese të cofëtinës në të cilën nuk ka jetë.

Në lidhje me gjymtyrën e prerë prej trupit të gjallë, fukahatë kanë dy thënie: Njëra thënie flet për pastërtinë e saj dhe është bazë, kurse thënia tjetër flet se ajo është papastërti, por për rezervë. Shprehja është: Rezerva nuk është argument për ligjin e fesë. Ky është edhe shkaku që autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Qëllimi që merret prej njoftimeve është papastërtia e trupit të vdekur. Por kjo, në mënyrë taksative, nuk vërtetohet për pjesët.”

Mullëza dhe qeska e miskut

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për mullëzën që del prej kecit të ngordhur. Ai ka thënë: “Nuk ka problem.” Gjithashtu, është pyetur edhe për qumështin që mbetet në gjirin e deles së ngordhur. Përsëri ai ka thënë: “Nuk ka problem.”

Gjithashtu, është pyetur djali i Imam Sadikut, Imam Qazimi (*Paqja qoftë mbi të!*), për qeskën e miskut, të cilën burri që fal namaz e ka në xhep ose në rrobën e tij. Ai ka thënë: “Për këtë nuk ka problem.”

Fjala arabisht “*el infeh'hatu*” është mullëza e kecit, e qengjit, e viçit gjatë kohës që ushqehet vetëm me qumësht. Por kur i vogli fillon të kullosë bar, ajo bëhet plëndës. Mullëza përdoret për të kthyer qumështin në djathë; kurse qeska e miskut, është lëkura që gjendet në zhapikun e quajtur “*dhabij*”, në të cilën ka gjak me erë të mirë. Bazuar në këto dy transmetime dhe në transmetime të tjera, fukahatë janë shprehur për pastërtinë e kësaj qeske misku, si dhe për pastërtinë e mullëzës, edhe kur këto të dyja nxirren prej kafshës së ngordhur. Gjithashtu, fukahatë janë shprehur edhe për

pastërtinë e qumështit në gjirin e kafshës së ngordhur, pavarësisht kontaktit të tij me pjesët e vdekura që janë papastërti, me kusht që kafsha të jetë prej llojit që i hahet mishi.

Dora e myslimanit

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për mesten (*khuff*) që shitet në treg. Ai ka thënë: *“Blije dhe me atë fal namaz, derisa të mësosh se me të vërtetë ajo është prej kafshës së ngordhur.”*

Gjithashtu, ai është pyetur për një burrë që ble në treg një gunë postiqeje, por ai nuk e dinte se lëkura është marrë prej kafshës së pastruar me anë të therjes sipas mënyrës islame. Ai tha: *“Po, çështja nuk është kundër jush. Në të vërtetë, khavarixhët, me injorancën e tyre, e shtrënguan shumë vetveten. Por feja është shumë më e gjerë se kaq.”*

Këtu qëndron edhe shkaku që fukahatë kanë dhënë fetva për pastërtinë e mishrave e të lëkurave mbi të cilat është dora e myslimanit, ose ato janë marrë në treg, por si tërësi, ose pjesa më e madhe e lëkurëve janë marrë prej myslimanëve. Gjithashtu, fukahatë kanë gjykuar për pastërtinë e mishrave e të lëkurëve që gjenden në trevat e në rrugët e tokave islame, me kusht që mbi to të ketë shenja që janë përdorur.

Sej'jid El Hakijm, në pjesën e parë të librit *“El Mustemsek”*, *“Çështja e papastërtisë së cofëtinës”*, ka thënë: *“Ti ke të drejtë të marrësh lëkurë prej dorës së myslimanit, madje edhe kur e di se ai e ka marrë atë prej një jomuslimani. Shprehimisht, kjo thënie, në tekst, është: “Kur dora e myslimanit është para dorës së mohuesit,*

ashtu siç ndodh në kohën e sotme, me lëkurët e sjella prej vendeve të mohuesve, është e qartë se ajo, dora e myslimanit, gjithashtu, është zotëruese, domethënë në pastrimin.”

Autori i librit “Kàshiful Gitài” ka thënë: “Ajo që vjen prej vendeve të mohuesve, si portokallet, nuk ka problem, kur ti e merr atë prej dorës së myslimanit, edhe kur e di se më parë ajo ka qenë në dorën e mohuesit.”

Në vijim, Sej’jid El Hakijm, ka thënë: “Ajo që ka thënë autori i librit “El Xhevàhir”, në lidhje me përfitimin, është në vendin e duhur.”

Qelbi dhe të vjellat

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për burrin që ka një puçërr dhe ajo shpërthen gjatë kohës që ai fal namaz. Ai tha: “E fshin qelbin, pastaj dorën e fshin në mur ose në tokë dhe nuk e ndërpret namazin.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka vjellë në rrobën e vet. A lejohet të falë namaz me këtë rrobë, pa e larë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk ka problem.”

Me këtë thënie kanë dhënë fetva të gjithë fukahatë.

Qeni dhe derri

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për qenin. Ai tha: *“I ndyrë, është papastërri, nuk merret abdes me ujin prej enës ku ka pirë qeni. Këtë ujë derdhe dhe enën laje në fillim me baltë dhe pastaj laje mirë me ujë.”*

Është pyetur djali i tij, Imam Kadhim (Paqja qoftë mbi të!) se si të veprohet me enën ku ka pirë ujë derri. Ai ka thënë: *“Laje shtatë herë.”*

Me këtë thënie, fukahatë kanë dhënë fetva dhe s’kanë përjashtuar prej papastërtisë as pjesët e qenit e as pjesët e derrit që s’kanë jetë, si: qimet, kockat, etj.

Por, kjo papastërri është e veçantë për qenin e për derrin e tokës dhe jo për qenin e për derrin e detit, sepse s’ka argumente që flasin për ndyrësinë e këtyre dy të fundit.

Vera

Transmetohet se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kur mbi rrobën tënde bie verë, ose pije tjetër dehëse, laje vendin ku rënë vera, natyrisht nëse e di vendin. Nëse nuk e di, atëherë laje gjithë rrobën. Në qoftë se ke falur namaz me rrobën mbi të cilën ka rënë verë, menjëherë përsërite namazin.”*

Pija dehëse, në origjinë, është lëng si edhe vera, por ka edhe pije dehëse të ngurta, siç është opiumi e hashashi. Shumica e fukahave janë të mendimit se vera është papastërri (nexhaset). Të gjithë fukahatë janë të mendimit se dehësi i ngurtë, si opiumi

është i pastër, megjithëkëtë fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me pijet dehëse të lëngshme, veç verës, si p.sh rakia. Disa fukaha kanë thënë se edhe ajo është papastër (nexhis), sepse Allahu nuk e ka bërë haram verën për shkak të emrit të saj, por e ka bërë haram për pasojën që ajo le, ashtu siç ka ardhur edhe në disa thënie të Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), prandaj edhe pija jo verë, që le pasojën e verës, është verë. Ka prej fukahave që kanë thënë se pija dehëse e lëngshme, jo verë, është e pastër, krahas pohimit për papastërtinë e verës, me gjithë kundërshtimin e emrit. Por dispozitat ndjekin emrat dhe jo shkaqet e nxjerra e pasojat. Fukaha të tjerë janë shprehur për pastërtinë e pijes së lëngshme dehëse jo verë, bazuar në teorinë e Sej'jid El Khùjit, i cili ka thënë se pija dehëse, jo verë, është e korrigjuar dhe nuk ka argument që vërteton se ajo është papastër, në një kohë kur rregulli nënkupton pastërtinë. Megjithëkëtë, për rezervë, praktikisht gjykimi jepet se pija dehëse, jo verë, është papastër, për shkak të rëndësisë së njohur që ka dispozita e verës.

Konstatohet se rezerva dhe veprimi i përhapur e i dëgjuar, nuk janë prej argumenteve të ligjit të fesë, madje as te Sej'jidi (*Allahu e mëshiroftë dëshmorin e dytë!*), kur ka thënë: *"Puna në kundërshtim me veprimin e dëgjuar, është formalizëm, kurse vendimi, sipas fjalës së të famshmëve, është formalizëm në shkallën sipërore."*

Kur zien rrushi

Fukahatë ndajnë mendim të përbashkët se, kur rrushin e ziejmw në zjarr, lëngu i tij është haram të pihet. Ai lëng bëhet hallall, kur avullon dy e treta e lëngut.

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Gjykimi për papastërtinë (*nexhasetin*) e lëngut të valuar të rrushit, është mjaft i përhapur te të mëvonshmit. Ne nuk e dimë ku është marrë ky gjykim, domethënë se nuk ka argument që vërteton se ai është i papastër. Dëshmori i dytë ka pohuar në librin e tij “Edh’dhikrà uel Bejàn” se ai nuk ka hasur në ndonjë argument që të vërtetojë se lëngu i valuar i rrushit është papastërti. Vetëm pak prej fukahave thonë se ai është papastërti. Dëshmori i dytë priret kah mendimi se lëngu i valuar i rrushit është i pastër. Këtë mendim e ka përforcuar edhe shehu ynë bashkëkohës, i cili mbështetet në kapjen pas kërkesës së bazës së shëndoshë dhe jo në atë që është antagonistë.”

Ne nuk dyshojmë se ai që është shprehur për papastërtinë e lëngut të valuar të rrushit, këtë lëndë ai e ka puqur me verën. Por aksioma thotë: Aneksimi është analogji, për pasojë identifikohet pastërtia, sepse pastërtia është bazë në të gjitha sendet, derisa të vërtetohet e kundërta.

Lëngu i elbit (*el fuk’kàu*)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për lëngun e elbit. A duhet pirë ky lëng? Ai është përgjigjur: “Atë mos e pi, sepse ai është verë e panjohur dhe, nëse ai bie në rrobën tënde, laje menjëherë rrobën.”

Lëngu i elbit (*el fuk’kàu*) merret prej elbit. Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Gjykimi për papastërtinë e lëngut të nxjerrë nga elbi është mjaft i përhapur te kolegët, domethënë te fukahatë.”

Në lidhje me këtë, ka një transmetim me përcjellës shumë të dobët.

Djersa e njeriut xhunub është prej gjërave haram

Autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Kolegët kanë mendime të ndryshme nëse është haram djersa e njeriut xhunub. Një pjesë e tyre kanë thënë se ajo është papastërti, ndërsa shumica e të mëvonshmëve, mbështetur në origjinë, kanë thënë se ajo është e pastër.”

Sej’jid El Hakijm, në librin “El Mustedrek”, ka thënë: “Shumica e dijetarëve të mëvonshëm, madje është e njohur (meshhur) në mesin e tyre, thonë se djersa e njeriut xhunub është e pastër.” Kurse El Hil’lij ka një pretendim kundër pastërtisë së kësaj djerse. Por ka edhe ndonjë që ka thënë se djersa e njeriut xhunub është papastërti, duke u referuar sa në një libër në një libër tjetër.”

Por aksioma është: Për çdo dyshim në papastërtinë e një sendi, ai send është i pastër, derisa të arrihet njohja e plotë se ai send është i papastër.” Por te ne nuk ka arritur kjo njohje e plotë, madje as edhe të ngjashme me të.

Ithtarët e librit

Është pyetur Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për të ngrënat e hebrenjve dhe të kristianëve. Ai ka thënë: “*S’ka problem, kur janë prej të ngrënave tuaja.*”

Transmetohet se Zekerijja bin Ibrahim ka thënë: *“Isha kristian dhe u bëra mysliman. Vajta dhe i thashë Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “Njerëzit e shtëpisë sime janë në fenë kristiane dhe unë jam së bashku me ta, në të njëjtën shtëpi, ha në të njëjtat enë së bashku me ta.”*

Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) më tha: *“A hanë ata mish derri?”*

I thashë: *“Jo.”*

Atëherë ai foli: *“S’ka problem.”*

Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*), nipit të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i është thënë: *“Në shërbimin tënd ke një shërbyese kristiane dhe ti e di se ajo është kristiane. Ajo as nuk merr abdes dhe as nuk lahet që të pastrohet prej xhunubllëkut.”*

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: *“S’ka problem, ajo lan duart.”*

Në lidhje me këtë çështje ka edhe transmetime të tjera.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se është i papastër (*nexhis*) ai që mohon Krijuesin e Lartësuar. Nuk ka asnjë dyshim se qeni e derri janë më të ndershëm e më të respektuar se ky mohues, madje edhe urina e feçet janë më të pastra se mohuesi.

Në lidhje me ithtarët e librit, që janë hebrenjtë dhe kristianët, si dhe të tjerë që i aneksohen këtyre, siç janë mexhusët (adhurues të zjarrit), kemi dy thënie të njohura të fukahave: E para thotë se ata janë të papastër. Kjo është thënia e pjesës më të madhe të fukahave. Thënia e dytë pohon pastërtinë e tyre. Këtë thënie e dytë e kanë mbështetur disa nga të mëparshmit dhe një grup prej

të mëvonshmëve, ndër të cilët autori i librit “El Medàrik”, Es’sebzevàrij dhe të tjerë të kamufluuar.

Thënia më e re, që pohon papastërtinë e ithtarëve të librit, përbën një problem shoqëror për shi’at, pasi ka krijuar një greminë të ashpër e të thellë mes tyre e mes të tjerëve. Për më tepër, i ka vënë shi’at në vështirësi e në ngushticë nga të gjitha anët, veçanërisht kur ata udhëtojnë në një vend kristian, si p.sh. në perëndim, ose janë në një vend ku jetojnë kristianë siç është Libani, duke pasur parasysh se në ditët e sotme globi tokësor është bërë një shtëpi e vetme, në të cilën banon e gjithë familja njerëzore.

Pa dyshim që thënia për pastërtinë e ithtarëve të librit përputhet plotësisht me qëllimet lehtësuese e me tolerancën e ligjit të fesë islame. Është e qartë se ai që shprehet për këtë thënie, nuk ka nevojë për argument, sepse kjo thënie është në përputhje të plotë me bazën e ligjit të fesë, me logjikën, me traditën e me natyrën. Kurse ai që shprehet se ithtarët e librit janë të papastër, është i detyruar të vërtetojë thënien që mbështet, prandaj ai nxjerr argumente nga disa çështje:

E para - konsensusi unanim (el ixhmàu)

Përgjigjja jonë për këtë çështje është: Nuk ka unanimitet aty ku ka kundërshtim, edhe sikur ne t’ia dorëzojmë ekzistencën e unanimitetit ecjes krahas tij dhe për të qenë konform me të. Në të vërtetë, unanimiteti është argument, kur zbulon një mendim të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Por ne e dimë se unanimistët janë mbështetur në disa njoftime, ose për rezervë në më shumë se një njoftim. Por aksioma thotë: Dituria me zbulim prej mendimit

të Imemit nuk qëndron bashkë me mundësinë, kurse unanimistët mbështeten në shumë njoftime e në rezervën. Por, kur dituria e arritur me këtë zbulim, me unanimitet, është në shkallë të barabartë ekzistenca dhe mosekzistenca e saj.

Argumenti i dytë që kanë nxjerrë ata që prononcohen për papastërtinë e ithtarëve të librit, janë njoftimet, që kanë mbështetës të saktë dhe janë të qarta si argumente.

Përgjigjja jonë për njoftimet: Përkrah këtyre njoftimeve ka njoftime të kundërta, më të qarta si argument, më shumë si numër dhe jo më pak të mbështetura se të parat. Prandaj marrja e njoftimeve që flasin se ithtarët e librit janë të papastër, pa marrë edhe njoftimet që tregojnë pastërtinë e tyre, do të thotë dhënia përparësi e njoftimit të dobët ndaj atij që është më i fortë dhe e njoftimit të ulët ndaj atij që është më i lartë.

Sikur t'i referohemi barazimit dhe ekuivalencës ndërmjet njoftimeve që flasin për pastërtinë dhe për papastërtinë e ithtarëve të librit, do të kthehemi në bazën e pastërtisë së tyre, bazuar mbi thënien për rënien e dy të kundërtave njëherësh. Gjithashtu, bazuar në thënien për përzgjedhjen mes dy të kundërtave, ne kemi pëlqyer njoftimet që flasin për pastërtinë e ithtarëve të librit.

Për sa i përket atij që thotë se duhet rezerva për të shkuar te thënia më e dëgjuar që flet për pastërtinë e ithtarëve të librit, përgjigjja jonë e përsëritur është: Rezerva është gjë e mirë, kurse thënia e përhapur dhe e dëgjuar mbështetet dhe përkrahet. Por këto të dyja nuk janë prej katër argumenteve.

Bazuar nga sa u tha, s'ka asnjë argument tekst, as mendim të përbashkët të fukahave e as argument logjik, që të tregojë papastërtinë e ithtarëve të librit.

Vazhdimisht kujtoj se profesori gjatë mësimit na tha tekstualisht e germë për germë: "Ithtarët e librit janë të pastër shkencërisht, domethënë, teorikisht dhe janë të papastër praktikisht." Edhe unë i jam përgjigjur, gjithashtu, germë për germë: "Ky pohim është tepër i qartë se gjykimi për papastërtinë është një punë pa dituri."

Qeshi profesori, qeshën edhe shokët e klasës dhe me kaq mbaroi çdo gjë.

Jam bashkëkohës me tre dijetarë të mëdhenj, prej atyre që japin sentence (fetva) fetare dhe në fushën e traditës, gjithashtu, ata janë pikë referimi. Me të parin jam takuar në qytetin Nexhef El Eshref, në Irak, shejku Muhamed Rida Àl Jàsijn, me të dytin jam takuar në qytetin Kum të Iranit, Sej'jid Sadrudijn Sadr dhe me të tretin jam takuar në Liban, Sej'jid Muhsin El Emijn. Që të tre kanë dhënë sentencën (fetvanë) për pastërtinë e ithtarëve të librit, por këtë ia thoshin në formë sekreti vetëm atij që kishin besim dhe asnjëherë nuk e thanë hapur, ngaqë kishin frikë prej atyre që marrin zjarr shpejt, megjithëse Jasijni ishte më trimi i të gjithëve. Unë e di mirë se shumë prej fukahave bashkëkohës, si edhe prej atyre që jetuan para bashkëkohësve, janë shprehur për pastërtinë e ithtarëve të librit, kur ata pastrohen me ujë, ashtu siç pastrohet myslimani, kur i ndoten gjymtyrët me papastërti. Ai që pohon papastërtinë e rastësishme të ithtarëve të librit, është mbështetur në njoftimin që u përmend më sipër dhe i transmetuar prej Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*) se kristiania lan duart e saj, gjithashtu,

është mbështetur në “Sahijhun” e Ismailj bin Xhàbirit, në të cilën thuhet: “Në të vërtetë, në enët e tyre (të ithtarëve të librit) ka verë e mish derri.”

Ky është një justifikim i hapur, për të qëndruar larg ithtarëve të librit, për shkak të kontaktit të tyre të drejtpërdrejtë me gjëra që ne i numërojmë papastërti, si: qenin, derrin e verën, apo gjërave të tjera të ngjashme me këto.

Në tërësi, feja e Allahut është më e gjerë se kaq dhe, ashtu siç ka thënë Imami, khavarixhët bënë shtrëngime të forta kundër vetes së tyre (Allahu i shtrëngoftë!), kurse Islami është fe e mirësisë dhe e drejtësisë, është fe e lehtësimit dhe e logjikës. Për sa i përket ekzistencës së disa njoftimeve, që flasin për papastërtinë e ithtarëve të librit, veprimin me këto hadithe e kanë lënë aq shumë nga dijetarët e Ehli Sunetit dhe shi’ave, sa nuk numërohen. Dijetarët e Ehli Sunetit ndajnë një fjalë të përbashkët për pastërtinë e ithtarëve të librit, krahas asaj që është transmetuar prej Tha'lebeh El Khashenij, i cili tregon: “Unë i thashë të Dërguarit të Allahut se ne jemi në tokën e ithtarëve të librit, a të hamë prej enëve të tyre?” Ai tha: “Mos hani në ato enë, por, nëse nuk gjeni enë të tjera, atëherë i lani enët dhe pastaj hani në to.”

Ana e jashtme e hadithit tregon papastërtinë, pasi urdhëron për të mos ngrënë në enët e tyre, përveç rasteve kur s’ka enë të tjera, pra, vetëm nga nevoja, madje krahas nevojës, i Dërguari i Allahut urdhëroi që të lanin enët. Megjithëkëtë ata e transportuan këtë kuptim në një pozicion tjetër.

Mund të thuhet: Papastërtia e ithtarëve të librit është një gjë dhe papastërtia e enëve të tyre është gjë tjetër.

Unë kam thënë: Patjetër, por mund të thuhet: Papastërtia e enëve, në të vërtetë, është më e fortë dhe për këtë shkak ata, fukaha të shí'ave që janë shprehur për papastërtinë e ithtarëve të librit, kanë dhënë fetvanë me pastërtinë e enëve të tyre.

* * *

ÇESHTJE TË NDRYSHME

Mohuesi i domosdoshmërisë

Shumica e dijetarëve të fesë ndajnë një mendim të përbashkët: Kush mohon një dispozitë të domosdoshme të Islamit, pa e marrë në konsideratë që ajo është e domosdoshme, ai është i papastër. Kurse Sej'jid El Kuj'ji thotë në librin "Et Tenkijh": "Ai është i pastër për shkak të mungesës së argumentit që tregon, se ai është i papastër (*nexhis*)."

Kjo është e vërteta, derisa ky mohues shqipton dy dëshmitë dhe nuk ka pasur qëllim të përgënjeshtrojë të Dërguarin më të madh (Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të e mbi familjen e tij!).

Fëmija i mohuesit

Pjesa më e madhe e fukahave kanë thënë se fëmija i mohuesit është papastërti (*nexhis*), ai ndjek dy prindërit e tij.

Autori i librit "El Medàrik" ka thënë: "Po, ai është i pastër, sepse emri mohues nuk është i drejtë të thuhet për këtë fëmijë.

Thënia se ai është papastërti, nuk mbështetet në ndonjë argument.”

Dhe kjo është e vërteta, sepse dispozitat ndjekin emrat.

Zmadhuesi

Kush beson se një rob prej robve të Allahut krijon, ose furnizon me ushqim, ose ai ka fuqi të bëjë gjëra që ka fuqi të bëjë vetëm Allahu, ai është zmadhues, është politeist (*mushrik*), është i papastër (*nexhis*). Me këtë njeri, me fjalën e përbashkët të fukahave, as nuk hahet ushqim, as nuk bëhet martesë e as nuk trashëgohet.

Shfaqësi i armiqësisë

Kur shfaq armiqësi kundër Ehli Bejtit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose vetëm kundër njërit prej pjesëtarëve të Ehli Bejtit, ai është i ndyrë (*rixhsun*), është i papastër (*nexhisun*), sepse armiqësia ndaj familjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është armiqësi ndaj të Dërguarit dhe, armiqësia ndaj të Dërguarit është armiqësi ndaj vetë Allahut.

Mbetja nga uji ku kanë pirë kafshët (es'su'ru)

Fadli ka thënë: “Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për mbetjen nga uji ku pa pirë, macja, delja, lopa, gomari, kali, mushka dhe

egërsirat e bishat. Nuk lashë asgjë pa e pyetur për këto kafshë." Ai tha: "S'ka problem."

Por kur unë i përmenda qenin, ai menjëherë tha: "Qeni është i ndyrë (rixhsun), është papastërti (nexhis)."

Fjala e arabishtes "es'su'ru" është uji që ka mbetur, pasi në atë ujë kanë pirë kafshët. Dispozita për këtë ujë që ka tepruar në enë, është si dispozita për kafshën që ka pirë në të: Nëse kafsha është papastërti, edhe uji i mbetur është papastërti dhe, nëse kafsha është e pastër, edhe uji i mbetur është i pastër.

Dyshimi dhe ngurrimi

Këtu kemi disa çështje që kanë lidhje me dyshimin:

1- Kur ne dyshojmë se ky ujë i mbetur është nga mbetja e një kafshe që është e pastër, ose nga mbetja e një kafshe që është papastërti, si bazë, ky ujë është i pastër.

2- Kur ne dyshojmë, nëse ky njeri është mysliman, apo ai është jomusliman dhe, duke gjykuar se jomuslimani është papastërti (*nexhaset*), si bazë, uji është i pastër, por ne nuk kemi dyshime për shenja të tjera, të cilat patjetër duhet të jenë të vërtetuara në ligjin e Islamit.

3- Kur dyshojmë se ky ujë i mbetur ka ngjyrë të kuqe dhe dyshojmë, nëse ngjyra e kuqe është prej gjakut ose jo, uji i mbetur është i pastër.

4- Kur ne e dimë se ai është gjak dhe dyshojmë se është gjak kafshësh me gjak të rrjedhshëm, pra, është papastërti (*nexhis*).

Nëse është prej ndonjë kafshe tjetër, pra, është pastërti, si bazë, uji është i pastër.

5- Kur ne dyshojmë që kafsha që ka pirë në atë ujë është *xhel'lâl*, ose ajo nuk është e këtillë, si bazë, uji i mbetur është i pastër.

Nuk është detyrë studimi dhe pyetja për ndonjë gjë nga këto çështje. Gjithashtu, nuk është detyrë që as i pyeturi të përgjigjet.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo send është i pastër, derisa të mësosh se ai send është i ndyrë, ose e ke ditur më parë se ai është send i ndyrë, kurse për sendet që nuk kemi dijeni, ai send nuk është i ndyrë.”

Transmetohet se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Nuk shqetësohem për urinën time që më prek mua, ose për ujin kur nuk kam dijeni.”

Është mjaft i bukur transmetimi në lidhje me këtë çështje. Po e tregojmë shkurtimisht ngjarjen: Dy burra po ecnin së bashku në rrugë. Mbi këta të dy ra diçka që kulloi prej ullukut. Në çast, njëri prej këtyre dy burrave, foli: “Ore, ti i zoti i ullukut, ky uji yt është i pastër apo është i papastër (nexhis)?” Shoku i tha: “O i zoti ullukut, mos na njofto!”

* * *

DISPOZITAT E PAPASTËRTIVE

Rrugët e vërtetimit të papastërtisë (En Nexhasetu)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Të gjitha sendet për ty janë hallall, derisa të mësosh se ai send është haram dhe ti vetvetiu heq dorë prej atij sendi. Kjo është e ngjashme me një rrobë që ti ke blerë, por rroba mbase është e vjedhur, ose gruaja që është në kurorën tënde, është motra jote, ose është motra jote për qumësht. Të gjitha sendet janë të tilla, derisa për ty të bëhet e qartë e kundërta, ose për atë të gjendet argumenti.”

Në praktikë, vërtetimi për pastërtinë s’ka nevojë për argument vetëm për shkak të dyshimit se një send mund të jetë papastërti (nexhaset), por është i mjaftueshëm gjykimi që ai send është i pastër. Dyshimet janë prej atyre njoftimeve, për të cilat thuhet se transmetimi i dobët qëndron mbi transmetimin më të fortë, por edhe sikur të jetë mundësia që 90% e sendit është papastërti dhe vetëm 10% e tij është e pastër, përparësia i takon që dhjetë përqindëshi të jetë mbi nëntëdhjetë përqindëshin.

Papastërtia (*nexhaseti*) e një sendi nuk vërtetohet ndryshe veçse me argument, me anë të shqisave, me anë të shoqërimit dhe

me anë të argumentit të ligjit të fesë. Kjo është plotësisht prej atyre çështjeve për të cilat ka treguar Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) me fjalën e tij të mësipërme: “...të gjitha sendet janë të tilla, derisa për ty të bëhet e qartë e kundërta, ose për atë të gjendet argumenti”, domethënë, kur për ty papastërtia del në shesh me anë të shqisave, ose kur dëshmojnë dy dëshmitarë.

Njoftimi i vetëm

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se njoftimi i vetëm i besueshëm merret në vënien e dispozitave dhe, kur njoftimi është transmetuar prej të pagabueshmit se kjo gjë është hallall dhe kjo tjetra është haram, njoftimi është argument që merret në konsideratë. Gjithashtu, fukahatë ndajnë në fjalë të përbashkët, se e drejta nuk vërtetohet vetëm me thënien e njoftimit të vetëm në kapitullin e gjykimit dhe të armiqësisë, por fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse vërtetohen apo nuk vërtetohen çështjet objekt studimi me fjalën e këtij njoftimi të vetëm në kapitujt e tjerë të gjykimit përveç kapitullit të armiqësisë. Sikur njoftimi i vetëm të thotë: Kjo gjë është papastërti (*nexhis*) dhe askush nuk e ka kundërshtuar në këtë pohim.”, a do të jetë ky pohim argument?

Shumica e dijetarëve të fesë anojnë kah mendimi për të mos u mbështetur në njoftimin e vetëm për çështjet, madje edhe kur janë të shoqëruara me armiqësi.

Shejkh El Hamedànij, në librin “El Misbàhu”, thotë: “Më e fuqishme është mbështetja në njoftimin e vetëm dhe marrja e tij sipas përfundimit që kanë ndërtuar të mençurit, siç është për

shembull e vërtetuar ligjërisht mbështetja e besueshme për thirrjen e Ezanit, për të njoftuar hyrjen e kohës për faljen e namazit.”

Në të vërtetë, njoftimi i vetëm nuk merret në konsideratë në çështjet objekt studimi, me përjashtim të rasteve kur ai është shkak për siguri e besueshmëri shpirtërore dhe, kur me njoftimin e vetëm, shpjegohet siguria.

Bërësi i veprimit

Kur bërësi i veprimit, si gruaja, shërbyesi e të tjerë si këta, njoftojnë se ky send është i papastër, a merret në konsideratë fjala e tij?

Përgjigje:

Natyrisht që merret, sepse argumenti është udha e fukahave dhe ndërtesa e të mençurve.

Papastërtia dhe e ndotura me papastërti

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për plagën: “Si të veprojnë ai që ka plagë?” Ai është përgjigjur: “Lani pjesën rreth saj.”

Gjithashtu, është pyetur për një burrë, i cili urinon në një vend ku s’ka ujë dhe e fshin penisin me gur, por nga pikimi i

urinës i është lagur vetë penisi dhe kofsha. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Lan penisin dhe kofshën.*”

Kurse Imam Kadhim (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për burrin që ecën mbi feçe të thata dhe këmbët e rrobat kanë prekur ato. A duhet të të hyjë ky njeri në xhami e të falë namaz, pa larë pjesët që kishin takuar papastërtinë e lartpërmendur? Ai tha: “*Nuk ka problem, nëse ato janë të thara.*”

Në lidhje me këtë çështje kemi njoftime të tjera:

Papastërtia (*nexhaset*) konsiderohet papastërti, kur ajo është nga lloji i ndyrësive, që do të thotë se nuk është e mundur që ajo të hiqet në çast, siç janë: qeni, derri, urina e gjaku, prandaj thuhet: Ajo që është papastërti në vetvete, nuk ndryshon, kurse sendi i ndotur me papastërti, në vetvete, është i pastër, por është ndotur nga ekspozimi ndaj papastërtisë, si për shembull, dora ndotet me gjak ose me urinë.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur mbi sendin e pastër kalon një papastërti, ose atë e prek papastërtia që është në vetvete papastërti, ai send bëhet i papastër.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se është haram ngrënia e papastërtisë dhe e sendit të ndotur me papastërti. Gjithashtu, është haram edhe pirja e këtij sendi të papastër, si dhe e sendit të ndotur nga papastërtia. Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se është detyrë të pastrohet rroba e trupi prej papastërtisë (*nexhasetit*) për të falur namaz e për të bërë tavaf në Qabe, qoftë kur tavafin e bën për vete ose për një tjetër.

Çfarë i falet njeriut për kryerjen e namazit?

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka plagë që i kullon vazhdimisht. Si do të falë namaz ky burrë? Ai iu përgjigj: “*Ai e fal namazin, edhe nëse gjaku i rrjedh.*”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “*Nuk ka problem që burri të falë namaz, kur në rrobën e tij ka aq gjak sa nuk e arrin peshën e një dirhemi.*”

Për të gjitha këto, fukahatë kanë rënë në një mendim të përbashkët, se ky njeri është i falur në namaz prej gjakut që i del nga plagët ose nga puçrrat e shpërndara nëpër trup, edhe atëherë kur gjaku i rënë në rrobat e tij ose në trup është shumë ose pak, me kusht që plaga vazhdon të jetë plagë e hapur e pashëruar. Gjithashtu, burri është i falur edhe nga qelbi i ndotur me gjak, si dhe nga rrjedhjet e vrullshme të majasëllit.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për faljen prej gjakut, kur gjaku i dalë, në tërësinë e tij, nuk është më shumë se pjesa e sipërme e nyjës së gishtit tregues, edhe nëse në trup ai s’ka as plagë e as puçrra, me kusht që ky gjak të mos jetë gjak menstrual (*hajdhun*), as gjak nga *istihadhah*¹, as gjak nga lehonja, (*nifas*), as gjak prej sendesh që janë të ndyrë vetvetiu, si qeni, derri e cofëtina, madje as gjak prej kafshës që nuk i hahet mishi. Gjithashtu, është kusht që ky gjak të jetë në rrobë dhe nuk vlerësohet të jetë diku tjetër përveç rrobës.

¹ Istihadhah është gjaku që del nga femra pas menstruacioneve.

Papastërtitë me të cilat nuk mund të falet namaz

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur mbi njeriun bie, ose ai ka me vete papastërti me të cilat nuk mund të falë namaz, nuk ka problem që ai të falë namaz, edhe nëse papastërtia e rënë është feçe dhe ka të ndotur qeleshen, lidhëset e mbathjeve, kokën e penisit, pantoflat e të ngjashme me këto.”

Për të gjitha këto, fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se sendet që mbath njeriu dhe pa të cilat ai s’ka mundësi të ecë, por ai send është i papastër, namazi i falur me këtë send, është i vlefshëm, me kusht që sendi të mos jetë prej pjesëve të cofëtinës e as prej kafshës e cila vetvetiu është e ndryrë, si qeni e derri.

Pastrimi i xhamive

Transmetohet prej Profetit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Largojeni papastërtinë (nexasetin) prej xhamive tuaja.”

Fukahatë kanë një mendim të përbashkët se, kush shikon një papastërti në xhami, ka detyrë ta heqë atë menjëherë. Kjo është detyrë në shkallën e *farzit kifâjeh* (kur e kryen njëri, konsiderohet se e kanë kryer të gjithë myslimanët).

Gjithashtu, është detyrë që papastërtia të largohet nga Libri i Allahut, nga kapaku e nga faqet e tij, pasi qëndrimi i papastërtisë në këtë libër përbën shkelje të gjërave të shenjta që ka vënë Allahu.

A bëhet i papastër sendi i ndotur me papastërti?

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që urinon, por nuk ka ujë, prandaj ai e fshin penisin në mur. Ai është përgjigjur: “Çdo send i thatë, është i pastër.”, domethënë, ai nuk ndotet prej papastërtisë.

Është pyetur për një burrë që, në enën e tij, gjen një mi, por me këtë ujë ai ka marrë abdes disa herë, ose me këtë ujë ka bërë gusël, ose ka larë rrobat e veta. Për më tepër, miu ishte i rrjepur. Ai është përgjigjur: “Nëse ai e ka parë miun para se të bënte gusël, ose para se të merrte abdes, ose para se të lante rrobat e veta dhe, të gjitha këto punë ai i ka bërë, pasi e ka parë miun në enë, ai ka detyrë të domosdoshme të përsërisë larjen e rrobave, të lajë çdo gjë që është prekur prej këtij uji dhe të rimarrë abdes e të përsërisë faljen e namazit.”

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, që papastërtia ndot me papastërti, por ata kanë thënë fjalë të ndryshme në lidhje me sendin e ndotur nga papastërtia: A është apo nuk është i papastër ky send?

Fjala e parë: “Papastërtia ndot me papastërti”, ka kuptimin: Sikur të arrihet kontakti i ndërsjellë mes një sendi të pastër, si trupi yt dhe mes një sendi të papastër, vetvetiu, si për shembull qeni dhe njëri prej këtyre sendeve ka lagështirë dhe lagështira kalon prej qenit në trupin tënd, me fjalën e përbashkët të fukahave, trupi është bërë i papastër. Por, nëse bëhet kontakti mes trupit tënd e qenit dhe secili është i thatë, për pasojë lagështira nuk kalon prej të papastrit në të pastrin, me fjalën e përbashkët të fukahave, trupi yt mbetet në pastërtinë e tij.

Fjala e dytë: “A është i papastër sendi i ndotur me papastërti?” Sikur të supozohet se mbi trupin ka kaluar një papastërti, që në vetvete është papastërti, në mënyrë të prerë, trupi është bërë i papastër. Nëse më pas ky trup që u bë i ndotur me papastërti, bie në kontakt me një trup tjetër me lagështirë, a ndotet me papastërti ky trup tjetër, apo ai mbetet në pastërtinë e tij? Padyshim që i pastërti ndotet me papastërti, menjëherë kur bie në kontakt me një papastërti. Por çështja shtrohet, nëse ai ndotet me papastërtinë ose jo, kur kontakti është me ndërmjetësi.

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë janë ndarë në tri grupe:

Grupi i parë ka dhënë fetvanë (sentencën) se sendi i ndotur me papastërti, ndot nga ana e tij me papastërti. Ndër të tjera, merret mendim i saktë, ajo që ne kemi cituar prej Imamit: “Lahet çdo send që ka prekur ky ujë dhe përsëritet marrja e abdesit e falja e namazit.”

Grupi i dytë ka dhënë fetvanë për pastërtinë dhe mosndotjen me papastërti. Sej'jid El Khuji, në pjesën e dytë të librit “Et Tenkijh”, thotë: “El Hil'lij dhe homologët e tij janë shprehur se trupat e ndotur me papastërti nuk ndotin me papastërti, por nga fjala e tij e qartë rezulton se mosndotja me papastërti ishte prej postulateve të asaj kohe. Kurse dijetarët e mëparshëm, në mënyrë absolute, nuk ishin ndeshur me këtë çështje, prandaj asnjëri prej tyre s’ka dhënë fetva që sendi i ndotur me papastërti është i papastër, pavarësisht se ata e ndeshnin këtë fakt ditë e natë. Atëherë, si pretendon konsensusi i dijetarëve për papastërtinë e sendeve të ndotura nga papastërtitë?”

Më pas, Sej'jid El Khuji ka thënë: “Aga Riza El Isfehanej ka thënë: “Dispozita për papastërtinë është nga të rejat e të mëvonshmeve dhe ne nuk kemi gjetur ta këtë thënë këtë ndonjëri prej brezit të parë të myslimanëve.

Grupi i tretë ka heshtur rreth kësaj çështjeje dhe nuk ka dhënë feta, as negative e as pozitive. Gjithashtu, edhe ne këtu do të heshtim për të dhënë fetva së bashku me ata që kanë heshtur për këtë çështje, krahas asaj që është e ditur se ne jemi të motivuar nga zakoni e edukata për të mënjanuar sendin e ndotur dhe vëmë në dukje kontaktin e sendit me lagështirën.

* * *

PASTËRTIA E TRUPIT

DHE E RROBAVE PËR TË FALUR NAMAZ

Kushtet e namazit

Në kapitullin e papastërtive (*En Nexhâsat*) përmendëm transmetimet që tregonin detyrën për zhdukjen e papastërtisë. Autori i librit “El Medârik”, ka thënë: “Është detyrë e domosdoshme (*farz*) zhdukja e papastërtisë (*nexhasetit*) prej rrobave e prej trupit për të falur namaz e për të bërë tavaf, kur namazi e tavafi janë farz dhe papastërtia është e llojit që njeriu nuk është i falur prej saj, edhe kur ai s’ka rrobë tjetër përveç rrobës së ndotur me papastërti. Fukahatë (juristët) ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me domosdoshmërinë e pastërtisë së rrobave e të trupit për të falur namaz. Njoftime të shumta, që flasin për çështjen në fjalë, tregojnë për larjen e rrobave e të trupit prej papastërtive, duke ditur se larja e trupit nuk është detyrë (*farz*) për atë vetë, por për të kryer adhurimin.”

Mbi këtë fakt, ne bëjmë komentin se namazi, në kuptimin e lidhjes së Allahut me njeriun, është një audiencë e lartë hyjnore, prandaj për këtë audiencë është e domosdoshme përgatitja

paraprake me nijet të pastër, me zbukurim, me pastrimin e trupit e të rrobave dhe respektimin e përpiktë të kohës së caktuar.

Falja namaz me papastërti, pa e ditur

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë, që shikon gjak në rrobën e vëllait të tij që është duke falur namaz. Çfarë duhet të bëjë ky burrë? T'i flasë vëllait të tij, që ta ndërpresë namazin? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk e shqetëson atë, derisa ai të mbarojë faljen e namazit.”

Kush shikon një njeri që po fal namaz dhe në rrobën ose në trupin e atij njeriu ka papastërti (*nexhaset*), me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, ai nuk e ka detyrë ta njoftojë këtë njeri për papastërtinë e as t'i tërheqë atij vëmendjen. Madje dijetarët e fesë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se shikuesi bën mëkat ndaj xhematit me këtë burrë që po fal namaz, kur është siguruar se ai nuk ka dijeni për papastërtinë që mbart, por jo kur burri që fal namaz e ka ditur, por më pas kjo gjë i ka dalë nga mendja dhe ka harruar.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse në rrobën e burrit bie gjak dhe ai fal namaz pa e ditur, ai nuk e përsërit namazin dhe, kur ai e ka ditur këtë fakt para se të fillonte faljen e namazit, por harroi dhe fali namazin me rrobën e ndotur me gjak, ai ka detyrë të përsërisë faljen e namazit.”

Kush fal namaz me papastërti (*nexhaset*), duke e ditur se është me papastërti, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, namazi i këtij njeriu nuk është i vlefshëm. Por, kur ai fal namaz

me papastërri, pa pasur dijeni për dispozitën e ligjit të fesë, në lidhje me këtë çështje, përsëri me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, namazi i tij nuk është i vlefshëm.

I ngjashëm me këtë rast është edhe rasti kur ai e di që papastërtia ishte gjak, por nuk di se për të falur namaz është detyrë zhdukja e papastërtisë prej rrobës e prej trupit. Kurse ai që fal namaz me papastërri në rrobë e në trup, duke e ditur dispozitën e ligjit e të fesë dhe duke mos ditur situatën, me fjalën e përbashkët të të gjithë dijetarëve të fesë, namazi i këtij njeriu është i vlefshëm. I ngjashëm me këtë shembull është rasti kur burri e di detyrën për zhdukjen e gjakut e të papastërtive të tjera prej trupit e prej rrobave për të falur namaz, por ai nuk e di që trupi ose rroba e tij janë të ndotur me papastërri dhe e mëson faktin se ishte me këto papastërri vetëm pasi fali namazin. Kush e di dispozitën dhe objektin e çështjes, por më pas harron dhe fal namaz, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, namazi i këtij njeriu është i pavlefshëm. I ngjashëm me këtë shembull është rasti kur burri shikon gjak në rrobat e tij dhe ka dijeni për dispozitën që e bën detyrë të domosdoshme zhdukjen e papastërtisë, por atij i del nga mendja kjo gjë dhe fal namaz.

Sekreti i këtij sqarimi qëndron në atë se harruesi është njëri prej individëve të botës, prandaj ai nuk është njeri me pengesë (i pajustificuar). Nëse ai nuk ka dijeni për objektin e çështjes, ai është me pengesë (i justifikuar). Ky njeri nuk ka detyrë as të studiojë e as të saktësojë, kurse ai që nuk di dispozitën, është i pajustificuar dhe ka detyrë të studiojë e të mësojë, me përjashtim të rastit kur ai s'ka aftësi mendore e as mundësi për të mësuar e

për të kuptuar dhe është i pamundur deri në atë shkallë, sa mund të barazohet me kafshët.¹

I detyruari nga nevoja

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që bëhet xhunub në rroba, ose atij i ka rënë urina në rroba dhe nuk ka me vete rrobë tjetër përveç kësaj rrobe. Me se duhet të falet ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Ai të falë namaz me këtë rrobë, kur është i detyruar nga nevoja që të veprojë kështu.*”

Është pyetur djali i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*), për një burrë që s’ka asnjë rrobë në trup dhe erdhi koha për të falur namazin, ndërkaq ai gjen një rrobë, gjysma e së cilës është me gjak, ose ajo është e gjitha me gjak. A të falë namaz ai me këtë rrobë, apo të falë namaz ashtu, lakuriq, siç është? Imam Qazimi (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Nëse ai gjen ujë, le ta lajë atë. Nëse ai nuk gjen ujë, le të falë namaz me atë rrobë dhe të mos falë namaz lakuriq.*”

¹ Është e habitshme ajo që kam lexuar në lidhje me këtë kapitull, në librin “El Furûku” të autorit El Kirâfij, në vëllimin 4, në faqen 93. Tekstualisht e gërmë për gërmë, thuhet: “Theksohet se, me gjithë injorancën, në të vërtetë, ai ka bërë mëkat në doktrinën ... sikur ai të ishte munduar dhe të kishte lënë kohë më të gjerë për të hequr injorancën e tij, ai është mëkatar mohues. Sipas thënies më të përhapur në medh’hebet, domethënë në medh’hebet e Ehli Sunetit, ai do të jetë përgjithmonë në zjarr. Pavarësisht se hulumtimin (*ixhtihâdin*) e ka çuar deri në kufirin e tij, për pasojë, injoranca për atë është bërë domosdoshmëri e atillë që ai s’ka mundësi ta heqë nga vetja. Por edhe kështu, ai nuk është i justifikuar, derisa kjo paraqitje, sipas asaj që besohet, të futet në grupin e obligimeve më tepër nga sa ai ka fuqi e mundësi të kryejë.”

Kur një burrë që fal namaz, ka një rrobë të ndotur me papastërti dhe nuk ka rrobë tjetër përveç kësaj rrobe të ndotur, gjithashtu, s'ka mundësi as të pastrojë rrobën e as ta heqë dot nga trupi, për shkak të kohës së ftohtë, ky burrë fal namazin me këtë rrobë dhe namazi i tij është i vlefshëm. Gjithashtu, bazuar në substancën e njoftimit të parë: "Kur për këtë njeri të jetë hequr pengesa", ai nuk ka detyrë të përsërisë namazin as brenda kohës e as pasi ka kaluar koha e faljes së namazit (kada).

Kur burri s'ka mundësi të pastrojë rrobën, por ka mundësi ta heqë atë nga trupi dhe fal namazin lakuriq, mbështetur në substancën e njoftimit të dytë, ai le të falë namazin me rrobën e papastër dhe namazi i tij është i vlefshëm. Për këtë mendim është shprehur edhe autori i Urvetul Uethekij, Sej'jid El Hakijm dhe Sej'jid El Khuji.

Përngjasimi i sendit të pastër me sendin e papastër

Është pyetur Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), për një burrë që ka dy rroba. Njëra prej këtyre dy rrobave është ndotur me urinë, por ai nuk e di se cila prej këtyre dy rrobave është e ndotura, ndërkaq hyn koha për faljen e namazit dhe ai ka frikë se mos kalon koha e faljes, gjithashtu, ai nuk ka as ujë. Si të veprojë ky njeri?

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "*Ai fal namaz me të dyja rrobat.*"

Domethënë: Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, ai e përsërit namazin dy herë, njëherë e fal namazin me njërën rrobë

dhe herën e dytë e fal namazin me rrobën tjetër, sepse ai e di që e ka detyrë të falë namazin, duke qenë i pastër. Veç kësaj, ai është i fuqishëm dhe për rezervë të falë namazin dy herë, prandaj për atë është detyrë (*farz*) edhe falja e namazit për rezervë, sepse dituria për punën e shenjtë kërkon diturinë e plotë.

A ta zhdukë papastërtinë apo të marrë abdes?

Kur burri ka aq ujë, sa i mjafton vetëm për të marrë abdes dhe në trup ka papastërti (nexhaset), a duhet të marrë abdes dhe të falë namaz me trupin e ndotur me papastërti, apo të zhdukë papastërtinë me ujë dhe të bëjë tejemum për të falur namazin?

Përgjigje:

Ai të zhdukë papastërtinë dhe të bëjë tejemum për të falur namazin, sepse për abdesin ka zëvendësues, që është tejemumi, por s'ka zëvendësues për zhdukjen e papastërtisë.

* * *

PASTRUESIT

Pastruesit janë përbërësit që zhdukin papastërtinë prej sendeve të tjera dhe janë disa lloje:

Uji

Pastruesi i parë është uji dhe është bazë e domosdoshme e fesë.

Është kusht që për pastrimin me ujë, në fillim dhe para çdo gjëje, të zhduket vetë papastërtia (*nexhaseti*). Nuk sjell asnjë dëm, nëse mbetet ngjyra, ose era, ose shija e papastërtisë, pavarësisht se shkenca mund të pohojë se mbetja e diçkaje prej këtyre cilësive tregon praninë e atomeve të papastërtisë. Mirëpo dispozita vendoset bazuar mbi praktikën e njohur e mbi tolerancën dhe jo duke u bazuar mbi shkencën e mbi eksperimentet e saj.

Gjithashtu, është kusht që uji të jetë i pastër dhe jo i ndotur me papastërti, sepse humbja e një cilësie nuk i jep atij cilësinë e pastruesit, gjithashtu, edhe bashkimi i një papastërtie me një papastërti të ngjashme, nuk e bën totalin të pastër. Uji, patjetër

duhet të jetë ujë në përgjithësi (mutlak), sepse uji i shtuar, edhe nëse është i pastër në vetvete, siç kemi thënë më sipër, ai nuk është pastrues për sendet e tjera.

Pastrimi prej qenit, derrit, miut dhe urinës

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për derrin që pi ujë në një enë. Ai ka thënë: “*Ena lahet shtatë herë.*”

Me këtë thënie të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), të gjithë fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Qeni është ndyrësi e papastërti, nuk merret abdes me ujin e enës që ka tepruar, pasi aty ka pirë qeni. Atë ujë derdhe. Në fillim enën laje me baltë dhe pastaj laje dy herë me ujë.*”

Edhe për këtë thënie të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), fukahatë kanë një mendim të përbashkët.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për urinën që bie në trup. Ai ka thënë: “*Derdh ujë mbi vendin dy herë me radhë.*”

Edhe për këtë thënie të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), fukahatë kanë një mendim të përbashkët.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për urinën e foshnjës. Ai ka thënë: “*Derdh ujë mbi vendin ku ka rënë urina. Nëse foshnja ha ushqim, atëherë laje mirë me ujë.*” Në ligjin e fesë, si djali si vajza janë të barabartë.

Gjithashtu, fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, që foshnja e gjirit akoma të mos ketë marrë ushqim dhe edukatorja ka vetëm një rrobë të vetme.

Pastrimi i enëve, i rrobave dhe i trupit

Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur në rrobën tënde bie verë, ose raki, menjëherë lajë atë.”*

Është pyetur për ibrikun dhe për ndonjë enë tjetër, ku kishte verë, nëse bën të mbahet ujë në këtë enë. Ai ka thënë: *“Kur ena lahet, nuk ka problem.”*

Kur ena ndotet me papastërti, por jo ena në të cilën qeni e derri kanë futur gjuhën e turirin, apo kur ena ndotet nga mijtë e ngordhur, ajo pastrohet me ujë të bollshëm, thjesht nga kontakti i enës me papastërtinë, ose ena pastrohet duke derdhur ujë në të vetëm një herë. Në këtë mënyrë pastrohen rroba e trupi, kur nuk janë të ndotura me urinë. Ne thamë: Laje vetëm një herë, pasi Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka vënë kushte që larja të bëhet dy herë ose tre herë. Në disa transmetime prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se ai ka thënë: *“Laje atë tri herë.”*

Autori i librit “El Medarik” ka thënë: “Argument për të dhënë rezultat është zhdukja e papastërtisë me një larje, vërtetuar me shikim të syrit në përgjithësi, sepse ligjvënësi ka urdhëruar larjen e sendit të prekur nga papastërtia dhe kushtëzimi realizohet me një larje të vetme. Për sa i përket konsensusit të fukahave për papastërtinë, ai është seleksionuar pas larjes së vetme.”

Uji i shkëputur

Është uji që shkëputet prej vendit të larë, qoftë kur shkëputet vetvetiu, qoftë kur shkëputet me shtrydhje. Por ky ujë hyn në dispozitën e papastërtisë, kur ai është shkak për vazhdimin e llojit të papastërtisë, ndryshe ai është ujë i pastër.

Qëndrimi në banjë

Transmetohet prej Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kur të hysh në banjë (për të kryer nevojën), mos kthe as fytyrën e as shpinën në drejtim të Kiblës, por kthehu në drejtim të lindjes ose të perëndimit.”

Prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*), babait të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), transmetohet: “Pastrimin e kryejnë tre gurë. Kjo është rruga e veprimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Urina, patjetër duhet larë me ujë.”

Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka ndaluar që burri të pastrohet nga jashtëqitja me dorën e djathtë.”

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi atë dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush të bëjë gusël në fushë të hapur, le të bëjë kujdes për vendet e tij që duhen mbuluar. Asnjëri prej jush të mos hyjë në banjë pa rrobën e tij të poshtme. Gjithashtu, burri nuk shikon vendet e turpit të vëllait të vet.

Kush mendon këtë gjë, atë e mallkojnë shtatëdhjetë mijë engjëj. Edhe gruaja nuk duhet të shikojë vendet e turpshme të gruas."

Mbulimi i pjesëve të turpshme të trupit (*auret*) është detyrë e domosdoshme (*farz*) prej shikimit të njeriut të respektuar, qoftë kur je në vetmi, qoftë kur je më të tjerë. Gjithashtu, është haram shikimi në aurretin e të ngjashmit ose jo të ngjashmit, mysliman ose jo mysliman qoftë ai, madje gruaja e ka haram të shikojë edhe aurretin e vajzës së vet, kur vajza ka arritur në moshën kur bën dallim.

Është detyrë (*farz*) madhërimi i Kibles, prandaj kryerja e nevojave personale nuk bëhet as me fytyrën në drejtim të Kibles e as duke i kthyer shpinën asaj. Gjithashtu, është veprim i urryer që pastrimi nga jashtëqitja të kryhet me dorën e djathtë, sepse dora do të prekë ndyrësi dhe me dorën e djathtë merret ushqimi e gjëra të tjera.

Uji i përdorur për pastrimin e vendit të daljes së urinës e të feçeve, duhet të jetë i pastër, me kusht që të mos këtë pësuar ndryshim prej papastërtisë (*nexhasetit*). Papastërtia nuk arrin te uji nga jashtë, kur venddaljen nuk e sulmon papastërtia me vrull, ose kur së bashku, me urinën e me feçet, nuk del gjak, gjithashtu, që bashkë me ujin të mos këtë pjesëza prej feçeve.

Kur venddalja e feçeve fshihet me tre gurë, ajo është e pastër. Kjo fshirje është e mjaftueshme për mospërdorimin e ujit. Gjithashtu, fshirja është e mjaftueshme të bëhet me copë rrobe, me letër, me fajancë e me dru, si dhe me materiale të tjera që heqin papastërtinë, me kusht që këto materiale të mos jenë prej ushqimeve të njeriut.

Për sa i përket vendit të daljes së urinës, siç thamë më sipër, ai pastrohet vetëm duke e larë me ujë.

Dheu

Pastruesi i dytë është dheu. Transmetohet prej El Halebij: “I thashë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Rruga që unë shkoj në xhami, kalon nëpër një rrugicë, ku urinojnë. Kushedi sa herë kam ecur nëpër këtë rrugicë dhe, ngaqë s’kam këpucë, dheu i lagur më ngjitet nëpër këmbë.*” Ai më pyeti: “*Pas kësaj, a ecën nëpër tokë të thatë?*” I thashë: “*Posi jo.*” Atëherë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “*S’ka problem, sepse dheu pastron njëri-tjetrin.*”

Këtu qëndron edhe shkaku që fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se toka pastron tabanin e këmbës, kurse pantoflat pastrohen vetëm duke ecur mbi tokë, ose duke i fshirë ato me tokën, me kusht që të zhduket papastërtia (*nexhaseti*).

Dielli

Pastruesi i tretë është dielli. Imam Bakiri, baba i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “*Çdo send që është prekur nga rrezet e diellit, është i pastër.*”

Në një transmetim tjetër, thuhet: “*Kur atë e than dielli, mbi atë fal namaz, sepse ajo është e pastër.*”

Mbështetur në këto dy transmetime dhe në transmetime të tjera, fukahatë kanë thënë se dielli pastron ndërtesat dhe sendet e qëndrueshme, që janë te ndërtesat, si dyert e dërrasat e shtëpive,

pajimet e kuajve, pemët, frutat, derisa janë në pemë, bimët dhe çdo gjelbërim para se ai të shkulet prej tokës. Gjithashtu, dielli pastron trastat e thasët e shtrirë në tokë, madje me këto të fundit kanë bashkuar edhe rrogozat e anijet.

Transformimi

Pastruesi i katërt është transformimi, si vera që transformohet në uthull. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për verën e vjetër që është kthyer në uthull. Ai ka thënë: *“Nuk ka problem. Kur është tjetërsuar emri verë, atëherë ajo s’ka më asnjë problem.”*

Shndërrimi

Pastruesi i pestë është shndërrimi, si për shembull feçet shndërrohen në tokë ose në rërë. Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, ato janë pastruar, për shkak të ndryshimit të objektit.

Trupi i kafshës

Fukahatë kanë thënë: “Kur në trupin e kafshës (shtëpiake) bie një papastërti (nexaset), ajo pastrohet, sapo të zhduket prej saj dhe s’ka nevojë as për ujë e as materiale të tjera pastruese.

Sej’jid El Hakijm ka thënë në librin “El Mustedrek”: “Argumenti për lidhjet që kanë kafshët e njohura nga ndotja e tyre

me papastërti (nexhaset), është rruga taksative, duke ditur se mbi trupin e tyre nuk kalon ndonjë pastrues. Ngaqë në këtë dispozitë është i qartë veprimi. Nga shpjegimet që kanë dhënë Imamët, nuk është bërë objekt pyetjesh prej myslimanëve.”

Kjo fjalë do të thotë: Kur mbi kafshën bie cofëtinë ose feçe, apo papastërti të tjera dhe më pas papastërtia është zhdukur prej kafshës pa e pastruar atë me ujë, sipas mendimit të vërtetuar të fukahave, të gjithë njerëzit mund ta prekin këtë kafshë pa asnjë ngurrim. Kjo tregon se ajo kafshë për ata është e pastër me intuitë, si dhe për faktin se në doktrinën e tyre pastërtia është prej gjërave të qarta. Askush nuk e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, as vetë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u ka folur njerëzve për këtë problem.

Regjja

Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, lëkura e kafshës së ngordhur nuk pastrohet me anë të regjjes.

Këto që u thanë, janë një përmbledhje e shkurtër në lidhje me pastruesit më të rëndësishëm, ose më të zakonshëm. Sej'jid El Hakijm, autori i El Urvetu Uethekij, ka përmendur edhe sende të tjera, rreth të cilave mund të diskutohet, nëse ato mund të numërohen prej pastruesve.

* * *

ABDESI

Allahu i Lartësuar thotë:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ...”

“O ju që ju keni besuar, kur të ngriheni për të falur namaz, lani fytyrat tuaja e duart tuaja deri në bërrylat dhe fërkoni kokat tuaja e këmbët tuaja deri në nyjat...”¹

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Nuk ka namaz veçse me pastrim.” Gjithashtu, ai ka thënë: “Abdesi është detyrë e domosdoshme (*farz*).”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Abdesi është fillimi për faljen e namazit, tekberi i fillimit është hyrja në namaz dhe selami është dalja prej namazit.”

Imam Rizai, nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Fillohet me marrjen abdes, që robi të jetë i pastër, kur të jetë para

¹ Sure “El Maide”, ajeti 6.

Allahut. Gjatë meditimit me Të, në bindje të plotë ndaj Tij në punët për të cilat Ai e ka urdhëruar, të jetë i pastër nga papastërtisë morale e lëndore, krahas lënies së përtacisë e sprapsjes së përgjumjes, njëkohësisht abdesi është pastrim për zemrat.”

Më pas Imam Rizai (Paqja goftë mbi të!) tha: “Në të vërtetë, ne e kemi toleruar faljen e namazit të xhenazes pa abdes, sepse në këtë namaz s’ka as ruku e as sexhde, prandaj abdesi është farz në namazet që janë me ruku e me sexhde.”

Shkaqet e abdesit

Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: “Abdesi bëhet detyrë të merret vetëm ose për shkak të jashtëqitjes, ose për shkak të urinimit, ose për shkak të gazrave që u dëgjohet zëri, ose kur gazrat lëshojnë erë.”

Gjithashtu, ai ka thënë: “Mund të flejë syri, por nuk fle zemra dhe veshi. Por kur fle syri, veshi e zemra, atëherë është farz të merret abdes.”

Në një transmetim të tretë, Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: “Abdesin e prish jashtëqitja, urinimi, gazrat, sperma dhe gjumi, derisa humb vetëdijen.”

Në një transmetim të katërt, Imam Sadiku (Paqja goftë mbi të!) ka thënë: “Abdesin e prishin vetëm nxjerrja e papastërtive dhe gjumi.” Nuk ka asnjë dyshim se xhunubllëku, gjaku menstrual, (hajdhi), metrarogjia - hemorragjia jashtë kohës së menstruacioneve - (istihādḥah) dhe hemorragjia e lehonisë (nifās) janë prej papastërtive që nxjerr njeriu.

Në tërësi, këto transmetime dhe transmetime të tjera tregojnë se abdesi është detyrë të merret pas jashtëqitjes, pas urinimit, pas daljes së gazrave, pas gjendjes xhunub, pas kalimit të menstruacioneve, pas metrarogjisë, pas hemorragjisë së lehonisë, si dhe kur gjumi mposht dëgjimin e mendjes. Kurse ikja e mendjes nga dehja, gjendja e çmendjes dhe vilania, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, por jo me tekst, bëhet farz marrja e abdesit.

Autori i librit “El Uesàil” pasi citon hadithet që flasin për prishësit e abdesit, ka thënë: “Hadithet që limitojnë prishësit, tregojnë për mosprishjen e abdesit me ikjen e mendjes, por edhe kjo gjendje, me fjalën e përbashkët të fukahave, është konsideruar prishëse e abdesit.”

Janë të njëjtat shkaqe që prishin abdesin, që e bëjnë detyrë marrjen e tij, sepse ato edhe e bëjnë pa vlerë, edhe e prishim abdesin. Nga sa thamë më sipër, për ne është e qartë se dalja e krimbave, e gurëve, e gjakut, e ujthit gjatë përkëdheljeve (*medhij*), dalja e ujthit të trashë e të verdhë pas urinimit (*vedij*), vjellja, puthja e prekja, të gjitha këto dhe të tjera si këto, as nuk e bëjnë detyrë marrjen abdes e as nuk e prishin abdesin.

Është aksiomë se abdesi është i vlefshëm krahas pranimit të Islamit, mosha e pjekurisë (seksulale), mendja dhe mosdëmtimi. Thuhet: Abdesi është i vlefshëm edhe për fëmijën që dallon. Kjo, duke u bazuar mbi vlefshmërinë e adhurimit të tij. Për këtë çështje do të flitet më poshtë.

Dyshimi e ngurrimi

Kush është i sigurt në vetvete se është me abdes dhe nuk ka asnjë dyshim, nëse prej tij ka dalë apo nuk ka dalë ndonjë gjë prej gjërave që e bëjnë detyrë marrjen abdes dhe e prishin abdesin, ky njeri qëndron në sigurinë e vet dhe nuk ka detyrë të marrë abdes për herë të dytë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në të vërtetë, ai është i sigurt në vetvete për abdesin e tij. Dyshimi kurrë nuk e prish sigurinë, pasi siguria priset me një siguri të ngjashme me të.”

Qëllimet e abdesit

Adhurimi për të cilin njeriu merr abdes, quhet qëllim i abdesit. Qëllimi është si vijon:

1- Abdesi është farz për faljen e namazit farz dhe të namazit të vullnetshëm (*mustehab*), domethënë: Namazi nuk vlen pa abdes. Fjala e përbashkët e fukahave dhe me tekst, është fjala e Allahut të Lartësuar: “...kur të ngriheni për të falur namaz...”, si dhe fjala e Imam Sadikut: “*Namaz ka vetëm me pastrim.*”

2- Gjithashtu, abdesi është farz për të bërë tavaf, bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, që është hadithi: “Tavafi në Qabe është namaz.”. Ali bin Xhaferri, transmeton prej vëllait të tij, Imam Kadhimit, djalit të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): Një burrë po bënte tavaf në Qabe. Pastaj u kujtua se ishte pa abdes. Imami tha: “*Ndërpret tavafin e tij dhe tavafi që ai ka bërë, nuk merret në konsideratë.*”

3- Abdesi është farz për prekjen e shkrimit të Kur’anit. Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë djalit

të tij, Ismailit: *“O bir, lexo Kur’an.”* Djali i tha: *“Nuk jam me abdes.”* Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: *“Mos e prek shkrimin, por të prekësh vetëm letrën dhe lexo.”*

Këtu është me vlerë të theksohet se prekja e shkrimit të Kur’anit, në të vërtetë, nuk është prej qëllimeve të abdesit, por është për tolerancë, sepse kjo prekje nuk është as detyrë (*farz*) e as adhurim i vullnetshëm (*mustehab*). Atëherë, kur nuk është i këtillë, është më e preferuar që abdesi për prekjen e shkrimit të Kur’anit të mos jetë as farz e as prej veprimeve të preferuara (*mustehab*), për arsyen e thjeshtë se mjeti nuk bëhet detyrë pa qëllimin dhe ndjekësi nuk mund të jetë më shumë se i ndjekuri. Duke u bazuar mbi këtë arsyetim, abdesi për prekjen e shkrimit të Kur’anit, patjetër që nuk është ligj i fesë.

Atëherë qëllimi është: Kush është pa abdes, e ka haram të prekë shkrimin e Kur’anit dhe, kush është me abdes për ndonjë qëllim tjetër, ai lejohet të prekë shkrimin e shenjtë.

4- Abdesi është farz për thirrjen e ikametit, ashtu siç është farz për faljen e vetë namazit, bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave dhe në tekstin, që është fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“S’ka problem, nëse ti thërret ezanin pa abdes, por ti, në asnjë mënyrë, nuk mund të bësh ikametin për faljen e namazit pa abdes.”*

Në fillimet e këtij kapitulli kemi përmendur fjalën e thënë prej Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*) se falja e namazit të xhenazes nuk e bën farz marrjen abdes, sepse ky namaz s’ka as ruku e as sexhde dhe në fakt nuk është namaz i vërtetë, por është lutje për të vdekurin.

←—————
ËSHTË VEPRIM I PËLQYESHËM
PËR TË QENË VAZHDIMISHT ME ABDES
—————→

Në librin "Uesàilu Shiih", prej shehut Mufijdit transmetohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "O Enes, shtoje pastrimin (abdesin) sa më shumë, që Allahu të shtojë jetën tënde. Nëse ke mundësi të jesh me pastrim (abdes) natën e ditën, bëje, pasi, edhe nëse vdes duke qenë me pastrim (abdes), je dëshmor (vdes me gradën e dëshmorit)."

Gjithashtu, Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Kush kryen nevojat dhe nuk merr abdes, në të vërtetë ai më ka larguar mua."

Prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Madhështori, Allahu i Lartësuar, thotë: 'Me të vërtetë, shtëpitë e Mia në tokë janë xhamitë. Ato ndriçojnë për banorët e qiellit ashtu siç ndriçojnë yjet për banorët e tokës. Vini re, përgëzim për atë që xhamitë janë shtëpia e tij. Vini re, përgëzim për robin që merr abdes në shtëpinë e vet dhe pastaj më viziton Mua në shtëpinë Time.'

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Abdesi është gjysma e besimit (imànit).*”

Këto transmetime dhe transmetime të tjera si këto, tregojnë se abdesi, ashtu siç është ndërmjetësues për veprime të tjera, është edhe qëllim në vetvete, pasi me natyrën e tij peshon rëndë. Prandaj njeriu le të jetë me abdes, jo për ndonjë gjë tjetër, përveç faktit që të jetë i pastër në çdo pjesë të natës ose të ditës.

Bazuar mbi sa u tha, abdesi është detyrë e domosdoshme (*farz*) për kryerjen e adhurimeve të detyrueshme, siç është falja e pesë namazeve ditore, tavafi farz në Qabe, adhurimet e taksura (nedhr). Megjithëse, në vetvete, abdesi është veprim *mustehab*, (veprim i pëlqyer), përsëri ai është detyrë e domosdoshme (*farz*) edhe për faljen e namazeve të vullnetshme (*nafileh*), si dhe për kryerjen e tavafit mustehab. Juristët e fesë kanë thënë se është musteheb të merret abdes për të qenë i përgatitur për faljen e namazit, edhe para hyrjes së kohës së faljes.

* * *

KUSHTET E ABDESIT

DHE MËNYRA E MARRJES ABDES

Kushtet e abdesit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Allahu i Lartësuar e ka bërë farz që abdesi të merret me ujë të pastër.*”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i rrjedh gjak nga hundët gjatë kohës që është duke marrë abdes. Ndërkaq një pikë gjaku bie në enën e ujit që ai ka për abdes. A është i vlefshëm abdesi i këtij njeriu? Ai iu përgjigj: “*Jo.*”

Më sipër pamë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) urdhëroi derdhjen e dy enëve, në njërin prej të cilave kishte rënë papastërti (*nexhaset*), por që nuk dihet se në cilën prej dy enëve kishte rënë, gjithashtu, pamë se ishte detyrë e domosdoshme bërja tejemum.

Është kusht që uji me të cilin burri merr abdes, të jetë ujë në përgjithësi (*maul mutlak*) dhe i pastër. Nëse ti merr abdes me njërin prej këtyre dy ujërave, me ujin në përgjithësi dhe me ujin që e

konsideron të pastër, pa ditur gjë për pastërtinë e ujit, ose nga harresa, abdesi yt është prishur.

Gjithashtu, është kusht që uji të jetë ujë i lejuar dhe jo i grabitur, sepse në ligjin e fesë, veprimi me të grabiturën është i ndaluar, kurse ndalimi në adhurim tregon se ai adhurim është prishur. Por kur ti përdor ujë të grabitur për të marrë abdes, ngaqë nuk e di, ose harron se ai ujë është i grabitur, abdesi yt është i vlefshëm. Dallimi mes ujit të grabitur, nga njëra anë dhe ujit në përgjithësi dhe ujit të ndotur me papastërti, nga ana tjetër, vërtetohet me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë.

Gjithashtu, është kusht që gjymtyrët që lahen gjatë abdesit, të jenë të pastra, në mënyrë që të mos ndotet uji nga kontakti me papastërtinë.

Është kusht që uji të mos jetë në enë prej argjendi ose në enë prej floriri, si dhe të mos jetë ujë që është përdorur për heqjen e jashtëqitjeve dhe as ujë me të cilin ligji i fesë e ndalon marrjen abdes, për shkak të ndonjë dëmtimi që mund t'i vijë njeriut nga përdorimi i ujit, ose kur uji nuk duhet përdorur për ndonjë shkak më të rëndësishëm se marrja abdes.

Kjo çështje do të shpjegohet me hollësi në kapitullin "Tejemumi".

Gjithashtu, është kusht që abdesi të jetë i vlefshëm, duhet të ketë kohë të mjaftueshme deri në kohën e hyrjes së kohës për faljen e namazit, domethënë se pas marrjes abdes, njeriu ka mundësi të falë namazin në kohën e caktuar për faljen e tij. Le të supozojmë se koha mes abdesit e faljes së namazit është tepër e ngushtë, domethënë, nëse ti merr abdes, ndërkohë ka hyrë koha për faljen e namazit, për pasojë një pjesë e namazit mbetet të falet

jashtë kohës për faljen e tij. Por nëse ti merr tejemum, atëherë e arrin të plotë faljen e namazit në kohën e tij. Në këto kushte, është detyrë të bëhet tejemum dhe jo të merret abdes. Nëse merr abdes në një situatë të tillë, ky abdes është prishur.

Gjithashtu, është kusht se ai që merr abdes, t'i kryejë vetë të gjitha veprimet e marrjes abdes dhe të mos kërkojë ndihmën e ndonjë tjetri, përjashtoj rastin e pamundësisë e të domosdoshmërisë, sepse ajeti i Kur'anit që flet për abdesin, si dhe hadithet, urdhërojnë larjen e fytyrës, të dy duarve dhe dhënien mes'h kokës e dy këmbëve. Urdhri është i qartë: Është detyrë prekja direkt e ujit dhe kryerja e veprimeve pa ndërmjetës.

Gjithashtu, është kusht larja e gjymtyrëve të abdesit, sipas radhës: fillohet me larjen e fytyrës, pastaj lahet dora e djathtë, pastaj dora e majtë, pastaj i jepet mes'h kokës dhe pastaj i jepet mes'h dy këmbëve. Në rast prishje të kësaj renditjeje, domethënë, kur kryhet veprimi i parë në fund ose i fundit kryhet përpara nga padituria ose nga harresa, abdesi duhet të përsëritet. Veprimet detyrimisht të kryhen ashtu siç janë vënë në ligjin e fesë.

Gjithashtu, është kusht që veprimet e abdesit të kryhen sa më shpejt, në kuptimin që të bëhet larja e gjymtyrës pasuese menjëherë pas larjes së gjymtyrës së parë, pa asnjë ndërprerje. Kjo mënyrë e shpejtë e kryerjes së veprimeve të abdesit, në terminologjinë e juristëve të fesë (fukahave), quhet vijueshmëri. Juristët e fesë kanë thënë: Gjatë marrjes abdes nuk duhet të thahet lagështira nga asnjë gjymtyrë prej gjymtyrëve që lahen para se të mbarojë larja e të gjitha gjymtyrëve dhe, sikur të thahet fytyra para se të fillohet larja e dorës së djathtë, ose thahet dora e djathtë para se të fillohet larja e dorës së majtë, ose thahet dora e majtë

para se të t'i jepet mes'h kokës, ose thahet ndonjëra prej këtyre gjymtyrëve para se t'i jepet mes'h dy këmbëve, abdesi është prishur.

Duhet të theksohet se tharja që e prish abdesin, është tharja që vjen nga ndarja e gjatë mes larjes së një gjymtyre dhe një gjymtyre tjetër. Por nëse supozojmë se tharja ka ardhur për shkak të temperaturës së trupit të atij që merr abdes, ose prej ajrit, si dhe për shkaqe të tjera të kësaj natyre, nuk ka ndonjë problem.

Të gjitha këto kushte që ne përmendëm janë transmetime të ardhura prej Elhi Bejtit dhe janë të përforcuara me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë.

Mënyra e marrjes abdes

Imam Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Dëgjoni, a doni t’ju tregoj mënyrën si merrte abdes i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?” Ne thamë: “Posi jo.” Pastaj Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha t’i sillnin një enë të madhe e të trashë me ujë. Ai e vuri enën para vetes, përveshi krahët dhe zhyti në ujë shputën e dorës së djathtë, pastaj tha: “Vepronet kështu: Kur shputa e dorës është e pastër.” Pastaj e mblodhi dorën dhe mori një grusht ujë, dorën me ujë e vuri mbi ballin e vet dhe tha: “Bismil’lâhi-rr’rrahmâni-rr’rrahijm.”

Pastaj dorën me ujë e shtriu nëpër anët e mjekrës. Më pas e kaloi, vetëm një herë, dorën nëpër fytyrën e tij, deri mbi pjesën e sheshtë të ballit. Pas këtij veprimi, zhyti dorën e majtë në ujë, me të cilën mori një grusht ujë dhe dorën me ujë e vuri mbi bërrylin e

tij të djathtë dhe shputën e dorës e kaloi mbi gjithë krahun, deri te majat e gishtave të dorës. Pastaj mori një grusht ujë me dorën e djathtë, të cilën e vuri mbi krahun e tij të majtë, duke e kaluar mbi të gjithë krahun, derisa uji rrodhi te majat e gishtave të dorës. Pastaj me lagështirën që kishte dora e tij e majtë dhe me lagështirën që kishte mbetur nga dora e tij e djathtë i dha mes'h pjesës së përparme të kokës dhe shpinës së dy këmbëve.

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) tha: “Allahu është tek dhe Ai e do tekun, prandaj për ty janë të mjaftueshme trigrushte ujë: njërin për fytyrën dhe dy grushtet e tjera për dy krahët.

Pastaj me lagështirën e mbetur në dorën e djathtë i jep mes'h kokës dhe shpinës së këmbës së djathtë, kurse shpinës së këmbës së majtë i jep mes'h me lagështirën e dorën së majtë.”

Abdesi ka veprime farze (të kryhen patjetër) që nuk realizohen e që nuk konsiderohen të ligjëruara veçse duke i kryer ato. Gjithashtu, abdesi ka veprime mustehab, që nuk janë farz të kryhen dhe as që sjellin ndonjë pengim në adhurimin e atij që i le pa kryer, pasi, para së gjithash, na intereson veprimi më i merituar. Këto veprime janë si më poshtë:

1- Nijeti, në të vërtetë është shtytësi i punës për të fituar kënaqësinë e Allahut e për të zbatuar urdhrin e Tij. Çfarë shtytësi e çfarë argumenti tjetër ka veç nijetit, që mund të tregojë se detyra për të marrë abdes është adhurim, siç është adhurim agjërimi e falja e namazit? Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë dhe me tekst të Kur'anit e të hadithit, vërtetohet se s'ka adhurim pa nijet. Nga këto tekste kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَمَا أُمْرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ...”

“Ata nuk u urdhëruan për gjë tjetër përveçse të adhurojnë Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij...” (El Bej’jineh, ajeti 5), si dhe fjala tjetër të Allahut të Lartësuar:

“فَادْعُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ”

“Adhuroni Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, edhe pse mohuesit kanë urrejtje.” (El Gâfir, ajeti 14). Shihet qartë se s’ka asnjë dyshim se abdesi është prej veprimeve që vërtetojnë se nijeti është prej veprimeve të fesë, prandaj është detyrë e domosdoshme (*farz*) që adhurimi të mos pranohet pa nijet të sinqertë.

Duke qenë se motivi shtytës dhe sinqeriteti janë vetëm punë të zemrës, nuk është farz që nijeti të shprehet me fjalë, ashtu siç nuk është farz të shprehet me fjalë as qëllimi për të kryer një veprim farz, ose mustehab (adhurim të vullnetshëm), ose të bëhet nijet duke e shprehur me fjalë për të kryer pastrimin nga jashtëqitja, ose për të legalizuar hyrjen në namaz. Në të gjitha këto veprime, apo në ndonjë veprim tjetër të kësaj kategorie, nuk ka ndonjë gjë që të vërtetojë se është farz shqiptimi i nijetit, me përjashtim të faktit që me zemër atë veprim ti e kryen vetëm për hir të Allahut. Kjo është më se e mjaftueshme.

Sikur një njeri të marrë abdes për hir të Allahut të Lartësuar, por në të njëjtën kohë ka qejf që ta shikojnë njerëzit sa mirë merr abdes dhe se ai është prej atyre që bëjnë shumë punë të mira, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, abdesi i këtij njeriu është i vlefshëm, sepse dëshira e tij është e bashkuar me punën e mirë dhe për të mirën.

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), baba i Imam Xhaferr Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që bën ndonjë punë të mirë, kur e shikojnë njerëzit dhe kjo e gëzon atë. Imami ka thënë: *“S’ka problem për asnjë njeri, përderisa ka dëshirë të bëjë punën e mirë para njerëzve, kur vepron kështu vetëm për këtë qëllim.”*, domethënë: Ai nuk e bën punën e mirë për njerëzit. Me fjalë të tjera: Nëse puna e tij është dedikuar për njerëzit, atëherë në punën e tij s’ka asgjë për hir të Allahut. Por gëzimi i tij është që ai të jetë prej punëmirëve të Allahut, kurse shikimi i të mirës prej njerëzve është tjetër gjë.

Shtrohet pyetja: Sikur burri të dyshojë, nëse ka bërë apo s’ka bërë nijet për të marrë abdes? Nëse është duke vazhduar marrjen abdes, duhet të rifillojë abdesin nga e para dhe, nëse e ka mbaruar abdesin, ai nuk rikthehet të rimarrë abdes për së dyti.

2- Larja e fytyrës një herë të vetme, domethënë të rrjedhë uji mbi fytyrë, duke filluar nga venddajla e flokëve e deri te maja e mjekrës për së gjati dhe aq sa rrotullohet gishti tregues për së gjëri, që do të thotë, prej njërit vesh në veshin tjetër.

Pjesa më e madhe e fukahave janë shprehur se është farz që larja e fytyrës të fillojë nga sipër. Por nëse larja do të fillohet nga poshtë, ose edhe në mes të fytyrës, kjo larje e fytyrës nuk është e vlefshme. Shprehimisht, dijetarët kanë thënë: *“Është detyrë e domosdoshme që fytyra të lahet nga e pjesa e sipërme e fytyrës deri te nofullat dhe, nëse veprohet e kundërta, larja nuk është e vlefshme.”*

Konstatohet se urdhri për larjen e fytyrës është në përgjithësi larje. S’ka ndonjë tekst që të tregojë se është detyrë e

domosdoshme të fillohet larja e fytyrës nga pjesa e sipërme e saj, pasi është arritur përvetësimi i urdhrit që larja të bëhet si të jetë më mbarë. Përsa i përket faktit që Imami e filloi larjen e fytyrës nga pjesa e sipërme e saj, qëllimi është që të tregojë se kjo mënyrë larjeje është e vlefshme dhe në zbatim të ligjit të fesë, por nuk tregon as kufizim e as përcaktim.

Sido që të jetë, nuk është detyrë të lahet pjesa poshtë mjekrës dhe as fijet e mjekrës, mustaqet e vetullat, pavarësisht sa të gjata janë ato, pasi nuk është vështirë të kuptohet që sekreti i këtij veprimi qëndron në faktin se nuk është detyrë e domosdoshme (*farz*) që uji të arrijë deri në lëkurë, kur mjekra është e dendur, sepse në kushtet e një mjekre të këstillë, lëkura konsiderohet nga pjesët e brendshme dhe jo prej pjesëve të jashtme. Për këtë fakt tregon edhe fjala e Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Çdo pjesë të mbuluar me qime, njerëzit s’kanë detyrë të kërkojnë atë pjesë e as të mundohen ta gjejnë, por është e mjaftueshme që mbi atë pjesë të rrjedhë ujë.”

3- Larja e dy duarve një herë të vetme: Është detyrë të fillohet larja e dorës së djathtë para dorës së majtë. Kufiri i larjes së duarve fillon që nga majat e gishtave deri te bërrylat, pra, deri në ndarjen e parakrahut nga krahu. Kjo pjesë është detyrë e domosdoshme të lahet. Këtu vlen të theksohet se shi’at kanë bërë detyrë të domosdoshme (*farz*) që larja e duarve bëhet duke filluar nga dy bërrylat dhe e kanë anuluar të kundërtën, domethënë: fillimin e larjes nga majat e gishtave, kurse Ehli Suneti, me të katër medh’hebet e tij, e konsiderojnë të lejuar larjen si të vijë për mbarë dhe nuk e kanë bërë detyrë të domosdoshme fillimin prej dy bërrylave e as të fillohet larja e duarve nga majat e gishtave.

Këtij veprimi shiiat i janë përgjigjur bazuar në fjalën e të Plotpushtetshmit:

“فَاعْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ”

“...dhe lani fytyrat e duart tuaja deri te bërrylat...” Ajeti tregon se mbarimi është deri në dy bërrylat dhe jo se larja fillohet nga dy bërrylat, aq më pak tregon se është e lejuar në njëren nga dy pozicionet. Atëherë, nga erdhi përcaktimi?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje shiiat e bazojnë në faktin se në këtë ajet parafjala “deri në” është për përfundimin dhe nuk tregon se është filluar prej ndonjë ane tjetër, sikur për shembull të thuash: “Eca prej shtëpisë, deri në treg.”, kurse në ajetin e mësipërm mungon parafjala “prej”, prandaj patjetër që parafjala “deri në” është në kuptimin bashkërisht, domethënë: lani dy bërrylat e dy duart tuaja.

Ne nuk kemi dyshim se kjo është një lojë fjalësh dhe vetëm fjalë pa asnjë rezultat, pasi kuptimi i saktë i parafjalës “deri në” është i qëndrueshëm, ashtu siç është në dukjen e saj të jashtme, pra, ajo tregon përfundimin. Sikur parafjala “prej” të mos ishte ana tjetër, që në fakt është një përkufizim për gjymtyrën e larë, pra, për dorën, nuk do të kishim përkufizim për vetë larjen dhe, sikur të ishte përkufizimi për larjen, atëherë patjetër do të ishte detyrë e domosdoshme caktimi i fillimit të larjes që nga majat e gishtave. Por për këtë nuk është shprehur askush, madje as Ehli Suneti, të cilët, pa përjashtim, janë shprehur për përzgjedhjen: ose larja të fillohet prej dy bërrylave, ose larja të fillohet nga majat e gishtave.

Këtu kemi një pyetje që na lind vetvetiu: Meqenëse parafjala “deri në”, në ajetin e mësipërm, është përcaktim për gjymtyrën e larë dhe jo për larjen, kurse ajo që tregon ajeti konsiston në faktin se është detyrë e domosdoshme larja e kësaj gjymtyre të caktuar si të vijë më mbarë, atëherë në ç’argument janë bazuar shi’at, kur thonë se është detyrë e domosdoshme (*farz*) të fillohet larja nga dy bërrylat? Me një fjalë, problemi i mësipërm qëndron përderisa ajeti nuk tregon se është detyrë e domosdoshme fillimi i larjes as nga majat e gishtave e as nga të dy bërrylat.

Përgjigje:

Patjetër që ajeti është jashtë këtij interpretimi, por shiiat janë bazuar mbi një argument tjetër për të bërë detyrë të domosdoshme fillimin e larjes nga dy bërrylat. Ata janë bazuar në fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë dhe të transmetimeve të përcjella prej Ehi Bejtit.

Një herë të vetme

Ne kemi bërë detyrë të domosdoshme (*farz*) larjen e fytyrës dhe të dy duarve një herë të vetme, bazuar në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Abdesi është farz një herë të vetme dhe dy herë nuk shpërblehet, kurse larja e tretë është sajësë (bid’at).*”, domethënë se ai që lan gjymtyrën për herë të tretë, duke besuar se kjo larje është e abdesit, në të vërtetë, ai ka bërë një veprim në kundërshtim me ligjin e fesë dhe ka bërë një sajësë, por çdo sajësë

është shkarje në rrugën e humbjes dhe çdo shkarje në rrugën e humbjes, është në zjarr. Kush e bën një veprim të tillë pa qëllim, mbi atë nuk rëndon asnjë mëkat, megjithëkëtë atij i është prishur abdesi. Gjithashtu, për atë nuk është e lejuar që t'i japë mes'h kokës e dy këmbëve me lagështirën e herës së tretë.

4- Dhënia mes'h kokës. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kokës i jepet mes'h në pjesën e saj të përparme.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “S'ka problem, nëse gjatë abdesit i jep mes'h përpara ose mbrapa.”, domethënë, s'ka problem nëse përsërit dhënien mes'h të gjymtyrëve. Pastaj Imami tha: “Nëse ti harron t'i japësh mes'h kokës, jepi asaj mes'h dhe dy këmbëve me lagështirën e abdesit tënd dhe, nëse në duart e tua nuk ka mbetur asgjë nga lagështira e abdesit tënd, atëherë merr lagështirën prej mjekrës tënde dhe më këtë lagështirë jepi mes'h kokës e dy këmbëve. Nëse nuk ke mjekër, atëherë lagështirën merre prej vetullës e prej dy kapakëve të syve të tu dhe me këtë lagështirë jepi mes'h kokës e dy këmbëve të tua. Nëse s'ka mbetur fare lagështirë nga abdesi yt, atëherë përsërite abdesin.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i jep mes'h kokës së tij vetëm me një gisht, nëse kjo është e mjaftueshme ose jo. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Këto transmetime dhe transmetime të tjera të ngjashme, fukahatë i kanë përmbledhur me këto fjale: Është e mjaftueshme për dhënien mes'h kokës ajo që quhet mes'h dhe është e pëlqyeshme (*mustehab*) që pjesa e përfshirë në mes'h të jetë sa madhësia e tre gishtave për së gjeri. Gjithashtu, mes'hi i kokës ka veçorinë të bëhet në pjesën e përparme të kokës. Është farz që

mes'hi të jetë prej lagështirës së abdesit dhe jo me ujë të ri. Në rast se lagështira është tharë nga duart, atëherë merr lagështirë prej dy vetullave e dy kapakëve të syve të tu dhe, në rast se lagështira është tharë krejtësisht, atëherë përsërite abdesin. Gjithashtu, mes'hi është i vlefshëm edhe kur përsëritet.

5- Dhënia mes'h dy këmbëve bëhet duke filluar prej majës së gishtave deri te dy nyjat e këmbëve, pra, deri në dy kockat e ngritura mbi shpinën e këmbës. Është e pëlqyeshme (mustehab) që këmbëve t'u jepet mes'h deri në fillim të kërcirit, ashtu siç veprohet zakonisht.

Edhe për dhënien mes'h të dy këmbëve, është vërtetuar me tekst e me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë ajo që është vërtetuar edhe për dhënien mes'h kokës: Është e mjaftueshme që mes'hi i dy këmbëve të fillojë nga gishtat deri te nyjat e këmbëve, ose edhe e kundërta, domethënë, duke filluar nga dy nyjat deri në majat e gishtave. Me fjalë të tjera, shiiat e kanë farz që, larja e gjymtyrëve, për marrjen abdes, të fillojnë nga lart. Por fillimin nga lart nuk e kanë farz në dhënien mes'h. Dallimi qëndron në njoftimet që vijnë prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!). Gjithashtu, është më e pëlqyeshme që me shputën e dorës së djathtë t'i jepet mes'h shpinës së këmbës së djathtë dhe shpinës së këmbës së majtë t'i jepet mes'h me shputën e dorës së majtë. Gjithashtu, lejohet që dy këmbëve t'i jepet mes'h njëherësh, por nuk lejohet që t'i jepet mes'h këmbës së majtë para këmbës së djathtë.

Ndërmjet shiiave dhe Elhi Sunetit

Këtu do të trajtojmë një mospërputhje të njohur në mes Ehli Sunetit dhe shiiave, në lidhje me interpretimin e ajetit 6 të sures “El Maideh”:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ”

“O ju që besuat kur të ngriheni për të falur namaz, lani fytyrat tuaja e duart tuaja deri në bërrylat dhe i jepni mes`h (fërkoni me dorë të lagur) kokave tuaja e këmbëve tuaja deri në nyjat e këmbëve...”

Kjo mospërputhje është në lidhje me këmbët: A është farz larja e këmbëve apo është farz dhënia mes`h atyre? Në lidhje me interpretimin e ajetit të lartpërmendur, për shpjegimin e kësaj çështjeje, bazuar mbi rregullat e gramatikës së gjuhës arabe janë përcjellë dy variante të leximit të ajetit. Njëri variant duke e lexuar shkronjën “l” të fjalës “ue *erxhulekum*” (dhe këmbëve tuaja) me zanoren “e”, por duke e atashuar këtë fjalë në foljen “lani”, kurse varianti tjetër, duke e lexuar shkronjën “l” me zanoren “i”, domethënë, duke e lexuar “ue *erxhulikum*” (dhe këmbëve tuaja), por duke e atashuar në foljen “jepni mes`h”.

Ehli Suneti thotë se në të dy variantet e përcjella për leximin e ajetit, larja e këmbëve është farz, sepse ka lidhje me fjalën “duart tuaja”. Për sa i përket variantit për leximin e shkronjës “l” me zanoren “e”, çështja është më se e qartë, sepse në ajet fjala “duart” është në pozicionin e vet, prandaj detyrimisht ajo duhet të lexohet me zanoren “e”. Kurse për variantin e leximit me

zanoren “i” të fjalës këmbëve tuaja “erxhulikum”. Kjo është për shkak të rregullit gramatikor të fqinjësisë, që thotë se fjala e mëpasshme ndjek paraardhësen e saj, domethënë, meqenëse fjala kokat tuaja “ruùsikum”, sipas rregullit të gramatikës së gjuhës arabe, patjetër duhet të lexohet me zanoren “i”, për pasojë edhe togfjalëshi “këmbëve tuaja”, që vjen puqur me togfjalëshin “kokave tuaja”, duhet të lexohet me zanoren “i”, për shkak të rregullit të fqinjësisë.

Shiat thonë: Është farz dhënia mes’h këmbëve, sepse kjo fjalë i atashohet togfjalëshit “kokave tuaja”. Nëse e shikojmë leximin, nga pikëpamja e rregullit gramatikor, togfjalëshi “kokave tuaja”-“biruùsikum”, shihet qartë se germa “s” e kësaj fjale patjetër do të lexohet me zanoren “i”, për shkak se në fillim të fjalës gjendet shkronja “b”, e cila ka atributin të bëjë të detyrueshme leximin e shkronjës së fundit të emrit me zanoren “i”, por edhe në variantin e leximit të fjalës “ue erxhulekum”-“këmbët tuaja”, ashtu siç është tekstualisht në Kur’an. Për shkak të pozicionit që ka fjala në këtë ajet, kjo fjalë i atashohet fjalës “biruùsikum”-“kokave tuaja”, sepse rregulli kërkon që çdo fjalë që në fundin e saj ka zanoren “i” (*mexhrur*), për shkak të pozicionit që ka në fjali, fundi i saj duhet të lexohet me zanoren “e” (*nashb*).

Përveç kësaj, shi’at shtojnë: Atashimi i togfjalëshit “këmbëve tuaja” në fjalën “duart”, nuk është i vlefshëm për dy arsye:

E para, sepse është në kundërshtim me rregullat e drejtshkrimit të arabishtes, për shkak të ndarjes që është ndërmjet fjalëve “duart” dhe “këmbët”. Allahu i Lartësuar thotë në Kur’an: “...dhe jepni mes’h kokave tuaja...”. Nëse fjala “këmbët” do të

ishte atashuar në fjalën “duart”, patjetër që Allahu do të kishte thënë: “... duart tuaja deri në dy bërrylat dhe dy këmbët deri në nyjat e këmbëve.”, pa i ndarë duart e këmbët me fjalën mes’h.

E dyta, nëse këmbët do të atashoheshin te duart, kjo mënyrë atashimi kërkon që për çdo variant leximi një kuptim të ndryshëm nga tjetri, pasi kuptimi në rastin e leximit të shkronjës së fundit të fjalës “këmbët tuaja”, që është shkronja “l” me zanoren “e” (*nasb*), do të thotë larje, kurse varianti i leximit të kësaj shkronje me zanoren “i” (*xherr*) do të thotë dhënie mes’h. Me këtë interpretim, që e atashon fjalën këmbët në kokat, kuptimi është i njëjtë në të dy variantet e përcjelljes për leximin e togfjalëshit “këmbëve tuaja”, sepse leximi i shkronjës së fundit të kësaj fjale me zanoren “i” (*xherr*), vjen për shkak të fqinjësisë së fjalëve. Megjithëse kjo është fare pa rëndësi, pasi një gjë e tillë, në mënyrë absolute, nuk ka ardhur në fjalën e Allahut.

Sunetet e abdesit

Bazuar në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (Paqja e shpëtimiti i Allahut goftë mbi ta!) fukahatë kanë përmendur për abdesin veprime sunet, ndër të cilat rirreshtojmë: fillimi i abdesit me “Bismil’lâhi-rrahmâni-rr’rahijm”, këndimi i lutjes së transmetuar, larja e dhëmbëve me sivak (furçë e pastë dhëmbësh), shpëlarja e gojës, tri herë, duke përplasur ujët në brendësi të gojës (*madmadah*), thithja e ujit në brendësi të hundës, tri herë (*istinshâk*), burri fillon duke larë shpinën e dorës, kurse gruaja e fillon duke larë shputën e dorës, si dhe veprime të tjera që janë cituar në librat e fik’hut, të cilave mund t’i referohet kushdo që dëshiron.

* * *

DISPOZITAT E ABDESIT

Rregulli i përfundimit dhe rregulli i shlyerjes

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ti dyshon për ndonjë gjë në abdesin tënd dhe ke hyrë në një veprim tjetër, domethënë në një veprim jo të abdesit, dyshimi yt s’ka asnjë problem. Por nëse dyshimi është kur ti akoma je duke marrë abdes, atëherë ai abdes nuk është kryer.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që dyshon, pasi ka marrë abdes. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur ai po merrte abdes, a i kujtoi kush atij ndonjë gjë prej abdesit, kur ai dyshoi?”

Zurarah ka thënë: Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që dyshon për ezanin, ndërsa ai është duke bërë kiametin. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: “Është kryer.”

I thashë: “Ai dyshon në ezanin dhe në ikametin, ndërkaq është lidhur në namaz dhe ka marrë tekbirin (ka thënë “All’llàhu ekber”).”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: “Është kryer.”

I thashë: *“Ai dyshon në tekbirin dhe ka filluar këndimin (kiraetin).”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: *“Është kryer.”*

I thashë: *“Ai dyshon në kiraetin dhe ndërkaq ka rënë në ruku.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: *“Është kryer.”*

I thashë: *“Ai dyshon në rukunë, ndërkaq ka rënë në sexhede.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: *“Ai e ka kryer namazin e tij, o Zerare, sepse, kur ti del prej një veprimi dhe hyn në një veprim tjetër, pastaj dyshon, ky dyshim nuk është asgjë.”*

Në fik’h (jurispeudencë) ka rregulla, të cilat fukahatë i kanë nxjerrë prej teksteve të ligjit të fesë, ose prej shprehjeve të bazave të jurisprudencës fetare, ose prej deduksioneve logjike. Prej teksteve të bazave të mësipërme, fukahatë kanë nxjerrë dy rregulla, njërën prej të cilave e kanë emërtuar rregulli i përfundimit dhe tjetrën rregulli i shlyerjes.

Çdo njëra prej këtyre dy rregullave ka si burim dyshimin. Ndryshimi mes tyre qëndron në faktin se burimi në rregullin e përfundimit është dyshimi në vlefshmërinë e punës pas daljes prej asaj pune dhe hyrjes në një punë tjetër. Për ta pasur më të qartë idenë, po japim një shembull: Njeriu dyshon në vlefshmërinë e abdesit, pasi ka filluar faljen e namazit, ose dyshon në vlefshmërinë e namazit, pasi e ka përfunduar faljen e tij, ose ai dyshon në vlefshmërinë e agjërimit, pasi ka mbaruar Muaji i Ramazanit, ose dyshon në vlefshmërinë e Haxhit, pasi ka kaluar periudha e tij, ose në vlefshmërinë e kontratës së shitjes ose të qerasë, ose të kontratave të tjera, pasi ato janë bërë vepruese.

Rregulli i përfundimit është aksiomë te të gjithë. Me këtë rregull veprohet në të gjithë kapitujt e fik'hut, në çdo punë, pa asnjë përjashtim, qoftë kur bëhet fjalë për abdesin, guslin, ose tejemumin, apo për punë të tjera.

Për sa i përket rregullit të shlyerjes, e veçanta e këtij rregulli qëndron në faktin se dyshimi në këtë rregull e ka burimin në njërën prej pjesëve të punës gjatë kohës së kryerjes të asaj pune dhe para mbarimit të gjithë pjesëve të punës. Le ta ilustrojmë këtë rregull me një shembull: Njeriu dyshon, nëse i ka larë dy krahët, kur është akoma ulur në vendin ku merr abdes, ose ai dyshon, nëse e ka kënduar suren para se të japë selam (të dalë nga namazi).

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se rregulli i shlyerjes është veprues në namaz, mbështetur në njoftimin e mësipërm, të transmetuar prej Zurares: "Dyshon në tekbirin, kur ka filluar këndimin, etj."

Gjithashtu, fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se ky rregull nuk është veprues për abdesin, bazuar në ato që u thanë më sipër dhe në fjalën e Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Kur je ulur dhe po merr abdes dhe nuk e di, nëse i lave apo nuk i lave të dy krahët e tu, menjëherë përsërite larjen e krahëve. Kështu vepro për të gjitha dyshimet që mund të kesh për abdesin tënd."

Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me rregullin e shlyerjes, nëse është veprues ose jo ky rregull për guslin e për tejemumin.

Për këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie: Thënia e parë tregon se rregulli i shlyerjes, në mënyrë absolute, nuk është veprues në tri llojet e pastrimit: abdesin, guslin dhe tejemumin.

Thënia e dytë tregon se ky rregull është veprues për guslin e për tejemumin dhe ka si veçanti, se nuk është veprues vetëm për abdesin. Ne i përmbahemi kësaj thënieje, duke u bazuar në rregullin përgjithësues: Çdo gjë, në të cilën ka dyshim, por ajo është kryer dhe është filluar një veprim tjetër, atëherë le të vazhdohet, duke u mbështetur mbi veprimin e kryer, pra, sipas rregullit mbi dyshimin në një pjesë të punës dhe vlefshmërinë e punës në tërësinë e saj. Ky rregull është vënë për abdesin, bazuar mbi tekstin, kurse të tjerat mbeten të përfshira në përgjithësim.

Dyshimi dhe ngurrimi

Do të trajtojmë tani një çështje: Kur njeriu është i vetëdijshëm se është me abdes, por pas një farë kohe ai dyshon, nëse i ka ndodhur ose jo ndonjë veprim që prish abdesin. Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë dhe me tekst, ai mbetet me abdes, ashtu siç është edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Ti kurrë nuk e atakon me dyshim atë për të cilin je i vetëdijshëm.”*

Kur njeriu dyshon, nëse mori apo nuk mori abdes. Bazuar mbi të njëjtin argument, ai do të vendosë se abdesi i tij është prishur dhe nuk ka marrë abdes.

Sikur të supozohet që burri dyshoi për abdesin dhe nga harresa ose nga shkujdesja nuk rimori abdes, atëherë namazi i tij është i prishur, sepse është falur pa abdes.

Kur njeriu, në asnjë mënyrë, nuk dyshon para faljes së namazit, as në abdesin e as në kryerjen e nevojave jetësore dhe pastaj ai fal namaz, por, pasi e ka kryer faljen e namazit, fillon të dyshojë, nëse ai e ka falur namazin me abdes apo pa abdes, në këtë rast, namazi i tij është i vlefshëm, bazuar në rregullin e përfundimit. Por ai duhet të rimarrë abdes për të falur namazin e dytë, sepse si rregull, atij i ka ndodhur prishja e abdesit nga ndonjë prishës i abdesit, për pasojë ai është pa abdes.

Mbase dikush mund të thotë: Si është e mundur të bashkohet dispozita e vlefshmërisë së namazit me dispozitën e mospasjes abdes, duke ditur se nuk ka namaz pa pastrim dhe se vlefshmëria e namazit nënkupton që njeriu detyrimisht është me abdes, gjithashtu, edhe mospasja abdes nënkupton prishjen e namazit?

Përgjigjja jonë: Ky konflikt, në të vërtetë, ndodh kur pozitivja e negativja vijnë njëra pas tjetrës mbi një subjekt të vetëm, kurse, kur janë shumë subjekte, kjo nuk ndodh. Subjekti i rregullit të përfundimit, këtu është dyshimi në vlefshmërinë e namazit, kurse subjekti i bazës së shoqërimit, është dyshimi në pasjen ose mospasjen abdes. Por, kur ndryshon subjekti, hiqet konflikti.

Problemi është kështu: Përderisa ne nuk kemi gjykuar për vlefshmërinë e namazit e mospasjen abdes realisht, por vetëm sipas dukjes së jashtme dhe ashtu siç thuhet: çmontimi mes dispozitave të jashtme, ose mes efekteve të këtyre dispozitave, nuk është veprim i qëndrueshëm.

Kur njeriu e di në mënyrë të prerë se është me abdes, ose, kur e di në mënyrë të prerë, se ka kryer nevojat personale, por ai nuk e di, nëse ka marrë abdes më vonë, që të jetë me abdes, apo tani vonë ai kreu nevojat personale, pasi ishte me abdes. Pra, ai është pa abdes. Si të veprojë në një gjendje të tillë?

Përgjigje:

Pjesa me madhe e fukahave, sidomos fukahatë e mëparshëm kanë thënë: Në të vërtetë, ai hyn në dispozitën e atij që ka kryer nevojat personale, prandaj ai ka detyrë të marrë abdes, kur do të falë namaz.

Këtë gjë e thotë edhe autori i librit “El Medàrik”: “Allahu i Plotpushtetshëm ka urdhëruar të merret abdes dhe urdhri i Tij patjetër duhet të plotësohet, që do të thotë se abdesi duhet të realizohet me ndërgjegje dhe marrja abdes të kryhet e shoqëruar me zbatimin e plotë të rregullave për marrjen abdes në të gjitha pjesët e abdesit, duke iu kundërvënë shoqërimit të gjendjes së prishjes së abdesit nga jashtëqitja. Të dyja këto janë veprime të ndërgjegjshme, njëra arrihet me abdesin, kurse tjetra me kryerjen e nevojave, pra, shoqërimi i çdo të kundërte nën shoqërimin e një të kundërte tjetër, atëherë ato rrëzojnë njëra-tjetrën. Kur abdesi, si bazë, nuk vërtetohet me ndërgjegje, ashtu siç është detyrë të vërtetohet, atëherë ky dyshim hyn në dispozitën e prishësit të abdesit nga jashtëqitja (*hadeth*).

Dyshimi i shpeshtë

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që dyshonte shpesh në namazin e tij. Ndër të tjera, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Sipas zakonit të tij, djalli është i lig, kontradiktor e provokues. Prandaj çdo njëri prej jush, le të mos kapet pas hamendjeve, domethënë, të mos i kushtojë rëndësi hamendjeve e dyshimit, pasi kjo është e përgjithshme në namaz e në veprime të tjera.”*

Në hadithet e transmetuara prej Profetit dhe prej familjes së tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi ta!*) thuhet: *“Dyshimi i shpeshtë është prej shejtanit.”*

Kjo do të thotë se kujdesi për dyshimet e shpeshta është vështirësi, por në ligjin e fesë nuk ka vështirësi.

Nga këtu ka ardhur rregulli i njohur i fik’hut: S’ka dyshim, kur dyshimi është i shpeshtë. Bazuar mbi këtë rregull, arrijmë në përfundim: Kur dikush që dyshon shumë në ndonjërin prej pjesëve të punëve të abdesit gjatë kohës që është duke marrë abdes, ai le të vazhdojë dhe të mos e ripërsërisë abdesin.

* * *

FASHAT (el-xhebàir)

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka thyer krahun, ose ndonjë pjesë tjetër prej pjesëve të abdesit dhe ai nuk ka mundësi ta zgjidhë vendin e lidhur. Si duhet të veprojë ky njeri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur ai të marrë abdes, le të marrë një enë me ujë dhe vendin e fashuar ta fusë në ujë, derisa uji të arrijë në lëkurën e tij. Ky veprim e shlyen larjen, pa qenë e nevojshme zgjidhja e fashës.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që në krah, ose në ndonjë vend tjetër të abdesit ka një mahisje, të cilën e ka lidhur me një fashë dhe, kur do të marrë abdes, i jep mes’h fashës. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur uji i sjell dëm, atëherë le t’i japë mes’h fashës, por, nëse uji atij nuk i sjell asnjë dëmtim, atëherë le të zgjidhë fashën, pastaj ta lajë atë, domethënë vendin e mahisur.”

Transmetuesi e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) edhe për plagën: Si duhet të veprojë ai për ta larë atë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Laje vendin rreth plagës.”

Në gjuhën e zakonshme, fasha (*xhebijreh*) është një lidhëse që shtrëngohet mbi kockën e thyer, kurse në terminologjinë e fukahave është fashimi që vihet mbi gjymtyrën, qoftë ajo e sëmurë, ose e thyer, ose edhe jo e thyer.

Vlefshmëria e dhënies ose e mosdhënies mes’h fashës ka lidhje me frikën e dëmtimit ose të mosdëmtimit. Kur nuk është frikë nga zgjidhja e fashës dhe heqja e saj prej plagës, atëherë ai lan gjymtyrën, nëse është farz larja e saj, ose i jep mes’h gjymtyrës, kur është farz dhënia mes’h asaj. Nëse ai ka frikë se plaga dëmtohet, nëse zgjidhet fasha, atëherë ai i jep fashës mes’h, me kusht që lidhësja të mos jetë më shumë se vendi i sëmurë, domethënë lidhja të mos jetë më shumë nga sa është e nevojshme që ajo të kapet mbi gjymtyrën. Pastaj ai lan ose i jep mes’h pjesës që ka mbetur nga gjymtyra. Bazuar mbi këto që u thanë, dalin çështjet vijuese:

1- Kur fasha është mbi të gjithë trupin e njeriut ose në pjesën më të madhe të trupit të tij, ose mbi të gjitha gjymtyrët e abdesit, atëherë ai ka detyrë të bëjë tejemum, ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar:

“...وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِّنَ الْغَائِطِ أَوْ لَامَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ يَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا...”

“...nëse jeni sëmurë, në udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen nga vendi i kryerjes së nevojave, ose keni kryer marrëdhënie me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë bëni tejemum me tokë të pastër...” (Sure “En Nisa”, ajeti 43)

Argumenti për t'i dhënë mes'h fashës rrjedh prej këtij shembulli dhe, kur argumenti është i adaptueshëm për një gjymtyrë të vetme prej gjymtyrëve që është farz, të lahen ose t'i jepet mes'h, është e mjaftueshme që kësaj gjymtyre t'i jepet mes'h dhe nuk është detyrë të bëhet tejemum.

2- Kur fasha është mbi gjymtyrën që është farz të lahet dhe është e mundur që uji të arrijë në lëkurë, duke përsëritur derdhjen e ujit mbi gjymtyrën e fashuar, ose duke e zhytur gjymtyrën në ujë, derisa uji të arrijë në lëkurë, pa e dëmtuar plagën dhe pa e ndotur ujin, kur kjo është e mundur, atëherë është detyrë e domosdoshme të bëhet, ndryshe i jepet mes'h fashës.

3- Plagën e hapur, kur e dëmton uji, i vihet nga sipër nja copë e pastër dhe i jepet mes'h mbi copën.

4- Fasha lejohet të jetë edhe prej mëndafshi, edhe prej materialesh të tjera me të cilat nuk lejohet falja e namazit, me përjashtim të sendit të rrëmbyer. Por që mes'hi të jetë i vlefshëm mbi fashën, ajo duhet të jetë e dukshme dhe e pastër. Sej'jid El Hakijm, në librin "El Mustemsek", ka argumentuar sa u tha më sipër me fjalën e tij me këtë paragraf: "Kjo është për fashën që s'ka problem, pasi vetë argumenti përgjithësues i fashës e nënkupton këtë."

5- Kur gjymtyra është e shëndoshë dhe mbi gjymtyrën ka papastërti që s'mund të hiqen në çast, atëherë është detyrë të merret tejemum, por mbi këtë gjymtyrë të ndotur me papastërti nuk mund të jetë vepruese dispozita e fashës, sepse kjo dispozitë është specifike për gjymtyrën e sëmurë.

Meriton të tërhiqet vëmendja se qëllimi me fjalën gjymtyrë e shëndoshë, e ndotur me papastërti, është për gjymtyrën që është farz të lahet, ose t'i jepet mes'h. Në rast se papastërtia është në ndonjë vend tjetër, si për shembull, në kërcirin e këmbës, ose në shpinë, ose edhe në vende të tjera të trupit, patjetër që është farz të merret abdes dhe nuk lejohet që ai të bëjë tejemum.

6- Kur atij që kishte vënë fasha i kalon kjo nevojë, ai nuk e ka detyrë të përsërisë faljen e namazit, madje as atëherë kur ka kohë të mjaftueshme për të falur namazin, në mënyrë të veçantë, kur ai e ka falur atë namaz dhe nuk shpreson që plaga t'i shërohet para se të kalojë koha për faljen e namazit.

7- Kur ai merr abdes dhe i jep mes'h fashës, por pastaj atij i përmirësohet plaga, për pasojë i hiqet pengesa dhe ai nuk e ka prishur këtë abdes me ndonjërin për llojeve të jashtëqitjeve, a ka apo nuk ka të drejtë ai të falë namaz me këtë abdes të marrë, kur ishte i detyruar nga pengesa?

Përgjigje:

Jo, ai ka detyrë të rimarrë abdes të plotë, sepse largimi i nevojës është vetëm abdesi i plotë, kurse abdesi me pengesë është për raste domosdoshmërie dhe është vetëm për një pengesë, me të cilën lejohet falja e namazit. Është e padiskutueshme që domosdoshmëria vlerësohet me masën që ka, kurse pengimi kufizohet me burimin nga rrjedh dhe, kur supozohet që pengesa largohet, për pasojë së bashku me pengesën, largohet edhe efekti i saj.

8- Kur i fashuari beson se uji e dëmton dhe vepron në përputhje me këtë besim, domethënë e vë ujin mbi fashën, por më pas bëhet e qartë se në fakt ai kurrë e asnjëherë nuk do të kishte ndonjë dëmtim, nëse do të hiqte fashën dhe do të lante ose do t'i jepte mes' h gjymtyrës, abdesi i këtij njeriu, a është i vlefshëm apo është prishur?

Çështja e dytë është e kundërta e së parës, domethënë burri beson se nuk pëson asnjë dëm nga heqja e fashës, kur të vërë ujin mbi plagë dhe ai vepron në përputhje me besimin e tij, heq fashën dhe e lan ose i jep mes' h vendit të fashuar, por më pas bëhet e qartë realisht prania e dëmtimit. Abdesi i këtij burri është i vlefshëm, apo është i prishur?

Përgjigje:

Disa janë të mendimit se abdesi i këtij njeriu është prishur në dy çështje, sepse është vepruar, duke u bazuar mbi realitetin dhe jo mbi besimin. Në rastin e parë, ishte detyrë t'i jepej mes' h fashës, edhe pse plaga nuk dëmtohej prej ujit, kurse në rastin e dytë, ai e çoi ujin deri në plagë, e cila nga kontakti me ujin, u dëmtua.

Dikush ka thënë: Jo, është vepruar sipas besimit dhe jo sipas realitetit.

Ne e kundërshtojmë këtë thënie, pasi trajtimi shkencor i kësaj çështjeje mbështet ata që mendojnë se abdesi i atij njeriu është prishur dhe, sepse obligimet ligjore të fesë janë rezultat i subjekteve reale, ashtu siç janë, kurse përmbajtja në besimin, ose

në diçka tjetër, detyrimisht duhet të jetë e mbështetur me argument, por këtu s'ka argument.

Shejkh El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Në të vërtetë, çështja është në cakun më të largët të problemit dhe ka nevojë për më shumë ndjekje e meditim, por për rezervë nuk duhet hequr dorë prej saj.”

Dyshimi për mbulesën

Kur ti dyshon: Vallë a ka ndonjë mbulesë që pengon arritjen e ujit mbi ndonjëren prej gjymtyrëve të abdesit që lahen ose i jepet mes'h dhe si duhet të veprojë njeriu?

Përgjigje:

Ai ka detyrë të thellohet në hulumtim, derisa të jetë plotësisht i bindur se uji ka arritur në vendin ku është farz, të arrijë, sepse dituria për veprim të sigurt e bën të detyrueshme diturinë me degët e saj, ose ashtu siç shprehen fukahatë: Veprimi i sigurt e bën të detyrueshëm përfundimin e sigurt. Ky është një rregull i përgjithshëm e i përdorshëm, pa asnjë përjashtim, në të gjithë kapitujt e fik'hut, që do të thotë: Kur ti e di me siguri se ky veprim është detyrë mbi ty, ti mban përgjegjësi për kryerjen e atij veprimi, por prej kësaj diturie që ti ke, lind detyrimi logjik, që do të thotë se ti e di mirë dhe je i bindur që e ke kryer atë veprim të plotë, praktikisht je çliruar prej përgjegjesisë.

Le ta ilustrim me një shembull: Kur ti e di se të kërkohet të japësh një dirhem për filanin dhe pastaj ti kujton se e ke mbajtur fjalën, ky kujtim i yti nuk është asgjë, por ke detyrë të mësosh me siguri se ti e ke mbajtur besën e dhënë plotësisht, ashtu siç e di mirë që ke marrë borxh, pasi diturinë nuk e heq asgjë tjetër përveç diturisë.

Por, sikur të supozosh, ose të kujtosh se ti me të vërtetë ke kërkuar borxh prej tij, atëherë mbi ty nuk rëndon asgjë.

Njeriu me probleme të urinimit dhe me probleme intensinale

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që i pikon urina dhe ai s'ka mundësi ta mbajë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur ai s'ka mundësi ta mbajë, në radhë të parë, i kërkohet ndjesë Allahut për pengesën dhe ai lidh nën vete një enë lëkure (sot përdoren qese plasmani, që të sëmuret e kësaj kategorie i varin në brez).

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që ka trazim në barkun e tij, ose ndonjë mundim, ose ndonjë vështirësi prej urinës, ndërsa është duke falur namazin farz dhe është në rekatën, e parë, ose në rekatën e dytë, ose në rekatën e tretë, ose në rekatën e katërt.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur ai preket nga ndonjë gjë e tillë, nuk ka asnjë problem që ai të dalë prej namazit për të kryer nevojën që ka, të marrë abdes dhe pastaj të kthehet në namazin që ishte duke falur, pastaj le të rifillojë faljen e namazit aty

ku e la në kohën, kur doli për të kryer nevojën, me kusht që të mos e ketë prishur namazin duke folur ndonjë fjalë.”

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Ai që ka probleme të shpeshta me barkun, merr abdes, pastaj kthehet në namazin e tij dhe plotëson namazin që i ka mbetur.”*

Fukahatë

Njeri me probleme të urinimit quhet personi që vuan nga sëmundja e daljes së pavullnetshme të urinës dhe nuk ka mundësi ta mbajë atë, kurse njeriu me ankesa intensinale, është personi që nuk mban dot defekimin.

Kur kjo kategori personash ka mundësi të mbajë urinimin ose defekimin për aq kohë sa është e mjaftueshme për të marrë abdes e për të falur namazin, për ata është farz që të mos e humbin këtë kohë, por ta shfrytëzojnë atë për të marrë abdes e për të falur namazin në mënyrë të plotë, ashtu siç duhet marrë abdes dhe ashtu siç duhet të falet namazi.

Në qoftë se ata nuk e kanë këtë mundësi dhe atyre u ndodh urinimi e jashtëqitja papritmas gjatë faljes së namazit, nëse një i sëmurë i kësaj kategorie ka mundësi, gjatë kohës që është duke falur namaz, le të mbajë enën me ujë pranë vetes dhe, nëse atij i ndodh rrjedhja e urinës ose defekimi, ta lerë namazin e të marrë abdes, gjithnjë i kthyer në drejtim të Kibles, pa pasur ndonjë vështirësi e mundim dhe pa folur asnjë fjalë, ose pa bërë ndonjë veprim tjetër që bie në kundërshtim me namazin, pastaj le të

kthehet në namazin që ishte duke falur dhe të vazhdojë faljen e namazit aty ku e la e ta plotësojë aq sa i ka mbetur prej namazit.

Në qoftë se ky i sëmure nuk ka mundësi të veprojë kështu, për shkak të vështirësisë që ka, ai merr abdes për çdo namaz që do të falë dhe është i falur për të papriturat që i ndodhin deri në përfundimin e namazit. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë se vetëm Allahut i kërkohet ndjesë, por këtij të sëmuri nuk i lejohet të falë dy namaze të bashkuara me një abdes të vetëm.

Shtrohet pyetja: Prej nga e kanë nxjerrë fukahatë këtë dispozitë, domethënë, që nuk lejohet falja e dy namazeve të bashkuara me një abdes të vetëm dhe mbi ç'bazë janë mbështetur ata, duke ditur se në fjalën e Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) nuk ka as tekst e as thënie tjetër për këtë çështje?

Përgjigje:

Vetëkuptohe se lejimi për të cilin tregojnë tekstet, në të vërtetë, përfshin lejimin prej jashtëqitjes gjatë faljes së namazit, kurse prishja e abdesit nga jashtëqitja, gjatë kohës ndërmjet dy namazeve, nuk përfshihet në këtë falje.

LARJA PREJ XHUNUBLËKUT

Në ligjin e fesë islame, ka larje të trupit që janë të detyrueshme (*farz*) dhe ka larje që janë të vullnetshme (*mustehab*), pra, ka gusël farz dhe gusël mustehab. Larjet farz të trupit janë gjashtë llojesh: larja prej xhunubllëkut, larja pas menstruacioneve, larja pas metrarogjisë (*istihâdah*) larja pas hemorragjisë së lehonisë, larja e të vdekurit dhe larja për shkak të prekjes së të vdekurit, pasi ai është ftohur dhe para pastrimit të tij.

Xhunubllëku

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا”

“...dhe nëse jeni xhunub, pastrohuni (lahuni)...” (Sure “El Maide, ajeti 6)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Larja e gjithë trupit prej xhunubllëkut është detyrë e domosdoshme (*farz*).”

Gjithashtu, ai ka thënë: *“Kush le pa larë me qëllim edhe një qime të vetme, ai nuk është larë prej xhunubllëkut dhe ai është në zjarr.”*

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!): *“Kur është farz larja (gusli) për burrin e për gruan?”* Ai është përgjigjur *“Kur e fut atë, bëhet farz gusli, mehri (shuma e kurorës) dhe rekhmi (ekzekutimi me gjuajtje me gurë për shkelje kurore).”*

Transmetohet se nipi Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *“Kur takohen dy vendet e synetllëkut, atëherë bëhet farz gusli.”*

Është pyetur për prekjen e kofshës: A e ka farz ai të bëjë gusël? Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Po, në rast se ka sekrecion të spermës.”*

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për gruan që sheh në ëndërr ato çka sheh burri. Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: *“Në qoftë se asaj i ndodh sekrecion, atëherë ajo e ka farz të bëjë gusël, por nëse asaj nuk i ndodh sekrecion, ajo nuk e ka farz të bëjë gusël.”*

Fukahatë

Për sa u përket thënieve të mësipërme, në lidhje me guslin farz, ato gëzojnë fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, madje duhet të theksohet se gusli është prej domosdoshmërive të fesë dhe kurrë nuk ka ndodhur që, qoftë edhe dy dijetarë të vetëm, të kenë mendime të ndryshme, të mëparshmit e të mëvonshmit, në lidhje me çështjen se xhunubllëku është shkak për të bërë gusël dhe xhunubllëku shkaktohet me dy rrugë: futja e kokës së penisit

dhe dalja e spermës si të vijë mbarë, dalja e spermës së rëndë, me vrull, me epsh, ose edhe pa epsh, kurse rruga e dytë e daljes së spermës ndodh në gjumë ose edhe zgjuar. Në lidhje me rrugën e dytë, kemi forma të shumta të kësaj dukurie:

Forma

Ndër format e daljes së spermës kemi: burri sheh në ëndërr se kreu marrëdhënie intime, por, kur zgjohet, nuk gjen ndonjë gjurmë. Ai nuk e ka detyrë të bëjë gusël.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që sheh ëndërr, sikur ndien epsh dhe ka dalje të spermës, por, pasi zgjohet, nuk shikon shenja të spermës as në rrobën e as në trupin e tij. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: *“Për këtë burrë nuk është farz të bëjë gusël.”*

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Në të vërtetë, bërja gusël është farz prej ujit të madh dhe, kur ai sheh ëndërr, por nuk shikon ujë, ai nuk e ka farz të bëjë gusël.”*

Gjithashtu, nga këto forma është: Kur prej burrit del spermë dhe ai bën gusël për shkak të xhunubllëkut, por pas guslit shikon lagështirë dhe nuk e di, nëse kjo lagështirë është apo nuk është prej spermës. A e ka farz ky burrë të bëjë gusël për herë të dytë?

Përgjigje:

Kur burri ka urinuar para se të bëjë gusël, ai nuk ka më detyrim ta përsërisë guslin dhe mbi të nuk rëndon asgjë. Kjo është për burrin, kurse gruaja, në asnjë rast, nuk e përsërit guslin, pavarësisht nëse ka urinuar ose nuk ka urinuar para se të bëjë gusël.

Argument për këtë sentencë është njoftimi që tregon se dikush ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që është bërë xhunub dhe ka marrë gusël para se të urinojë, por prej tij ka dalë diçka nga sperma. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Përsërit guslin.”*

Pyetësi tha: *“Po për gruan, prej së cilës del diçka, pasi ajo ka bërë gusël?”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: *“Ajo nuk e përsërit guslin.”*

Kur pyetësi kërkoi shpjegime në lidhje me ndryshimin mes burrit e gruas, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: *“Ajo që ka dalë prej gruas, në të vërtetë, është prej ujit të burrit.”*

Gjithashtu, prej këtyre formave kemi: Kur prej burrit del lagështirë, pa kryer marrëdhënie intime dhe ai nuk e di, nëse kjo lagështirë është apo nuk është spermë, ç’ detyrim ka ai?

Përgjigje:

Kur në këtë lagështirë janë të pranishme tre cilësitë: epshi, dalja e vrullshme dhe qetësim pas tensionimit, ai ka detyrë (*farz*) të bëjë gusël, ndryshe nuk e ka detyrë guslin.

Argument për këtë shërben fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Kur vjen epshi, sperma del me vrull dhe pastaj pas daljes së saj, vjen qetësimi. Ky njeri ka farz të bëjë gusël. Por nëse ai nuk gjen as qetësim dhe nuk ndien epsh, atëherë nuk ka problem.”*

Gjithashtu, nga këto forma është: Kur sperma del jo në vendin e zakonshëm, burri ka farz të bëjë gusël, sepse teksti i qartë e përfshin edhe këtë.

Gjithashtu, nga këto forma është: Kur burri shikon spermë në rrobën e tij, por ai dyshon, nëse kjo spermë është prej tij apo prej ndonjë tjetri. Mbështetur në rregullin e shoqërimit për pastrimin, ky burrë nuk e ka farz të bëjë gusël.

Kur burri bën gusël prej xhunubllëkut, por pas një farë kohe pas guslit shikon spermë në rrobën e tij dhe dyshon, nëse ajo është dalje e re pas guslit, ose ajo është sperma e xhunubllëkut për të cilën ai bëri gusël, ky burrë nuk e ka farz të bëjë gusël, sepse herën e parë ai bëri gusël prej xhunubllëkut, kurse hera e dytë është e dyshimtë dhe, si bazë, kjo herë e dytë mohohet, derisa të vërtetohet e kundërta.

Gjithashtu, nga këto forma është: Dy vetë kanë përdorur me radhë të njëjtën rrobë. Por më pas, mbi këtë rrobë u duk shenja e spermës, e cila pa dyshim që është e njërit prej atyre të dyve, por

nuk dihet se e cilit është konkretisht, a kanë farz të bëjnë gusël këta dy burra?

Përgjigje:

Jo, sepse çdo njërin prej këtyre të dyve, në të drejtën që ka secili, e shoqëron pastërtia. Veç kësaj, obligimi ligjor fetar i njërit prej këtyre të dyve, nuk lidhet me obligimin e tjetrit, përveçse nëse do të ndodhë që lidhja mes dy obligimeve të jetë në atë mënyrë që mbi njërin obligim të sistemohen gjurmët e tjetrit. Këtu qëndron edhe shkaku që fukahatë kanë dhënë sentencën (fetvënë): Këtyre të dyve nuk u lejohet të marrin me mëditje tjetrin për ta fshirë xhaminë, pasi në një gjendje të tillë, njëri prej të dyve do të ishte i detyruar drejtpërdrejt për të hyrë në xhami, ose shkaktar për të hyrë në të, por për njeriun xhunub hyrja në xhami, qoftë për detyrim të drejtpërdrejtë, qoftë për bërjen shkak, është rreptësisht e ndaluar (*haram*).

Gjithashtu, nuk lejohet që njëri prej këtyre të dyve të falë namaz, duke u bërë imam, pasi në këtë rast dihet që xhunub mund të jetë ose imami ose ai që i ujdiset imamit. Ndryshe qëndron çështja, nëse qenia xhunub do të ishte e shpërndarë në tri persona. Atëherë lejohet që njëri prej këtyre të dyve të prijë si imam për dy të tjerët, pasi mund të supozohet që xhunub është i treti. Në këtë rast, nuk arrihet të mësohet qenia xhunub për asnjërin prej atyre të dyve që të jepet përfundimi i prishjes së namazit të tij.

Qëllimet e guslit

Allahu i Lartësuar thotë:

“وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُطَهَّرِينَ”

“...dhe Allahu i do të pastruarit.” (Sure Teubeh” ajeti 108)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Mexhusët (adhuruesit e zjarrit) nuk laheshin prej xhunubllëkut, kurse arabët laheshin, pasi larja (gusli) është prej ligjeve të rrugës së drejtë.*”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë xhunub që ka dëshirë të flejë. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Më mirë është që ai të marrë abdes dhe pastaj të veprojë, por për mua, është më e dashur që ai të bëjë gusël.*”

Këto tekste dhe tekste të tjera të kësaj kategorie tregojnë se bërja e guslit, në vetvete, peshon më shumë, prandaj personi xhunub, në kërkim të fitimit të kënaqësisë së Allahut, ka detyrim të bëjë gusël kur të dëshirojë, pa pasur ndonjë qëllim tjetër. Gjithashtu, gusli bëhet me qëllim për adhurim të vullnetshëm, ose ai ka qëllim që me guslin farz të përgatitet për kryerjen e adhurimeve farz, siç janë falja e pesë namazeve dhe tavafi farz në Qabe.

Agjërimi dhe xhunubllëku

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që sheh ëndërr në fillimin e natës, në Muajin e Ramazanit, ose ai ka kontaktuar me familjen e vet dhe pastaj, me qëllim, fle, derisa

është zbardhur dita. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Plotëson agjërimin dhe nuk kryen agjërim kaza (të prapambetur).”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që agjëron në Muajin e Ramazanit, por në fillim të natës bëhet xhunub dhe nuk lahet (nuk bën gusël), derisa vjen fundi i natës, ndërkaq ai shikon se ka zbardhur agimi. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk e agjëron këtë ditë dhe agjëron ditët e tjera.”

Përsëri është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë të bërë xhunub në Muajin e Ramazanit, por që harron të bëjë dush, derisa mbaron i gjithë muaji. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai ka detyrë të domosdoshme (farz) të kryejë kaza (të prapambetura) namazin dhe agjërimin.”

Fukahatë

Mbështetur mbi këto tekste, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se larja (gusli) prej xhunubllëkut është farz për të agjëruar gjatë muajit të Ramazanit, gjithashtu gusli është farz edhe për të kryer agjërim kaza dhe, nëse ai ka qëndruar xhunub me qëllim në muajin e begatisë, në Ramazan, ai ka detyrë të agjërojë kaza ditët gjatë cilave ka qenë xhunub, plus agjërimin për shlyerjen (*keffâret*). Madje qëndrimi xhunub me qëllim shkakton që atij të mos i pranohet adhurimi, kurse ai që harron ose nuk e di, ka detyrë vetëm të agjërojë kaza.

Për sa i përket atij që kryen agjërim të vullnetshëm (*mustehab*), ai edhe mund të qëndrojë xhunub me qëllim. Kjo

sqarohet me përgjigjen që i ka dhënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) një burri për këtë çështje: “Më trego për agjërimin e vullnetshëm dhe për agjërimin e këtyre tri ditëve, kur unë jam xhunub që nga fillimi i natës, duke e ditur që jam xhunub, por me qëllim bie në gjumë dhe fle, derisa zbardh agimi. Të agjëroj apo jo? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë: “Agjëro.”

Ç’është haram për njeriun xhunub?

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për njeriun xhunub dhe për gruan me menstruacione, a mund të lexojnë ata diçka prej Kur’anit? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po, sa të dëshirojnë, me përjashtim të sexhdes,¹ gjithashtu ata e përmendin Allahun në çdo kohë.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për gruan në kohën e lehonisë, për gruan me menstruacione dhe për burrin xhunub, nëse për ta lejohet të lexojnë Kur’an. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Lexojnë sa të dëshirojnë.” Në një transmetim të dytë, ka thënë: “Lexojnë shtatë ajete.” Në një transmetim të tretë, ka thënë: “Edhe shtatëdhjetë ajete.”²

¹ Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) me fjalën “sexhde” kishte qëllim suret në të cilat urdhri për të bërë sexhde është në vetën e dytë dhe është farz që sexhdeja të bëhet, sapo të lexohet, ose sapo të dëgjohet ajeti i sexhdes. Këto ajete sexhdeje gjenden në katër sure: “El Alek”, “En Nexhm”, “Es Sexhdeh” dhe në suen “Fusilet”.

² Disa fukahë kanë bashkuar transmetimin për leximin e shtatë ajeteve me transmetimin për leximin e shtatëdhjetë ajeteve dhe kanë thënë se leximi më tepër se shtatë ajete është kerahet. Gjithashtu, kanë thënë se keraheti rëndohet akoma më shumë, kur leximi arrin në shtatëdhjetë ajete.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Njeriu xhunub nuk prek asnjë lloj monedhe argjendi e floriri mbi të cilën është stampuar emri “Allah”.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Njeriu xhunub nuk qëndron ulur në xhami, por ai mund të kalojë nëpër xhami, me përjashtim të xhamisë së shenjtë të Qabes dhe xhamisë së Medines.”*

Gjithashtu, Imami Sadiku (a.s.) ka thënë: *“Burri xhunub dhe gruaja me menstruacione marrin sendet që janë në xhami, por ata nuk mund të vënë në xhami ndonjë send.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë një mendim të përbashkët në lidhje me përmbajtjen e këtyre teksteve. Gjithashtu, kanë një fjalë të përbashkët se burrit xhunub, në mënyrë absolute, nuk i lejohet të prekë shkrimin e Kur’anit, pavarësisht se në atë shkrim është apo nuk është emri i Allahut, ose emri i Allahut dhe cilësitë e Tij, madje as kur shkrimi nuk është në librin e Kur’anit (mus’haf).

Gjithashtu, ai nuk lexon katër suret e sexhdeve. Për atë është veprim jo i pëlqyer (kerahet) leximi i pjesëve të tjera të Kur’anit, madje keraheti bëhet akoma më i rëndë, kur ai lexon më shumë se shtatë ajete prej këshilluesit Famëlartë (Kur’anit).

Atij nuk i lejohet të qëndrojë në xhami, në të gjitha xhamitë, por ai ka të drejtë të ecë kalimthi nëpër xhami, me përjashtim të xhamisë së Qabes dhe xhamisë së të Dërguarit më të madh (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), sepse

burrit xhunub nuk i lejohet as të qëndrojë e as të ecë në këto dy xhami.

Degëzim mbi hyrjen në xhami

Nga teksti që lejon marrjen e sendeve prej xhamisë dhe moslejimin për të vënë gjë në të, nxirret degëzimi që burri xhunub ka të drejtë të hyjë në xhami dhe të marrë aty ujë, me të të cilin do të bëjë gusël, domethënë me atë ujë do të lahet prej xhunubllëkut, pavarësisht se ky veprim nënkupton qëndrimin në xhami për një kohë të shkurtër. Por ai, edhe për këtë qëndrim në xhami, ka detyrë të bëjë tejemum, por ai nuk bën tejemun për të hyrë, me qëllim që të ecë nëpër xhami. Burri xhunub, pasi merr ujin në xhami, sapo të dalë prej xhamisë, atij i prishet tejemumi për shkak të gjetjes së ujit.

Meriton të theksohet se ky tejemum vlen vetëm për qëndrimin në xhami dhe vetëm për aq kohë sa është e domosdoshme, kurse prekja e shkrimit të Kur'anit, leximi i ajeteve të sureve që urdhërojnë sexhden në vetën e dytë, bëj sexhe, "واَسجد" bëni sexhde "واواَسجد", si dhe veprime të tjera, ky tejemum është plotësisht si tejemumi i marrë për të falur vetëm namazin, në rastet kur koha nuk premtion koha të bëhet gusël, ose të merret abdes.

Mënyra e bërjes gusël

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për larjen e trupit (guslin) prej xhunubllëkut. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Laj dy shputat e duarve të tua, pastaj me të djathtën tënde hidh ujë mbi të majtën tënde dhe laj vendet e turpit e dy bërrylat. Pastaj shpëllaj gojën, duke rrotulluar ujin nëpër zgavrën e gojës (madmadah), pastaj thith ujë në brendësi të vrimave të hundës (istinshak), pastaj laje trupin nga maja e kokës deri në fundin e majave të gishtave të këmbëve.”* Nuk merret abdes as para e as pas guslit, pasi çdo pjesë që ka prekur uji, ai e ka pastruar atë. Sikur një burrë xhunub të zhytet në ujë vetëm një herë, derisa uji e mbulon plotësisht me gjithë kokën, me këtë zhytje ai e ka kryer guslin, edhe pse nuk e ka fërkuar trupin e tij.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë xhunub, nëse konsiderohet se ka bërë gusël, kur qëndron në shi, derisa i laget trupi e koka, megjithëse ai ka fuqi e mundësi të lahet me mënyrë tjetër.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Në qoftë se ai lahet më këtë ujë, kjo larje është e vlefshme.”*

Fukahatë

Fukahatë, pasi bënë farz, në larjen e trupit prej xhunubllëkut, ato veprime që bënë farz edhe për marrjen abdes, siç ishte nijeti për t’u pastruar prej gjembave të hipokrizisë, vijimësia e larjes së pjesëve të trupit deri në përfundimin e guslit, lëshimi i ujit mbi trup, pastërtia e ujit, uji është i lejuar, kanë thënë:

“Gusli prej xhunubllëkut është dy formash: sistemim veprimesh dhe zhytje e plotë në ujë.”

Sistemimi

Gusli i sistemuar, do të thotë të fillohet gusli me larjen e kokës e të qafës, pastaj lahet ana e djathtë e trupit, prej supit deri te majat e gishtave të këmbës. Pastaj me të njëjtën mënyrë lahet edhe ana e majtë e trupit.

Një grup prej fukahave të mëdhenj janë shprehur se sistemimi i veprimeve nuk është farz dhe larja e trupit lejohet si të vijë për mbarë. Kështu thonë edhe fukahatë e Ehli Sunetit. Autori i librit “El Medàrik”, pasi ka përmendur transmetimet, ka thënë: “Këto transmetime, domethënë transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit, janë transmetime të qarta.

Në këto transmetime nuk ka asnjë mangësi dhe të gjitha flasin se nuk është farz kryerja e sistemuar e veprimeve për larjen sipas radhës për të dyja anët e trupit, domethënë, në fillim lahet ana e djathtë e trupit dhe pastaj lahet ana e majtë. Këto transmetime kanë ardhur në pozitën e shpjegimit të qartë të mohimit total. Gjithashtu, edhe veprimi sipas këtyre transmetimeve është i njëanshëm, përveç rasteve, kur me këto transmetime, për rezervë, veprojnë shumica e fukahave.”

Kjo do të thotë se fjalët e Ehli Bejtit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!*) kanë ardhur për të mësuar e për të qartësuar çdo veprim që është farz të kryhet gjatë guslit, si dhe për ta bërë të qartë se, sikur të ishte farz sistemimi i veprimeve, do të ishte farz

edhe përmendja e sistemimit. Megjithëkëtë, në asnjë rast nuk lejohet që sistemimi të neglizhohet, megjithëse për sistemimin s'ka as burim e as gjurmë në fjalët e tyre. Por ky fakt tregon vetëm se sistemimi nuk është farz.

Shejhu El Hamedànij, në librin “Misbàhul Fakijh”, ka thënë: “Thënia për mossistemimin mes anës së djathtës dhe anës së majtë, është shumë e fuqishme, por fakti që edhe kundërshtimi i sistemimit është mjaft e përhapur, përbën problem.”

Ne i përgjigjemi atij, gjithashtu, me një thënie tjetër mjaft të përhapur, që thotë se miratimi i asaj që është në zë, por pa argument, është me më shumë problem. Një transmetues njoftimesh tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Larësi i të vdekurit të fillojë me larjen e kokës së të vdekurit, pastaj ai e kthen të vdekurin në anën e majtë dhe i lan anën e djathtë, pastaj e kthen në anën e djathtë dhe i lan anën e majtë.”

Kjo fjalë e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se të gjitha larjet janë sipas këtij sistemimi.

Përgjigjja jonë për këtë është: Analogjia e të gjallëve me të vdekurit është plotësisht si analogjia e bimëve me trupat e ngurtë. Veç kësaj, ata që kanë bërë farz sistemimin mes tri gjymtyrëve: kokës, së bashku me qafën, anës së djathtë dhe anës së majtë, kanë thënë se nuk është detyrë e domosdoshme që larja të bëhet nga fillimi i çdo gjymtyre, ashtu siç veprohet në marrjen abdes, por lejohet që larja të fillohet edhe nga fundi i anës së djathtë, gjithashtu, edhe poshtë anës së majtë.

Fukahatë kanë një mendim të përbashkët se nuk është farz as vijueshmëria e as larja e menjëhershme e gjymtyrëve njëra pas

tjetrës. Le ta ilustron me një shembull: Sikur ai të lajë kokën e tij dhe pas disa orësh lan anën e tij të djathtë dhe pas një farë kohë lan edhe anën e majtë, larja e tij është e vlefshme.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka treguar: “Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk shikonte ndonjë problem të lante në mëngjes herët vetëm anën e djathtë dhe kokën e tij dhe të lante gjithë trupin, kur të vinte koha për faljen e namazit.

Zhytja në ujë

Mënyra e dytë për larjen e trupit prej xhunubllëkut (bërja gusël), është zhytja në ujë, domethënë personi xhunub e zhyt trupin e tij në ujë të pastër, në atë mënyrë që uji vetëm me një zhytje të mbulojë të gjithë pjesët e turpit të tij. Kështu qëndron çështja, edhe nëse ai qëndron në shi, me nijetin e zhytjes në ujë. Unë mendoj se është më mirë që ai të bëjë nijet sistemimin e veprimeve dhe të kalojë ujin me dorën e vet mbi trupin e tij.

Çështje

1- Kur personi është duke marrë gusël, urinon, ose atij i dalin gazra para se të përfundojë larjen e gjithë trupit, si do të veprojë ky njeri?

Përgjigje:

Plotëson guslin dhe merr abdes për të falur namaz, sepse ato që dolën prej tij, nuk e bëjnë farz guslin, por ato bëjnë farz marrjen e abdesit. Në lidhje me këtë çështje, prej Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*), nipit të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kemi një transmetim që tregon se është farz përsëritja e guslit nga e para. Gjithashtu, autori i librit “El Medàrik” ka thënë: “Unë nuk qëndroj në argumentin e këtij transmetimi, pasi detyra është që ai të plotësojë guslin dhe pas guslit të marrë abdes.”

Sej’jid El Hakijm ka miratuar fetvanë e autorit të librit “El Medàrik”, si dhe thëniet e tij në lidhje me transmetimin e pretenduar.

2- Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, çdo gusël është së bashku me abdesin, përveç larjes prej xhunubllëkut.

3- Patjetër duhen të pastrohen të gjitha pjesët e trupit dhe, në radhë të parë, ai fillon me larjen e gjymtyrës së ndotur me papastërti, pastaj ai bën nijet për larjen e turpit prej xhunubllëkut. Nuk ka dyshim se pastrimi i gjymtyrës së ndotur, para se të fillohet larja, është veprimi më i preferuar.

Kur ai dyshon se mbulesa pengon arritjen e ujit në lëkurë, është detyrë të hulumtohet, derisa të mësohet e të bëhet e qartë arritja e ujit, sepse vetë dituria që gusli është farz, e bën të detyrueshme edhe diturinë për përvetësimin e kryerjes së gushit, sipas mënyrës së kërkuar, ashtu siç pamë më sipër edhe në kapitullin e abdesit.

4- Ai dyshon, nëse e ka larë ose jo kokën e tij, kur bën gusël prej xhunubllëkut. Nëse ky dyshim i vjen atij para se të fillojë larjen e anës së djathtë, ai ka detyrë ta lajë kokën, sepse ky dyshim i tij është para se ai të hyjë në një veprim tjetër. Gjithashtu, mbi të nuk është veprues rregulli i shlyerjes, për të cilin kemi folur në kapitullin e abdesit.

Por, nëse ai dyshon, pasi ka filluar larjen e anës së majtë, atëherë ai nuk e lan kokën, sepse, në fakt, ai ka hyrë në një veprim tjetër, prandaj mbi të është veprues rregulli i lartpërmendur. Po kështu gjykohet, kur ai dyshon në krahun e djathtë, në analogji me krahun e majtë. Nëse ai dyshon në krahun e majtë, nëse dyshimi i vjen, pasi ka filluar larjen e kësaj ane, ai nuk kthehet ta lajë kokën, ndryshe ai ka detyrë ta lajë atë.

5- Kur ai ka falur namaz dhe, pasi ka dalë nga falja e namazit, dyshon dhe ngurron, nëse ai është larë ose jo prej xhunubllëkut para se të falte namaz, si do të veprojë ky njeri?

Përgjigje:

Në të vërtetë, namazi i tij është i vlefshëm dhe ai nuk ka detyrë ta përsërisë faljen e namazit, sepse ai dyshoi në vlefshmërinë e namazit, pasi kishte dalë prej namazit. Në këtë rast, mbi këtë njeri është veprues rregulli i përfundimit, por ai ka detyrë të bëjë gusël për veprimet e tjera, sipas rregullit të shoqërimit që supozon mbetjen e tij xhunub. Këtu nuk kemi mohim për diferencën e objektit, sepse objekti i rregullit është vlefshmëria e namazit dhe shoqërimi i të qenit xhunub. Është e

vetëkuptueshme se mohimi hiqet për shkak të një numri objektesh.

6- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ti bën gusël para agimit, ky gusël zëvendëson: larjen tënde prej xhunuybllekut, guslin për ditën e Xhumasë, guslin për ditën e Arafatit, guslin për ditën e Kurban Bajramit, guslin për therjen e kurbanit dhe guslin për tavafin e vizitës. Kur Allahu bashkon për ty kaq detyrime, Ai edhe i shlyen ato për ty me një gusël të vetëm. Po kështu, Allahu shlyen për gruan me një gusël të vetëm: guslin për larjen e saj prej xhunubllëkut, guslin për veshjen e ihramit, guslin për pjesëmarrjen e saj në xhemat, guslin për larjen pas menstruacioneve dhe guslin për ditë Bajrami.”

Siç e shikon, fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) përmbledh të gjitha llojet e guslit për njeriun, kur ai arrin moshën, kur obligohet me kryerjen e adhurimeve të detyrueshme të fesë, pavarësisht nëse këto obligime, në tërësinë e tyre, janë adhurime farz, ose janë adhurime të pëlqyeshme (*mustehab*), ose janë farz dhe *mustehab*, ndër të cilat edhe larja e trupit (*gusli*) prej xhunubllëkut, qoftë gusël farz, ose *mustehab*.

* * *

MENSTRUACIONET (hajd), METRAROGJIA (istihàdah)

DHE LEHONIA (nifàs)

Allahu i Lartësuar thotë:

”وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ ۖ قُلْ هُوَ أَدَىٰ فَأَعْتَرِلُوا النِّسَاءَ فِي الْمَحِيضِ ۖ وَلَا تَقْرُبُوهُنَّ حَتَّىٰ يَطْهُرْنَ ۖ فَإِذَا تَطَهَّرْنَ فَأْتُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ أَمَرَكُمُ اللَّهُ ۚ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ“

“Të pyesin ty (Muhamed) për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: “Ajo është gjendje e dëmshme.” Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar Allahu. Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.” (Sure, “El Bekare, ajeti 222)

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur gruaja arrin pesëdhjetë vjeç, ajo nuk shikon më të kuqe, përveçse kur është grua prej kurejshëve.”

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur femra mbush nëntë vjeç, ka mundësi që asaj t’i vijjnë menstruacionet.”

Gjithashtu, Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha më e paktë e menstruacioneve është tri ditë dhe koha më gjatë është dhjetë ditë.”

Gjithashtu, Imami Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha e pastrimit prej menstruacioneve nuk mund të jetë më pak se dhjetë ditë, që nga koha që ajo pastrohet, derisa të shikojë përsëri gjak.”

Fukahatë

Gjakun që shikon gruaja, fukahatë e kanë ndarë në tri kategori: gjak menstrual (*hajd*), gjak metrarogji (*istihadah*) dhe gjak pas lindjes (*nifas*).

Menstruacionet janë gjaku që del prej vaginës, jo për shkak të ndonjë sëmundjeje, as nuk është hemorragji pas lindjes. Allahu i Lartësuar e ka shkruar këtë hemorragji për gratë, për të ruajtur trungun gjenealogjik dhe për të mësuar pastërtinë e mitrës.

Gjaku i menstruacioneve rrëshqet prej thellësive të trupit për në mitër, e cila e grumbullon atë gjatë kohës së pastrimit dhe për këtë shkak është quajtur me fjalën “*kur’un*”, në analogji me shprehjen e arabëve: u grumbullua uji, kur uji mblidhet në një pellg.

Kurse hemorragjia pas lindjes (*demu n’nifās*), është gjaku që del prej vaginës pas lindjes. Siç do ta trajtojmë më poshtë, dispozita e këtij gjaku është e njëjtë me dispozitën për gjakun e menstruacioneve.

Për sa i përket gjakut të metrarogjisë (istihàdah), ai nuk është as gjak menstruacionesh e as gjak i dalë pas lindjes, por është gjak i dalë për shkak të ndonjë anomalie, ose ndonjë sëmundjeje.

Fukahatë

Menstruacionet nuk fillojnë pa mbushur femra nëntë vjet hënorë. Nëse femra shikon gjak para kësaj moshe, ai nuk është gjak menstrual, por është hemorragji e shkaktuar prej ndonjë sëmundjeje ose prej ndonjë anomalie. E njëjta gjë është edhe për gruan kurejshe, kur ajo shikon gjak pas të gjashtëdhjetave, kurse për gratë jokurejshe, kjo moshë është pesëdhjetë vjeç. Pas kësaj moshe, gjaku që mund të shikojë gruaja, nuk është gjak menstrual, por është gjak i shkaktuar nga sëmundja ose nga ndonjë anomali.

Nëse dyshojmë dhe nuk e dimë, nëse një grua është apo nuk është kurejshe, në këtë rast, kjo grua hyn në dispozitën për gruan jokurejshe, sepse si bazë është që të mos i atashohet tribusë kurejshe.

Kur dyshojmë se vajza ka mbushur nëntë vjeç, atëherë ajo nuk e ka arritur moshën e pjekurisë (*bàligah*), gjithashtu, kur dyshojmë se një grua i ka kaluar të pesëdhjetat, ose të gjashtëdhjetat, mbështetur në rregullin e shoqërimit, ajo hyn në dispozitën e gruas që nuk shikon më menstruacione.

Kohëzgjatja më e paktë e menstruacioneve është tri ditë. Në qoftë se menstruacionet vazhdojnë tri ditë pa një orë, atëherë ato nuk janë menstruacione. Kohëzgjatja më e madhe e

menstruacioneve është dhjetë ditë. Gjithashtu, hemorragjia që zgjat më shumë se dhjetë ditë, nuk është gjak menstrual.

Kohëzgjatja e pastrimit që ndan dy menstruacione dhe që konsiderohet koha absolute e pritjes, domethënë koha më e paktë, është dhjetë ditë, kurse kohëzgjatja më e madhe e pastrimit, deri në ciklin e ardhshëm, është e pakufizuar.

Gjaku menstrual, në të shumtën e herëve, është i ngrohtë, jo i ndenjtur (*taze*) dhe ka ngjyrë të zezë dhe, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), ai del me vrull dhe është i nxehtë.

Pyetje-përgjigje:

Pyetje: Fukahatë kanë thënë se menstruacionet janë shenjë treguese që femra ka arritur pjekurinë seksuale. Por kjo fjalë nuk përputhet me thënien e tyre se hemorragjia që sheh femra para moshës nëntë vjeç nuk është menstruacion.

Përgjigje:

Ka një dallim shumë të madh mes diturisë që ajo është më pak se nëntë vjeç dhe mes mosdijes e mosnjohjes së viteve, sepse gjaku që ajo shikon në rastin e parë, nuk është gjak menstrual, kurse gjaku që ajo shikon në rastin e dytë, është gjak menstrual dhe është shenjë treguese që ajo ka arritur moshën e pjekurisë, me kusht që në këtë gjak të gjenden të gjitha cilësitë e gjakut menstrual. Pikërisht këtë kanë pasur qëllim fukahatë me fjalën e tyre.

Rregulli i mundësisë

Në kapitullin e menstruacioneve fukahatë kanë përmendur një rregull, të cilin e kanë emërtuar “Rregulli i mundësisë” dhe që konsiston në çdo hemorragji që mund të jetë gjak menstrual, janë menstruacione. Kjo do të thotë se është rregull bazë se gjaku që del prej vaginës së gruas, është menstruacion, derisa të mësojmë se ai nuk është menstruacion. Këtë e mësojmë: 1. Kur femra ka parë gjak, para se të mbushë nëntë vjeç. 2. Ose ajo ka parë gjak, pasi ka kaluar të gjashtëdhjetat, nëse është kurejshe. 3. Ose ka kaluar të pesëdhjetat, kur s’është kurejshe. 4. Ose para se të kalojnë dhjetë ditë prej kohëzgjatjes së pastrimit. 5. Ose kur kalojnë dhjetë ditë nga kohëzgjatja e menstruacioneve, pasi hemorragjia më shumë se dhjetë ditë, nuk është e mundur të jetë gjak menstrual. 6. Ose menstruacionet nuk kanë vazhduar tri ditë njëra pas tjetrës. 7. Ose kur dihet se është gjak plage ose gjak virgjërie.

Kur nuk vërtetohet asgjë nga këto që u thanë, ndër të cilat edhe mundësia që ai gjak të jetë menstruacion, por edhe vetëm mundësia është e mjaftueshme për të vërtetuar se ai është gjak menstrual, domethënë, sikur gjaku të jetë homogjen ose i ndryshëm, kjo mund të atashohet në spontanitet, sipas shënimeve që janë në njoftimet e gërshetuara e të shumta në lidhje me renditjen e gjurmëve të menstruacioneve, domethënë shikimi i gjakut menstrual, pa marrë në konsideratë të gjitha mundësitë. Të këtij mendimi janë: El AlàmeH në librin “Et Tedhkireh”, autori i librit “Esh Sheràia”, si dhe shejkh El Hamedànij në librin “Misbàhul Fakijf”.

Llojet e menstruacioneve

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një vajzë të virgjër. Asaj i vijnë menstruacionet për herë të parë, një muaj i vazhdojnë dy ditë dhe një muaj tjetër tri ditë. Pra, asaj i ndryshon menstruacioni i parë në muaj disa ditë, në mënyrë të barabartë. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo ka të drejtë të mos bëjë asgjë. Ta lërë faljen e namazit, përderisa shikon gjak dhe nuk kanë kaluar dhjetë ditë. Nëse ditët, gjatë dy muajve, puqen në mënyrë të barabartë, ato ditë janë ditë menstruacionesh.”

Në një transmetim tjetër tregohet se ai ka thënë: “Në muajin e parë, gjaku ndërpritet në kohën e vet në mënyrë të barabartë, edhe pas dy ose tre menstruacionesh, derisa të mësohet se kjo kohë është bërë për këtë femër cikël i ditur dhe një sjellje e njohur, atëherë ajo do të ndjekë vetëm këtë cikël.”

Duhet të tërhiqet vëmendja në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Është bërë cikël i ditur dhe një sjellje e njohur”, pra, dy menstruacionet përputhen në kohë, ashtu siç vërtetohet zakonisht. Kur zakoni vërtetohet, veprohet sipas këtij vërtetimi të zakonit dhe lihet çdo gjë tjetër.

Fukahatë

Fukahatë i kanë ndarë menstruacionet në pesë kategori:

E para: Cikli i saj të jetë bërë udhëzues në kohë e në numër ditësh, si ajo që shikon gjak dy herë, ose më shumë në fillim të çdo

muaji vetëm për pesë ditë dhe as më shumë e as më pak se kaq, domethënë, ajo nuk shikon një herë pesë ditë, një herë tjetër katër ditë dhe herë tjetër gjashtë ditë, ose herë në fillim të muajit dhe herë tjetër në fund të muajit, kurse herë tjetër asaj i vijnë menstruacionet në mesin e muajit.

Me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, kjo femër e le faljen e namazit, pavarësisht se gjaku ka apo nuk ka cilësitë e gjakut të menstruacioneve.

E dyta: Cikli i saj të jetë bërë udhëzues si kohë, por jo si numër ditësh, si ajo që shikon gjak në fillim të çdo muaji, por që herë i vazhdon tri ditë dhe herë katër ditë ose më shumë. Ky cikël quhet udhëzues kohor me ditë të ndryshueshme.

Edhe kjo grua e le faljen e namazit, ashtu si e para, sapo të shikojë gjak.

E treta: Cikli i saj të jetë bërë udhëzues si numër ditësh, por jo si kohë, si ajo që shikon gjak për çdo herë pesë ditë, por ajo, herë e shikon gjakun në fillim të muajit dhe herë tjetër në fundin e muajit, kurse herë tjetër e shikon në mesin e muajit. Ky cikël quhet udhëzues për ditët dhe i ndryshueshëm në kohë.

Edhe kjo grua e le faljen e namazit, sapo të shikojë gjak, me kusht që gjaku të ketë cilësitë e menstruacioneve. Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur gjaku është i ngrohtë, del me vrull dhe është i zi, atëherë ajo le të lërë faljen e namazit.” Nëse gjaku nuk është me cilësitë e menstruacioneve, ajo grua ka detyrë të lërë ato veprime që le gruaja me menstruacione të rregullta, siç janë hyrja në xhami, etj. Adhurimet i kryen ashtu

siç i kryen gruaja me metrarogji, siç janë agjërimi dhe falja e namazit.

E katërta: Cikli i saj kurrë nuk është bërë udhëzues, as si kohë e as si numër ditësh, si ajo që shikon gjak, herë katër ditë në fillim të muajit dhe herë tjetër shikon gjak pesë ditë në fund të muajit, kurse herë tjetër shikon gjak tri ditë në mesin e muajit. Ky cikël quhet i ndryshueshëm në kohë e në numër ditësh, prandaj kjo grua hyn në dispozitën e grave të kategorisë së tretë, domethënë ajo le faljen e namazit, nëse gjaku ka cilësitë e menstruacioneve, ndryshe ajo ka detyrim të jetë e rezervuar, domethënë të shikojë me kujdes, nëse gjaku është me të vërtetë menstruacion.

E pesta: Femra që shikon gjak për herë të parë, quhet fillestare. Kjo femër hyn plotësisht në dispozitën e kategorisë së tretë dhe të katërt, sepse e treta, është me cikël të çrregullt dhe cikli i çrregullt është në kohë e në ditë, prandaj edhe fillestaren e përfshin fjala e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “Kur gjaku është i ngrohtë, del me vrull dhe ka ngjyrë të zezë, ajo le të lërë faljen e namazit.”

Tejkalimi i ditëve të zakonit

Kur gruaja ka zakon ditësh të caktuar, por në një cikël ndodh që asaj i vazhdojnë menstruacionet më shumë ditë nga zakoni i saj, por nuk tejkalojnë dhjetë ditë, si për shembull ajo e ka ciklin pesë ditë dhe menstruacionet i vazhdojnë deri në shtatë ditë, ose edhe vetëm dhjetë ditë, të gjitha këto ditë janë ditë menstruacionesh. Por nëse hemorragjia vazhdon më shumë se

dhjetë ditë, menstruacione për këtë grua janë vetëm ditët e zakonit të saj, deri në dhjetë ditë, kurse hemorragjia që vazhdon mbi dhjetë ditë, është metrarogji, përfshirë edhe ditët që janë brenda dhjetëditëshit. Një shembull: Kur asaj i vazhdojnë menstruacionet njëmbëdhjetë ditë dhe cikli i zakonshëm është vetëm pesë ditë, menstruacione janë vetëm pesë ditët e para, kurse gjashtë ditët e tjera janë metrarogji (*istihādah*).

Menstruacionet dhe gjaku

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse gruaja shtatzënë shikon gjak, a duhet ta lërë faljen e namazit?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Po, ngjet që gruaja shtatzënë nxjerr gjak.”

Mbi këtë thënie janë bashkuar shumica e fukahave, çka do të thotë se mund të ndodhë që menstruacionet të jenë edhe në kohën e barrës.

Ato thonë të vërtetën

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha e pritjes (*id'det*), e përcaktuar në ligjin e fesë, për të vërtetuar shtatzëninë dhe menstruacionet, kur e pohojnë vetë gratë, ato thonë të vërtetën.”

Për këtë nuk ka asnjë mendim ndryshe në mesin e fukahave.

Ç'është e ndaluar (haram) për gruan me menstruacione?

Gruaja me menstruacione ka të ndaluar gjithçka ishte e ndaluar për burrin xhunub, por duhet të theksohet se agjërimi dhe falja e namazit për burrin xhunub janë të vlefshme në raste pengesash të justifikuara, kurse për gruan në kohën e menstruacioneve, në asnjë rast, nuk është i vlefshëm as agjërimi e as falja e namazit. Gjithashtu, lejohet divorcimi i gruas jashtë kohës së menstruacioneve, edhe nëse ajo është xhunub, por divorci nuk është i vlefshëm, kur gruaja është në ciklin e menstruacioneve, me përjashtim të disa rasteve, të cilat me lejen e Allahut do t'i përmendim në kapitullin e divorcit. Gjithashtu, lejohet kryerja e marrëdhënieve intime me gruan xhunub, por nuk lejohet kryerja e marrëdhënieve intime me gruan gjatë menstruacioneve. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar, në librin e Tij, thotë:

“...فَاعْتَرِلُوا السَّاءَ فِي الْمَجِيضِ...”

“...prandaj largohuni prej grave gjatë menstruacioneve...”

Gjithsesi, burri gëzon të drejtën e dëfrimit me gruan, por jo nga përpara e as nga prapa. Gjithashtu, për burrin është veprim i neveritshëm (*keràhet*) të dëfrejë me gruan në pjesën ndërmjet kërthizës e gjunjëve.

Për burrin që mposht epshi dhe ai mëkaton e kryen marrëdhënie me gruan e vet, kur ajo është me menstruacione, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ai ka detyrë të japë sadaka: një dinar, nëse menstruacionet janë larguar prej fillimit të tyre,

një gjysmë dinari, nëse menstruacionet janë në mesin e tyre dhe një të katërtën e dinarit, kur menstruacionet janë në fundin e tyre."

Nëse ky burrë nuk ka se ç'të japë sadaka, atëherë le t'i kërkojë Allahut faljen e mëkatit, të bëjë pendimin e sinqertë dhe të mos i rikthehet veprimit të bërë, sepse kërkimi i faljes për mëkatin e bërë është *pendim (teubeh)*, është edhe adhurim shtesë për shlyerjen e mëkatit për atë person që nuk ka mundësi e fuqi as të japë sadaka e as të bëjë adhurimin shtesë për shlyerjen e mëkatit.

Gusli i gruas me menstruacione

Gruaja ka detyrë (farz) të bëjë gusël pas përfundimit të menstruacioneve, që të falë namaz, të agjërojë e të bëjë tavaf në Qabe, si dhe të bëjë të gjitha veprimet e tjera që u thanë kur trajtuam larjen (*guslin*) prej xhunubllëkut.

Mënyra e bërjes gusël për gruan me menstruacione është si mënyra e bërjes gusël për burrin xhunub, qoftë kur gusli bëhet sipas sistemimit të veprimeve, qoftë kur gusli bëhet me zhytje në ujë. S'ka asnjë dallim mes guslit për shkak të menstruacioneve dhe guslit për shkak të xhunubllëkut. Duhet të theksohet se në guslin prej xhunubllëkut nuk merret më abdes, kurse në guslin e gruas për shkak të menstruacioneve, ajo patjetër duhet të marrë abdes, sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "*Në çdo gusël merret abdes, përveç guslit prej xhunubllëkut.*"

Një grup fukahash të mëdhenj kanë thënë: "*Në të gjitha llojet e guslit nuk merret më abdes, madje as në guslin mustehab.*" Edhe Sej'jid El Hakijm priret kah ky mendim, të cilin ai e ka

shprehur në librin “El Mustemsek”, ku tekstualisht e germë për germë thuhet: “Ligjvënësi (Allahu) ka ligjëruar dy pastrime: abdesin dhe guslin. Secili prej këtyre dy pastrimeve është i vlefshëm për kryerjen e çdo veprimi në të cilin ai pastrim është ligj, pa qenë nevoja që njëri pastrin t’i bashkëngjitet pastrimit tjetër.”

Gjithashtu, El Hakijmi, thënien e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në çdo gusël ka abdes përveç guslit prej xhunubllëkut” e ka mbartur vetëm “për të vërtetuar ligjshmërinë”, domethënë se abdesi është i vlefshëm dhe është farz të merret abdes në mënyrë të veçantë kur bëhet gusël.

Kryerja e adhurimeve të prapambetura (kazà)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Gruaja me menstruacione kryen agjërimin e prapambetur (kazà), por ajo nuk kryen kaza namazet e prapambetura.”

Metrarogjia (istihàdhah)

Një grua hyri te Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e pyeti për një grua që i vazhdon hemorragjia dhe ajo nuk e di, nëse është gjak menstruacionesh apo gjak tjetër. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Gjaku i menstruacioneve është i ngrohtë, i freskët dhe me ngjyrë të zezë, domethënë gjaku i menstruacioneve del me shkulma dhe është i nxehtë, kurse gjaku i metrarogjisë, është me ngjyrë të verdhë dhe i ftohtë. Pra, kur gjaku është i nxehtë, del me shkulm dhe është i zi, ajo menjëherë le ta lërë faljen e namazit.” Gruaja u largua

duke thënë: *“Pasha Allahun, edhe sikur të ishte grua, nuk do të kishte shtuar gjë tjetër mbi ato që ai tha.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Gruaja me metrarogji pret ditët e saj, në të cilat ajo nuk fal namaz dhe asaj nuk i afrohet burri i vet. Nëse ditët e saj tejkalohen dhe gjaku që ajo shikon e shpon pambukun, ajo bën gusël për të falur namazin e mesditës dhe namazin e pasdites, e vonon ose e shpejton faljen e këtyre dy namazeve. Gjithashtu, bën gusël për faljen e namazit të mbrëmjes e të darkës, por e vonon ose e shpejton edhe faljen e këtyre dy namazeve. Gjithashtu, ajo bën gusël për faljen e namazit të mëngjesit, pastaj vë mbrojtëse, në xhami ajo nuk përkulet dhe i bashkon kofshët e saj. Gjatë ditëve të hemorragjisë, burri nuk kryen marrëdhënie me të. Ai i afrohet asaj vetëm, pasi asaj t’i kalojnë ditët e ciklit të menstruacioneve.”*

Në disa transmetime, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Gjaku i metrarogjisë është i dekompozuar.”*

Fukahatë

Më lart kemi thënë se gjaku që shikon gruaja, përveç gjakut të plagëve, çibanëve dhe gjakut të virgjërisë, patjetër duhet të jetë njëri prej tri kategorive të gjakut: ose gjak menstruacionesh, ose hemorragji pas lindjes, ose metrarogji. Nëse dy kategori gjaku pastrohen, caktohet kategoria e tretë. Thënë ndryshe, ashtu siç kemi thënë më përpara: Rregulli i mundësisë nënkupton se gjaku që shikon gruaja, ka mundësi të jetë gjak menstruacionesh, derisa të mësohet se ai nuk është gjak menstruacionesh. Kur ne të mësojmë se ai gjak nuk është gjak menstruacionesh, as hemorragji pas lindjes dhe as gjak i virgjërisë, etj., jemi të detyruar të pohojmë

se ai është gjak nga sëmundje ose është gjak i dekompozuar, domethënë është metrarogji (*istihādḥah*). Metrarogji është edhe gjaku që shikon gruaja pas dhjetë ditëve të menstruacioneve, ose gjaku që ajo shikon kur menstruacionet asaj i vazhdojnë më pak se tri ditë rresht. Gjithashtu, është metrarogji gjaku që shikon femra e vogël, pa mbushur nëntë vjeç, ose kur gruaja ka hyrë në moshën e shterimit të menstruacioneve. Në këto raste, ky gjak nuk është gjak menstruacionesh dhe, duke e ditur se nuk është as gjak që del pas lindjes së fëmijës, atëherë ky gjak patjetër është metrarogji. Me këtë pohim kemi një rregull të dytë, që thotë: Çdo gjak që nuk është as menstruacione, as hemorragji pas lindjes, as gjak i virgjërisë e as gjak plage, ai është metrarogji.

Në të shumtën e herëve, gjaku i metrarogjisë ka ngjyrë të verdhë, është i ftohtë e i hollë dhe ka cilësi të kundërta me cilësitë e gjakut të menstruacioneve, pasi gjaku i metrarogjisë del butë, pa vrull. Por gjaku me ngjyrë të verdhë mund të jetë edhe gjak menstrual, kur vjen në ditët e menstruacioneve. Gjithashtu, gjaku i metrarogjisë mund të ketë ngjyrë të zezë, kur vjen pas ose para menstruacioneve, ose kur vjen pas më shumë se dhjetë ditëve të menstruacioneve, ose kur menstruacionet vazhdojnë më pak se tri ditë.

Kategoritë e grave me metrarogji

Fukahatë e kanë ndarë gruan me metrarogji në tri kategori: e vogël, e mesme dhe e madhe. Këtë kategorizim e kanë ndërtuar mbi provën që bën gruaja me veten e saj, duke vënë tampon pambuku mbi vaginën e vet dhe pastaj shikon. Nëse gjaku del mbi

tamponin e pambuktë, por nuk e ka lagur të gjithë, ajo është e vogël. Nëse gjaku e ka lagur tamponin e pambuktë, por nuk pikon, ajo është e mesme dhe, nëse tamponi i lagur pikon, ajo është e madhe.

E vogla nuk ka detyrë të bëjë gusël, por ka detyrë ta ndërrojë tamponin e pambuktë dhe të marrë abdes për çdo namaz. Gjithashtu, ajo nuk mund të falë dy maze të bashkuara me një abdes. Kurse e mesmja ka detyrë të ndërrojë tamponin e pambuktë dhe të bëjë një herë gusël para namazit të mëngjesit dhe të marrë abdes për çdo namaz që do të falë. Gjithashtu, ajo nuk mund të falë dy namaze të bashkuara me një abdes të vetëm. E madhja bën tre herë gusël: guslin e parë e bën para faljes së namazit të mëngjesit, të dytin e bën për faljen e namazit të mesditës e të namazit të pasdites, të cilët ajo i fal të bashkuar njëri pas tjetrit dhe guslin e tretë e bën për faljen e namazit të mbrëmjes e të namazit të darkës, të cilët ajo i fal përsëri të bashkuar, njëri pas tjetrit, me kusht që të marrë abdes për çdo namaz, pasi të ketë ndërruar tamponin e pambuktë.

E mesmja dhe e madhja janë në gjendjen e papastërtisë së madhe dhe janë plotësisht si gruaja me menstruacione, domethënë ajo nuk kryen detyrimet që ne i përshkruam. Gjithashtu, ajo i ka të ndaluara (*haram*) të njëjtat gjëra që ka të ndaluara gruaja me menstruacione, siç janë: hyrja në xhami, shkrimi i Kur'anit, leximi i lutjeve, moslejimi i marrëdhënieve intime dhe nuk fal namaz, kurse për sa i përket agjërimit, kur ai vishet me dyshim për shkak të guslit, atëherë agjërimi është i prishur dhe gruaja ka detyrë ta agjërojë këtë ditë kaza. Por nëse agjërimi vishet me dyshim vetëm për shkak të abdesit, agjërimi është i vlefshëm, sepse abdesi nuk është kusht për vlefshmërinë e agjërimit.

Nëse gruaja bën ato që ne përshkruam, agjërimi, namazi dhe tavafi i saj janë të vlefshëm. Gjithashtu, është e lejuar (*hallall*) kryerja e marrëdhënieve intime me të dhe për të është e lejuar çdo gjë që është e lejuar për gruan në kohën e pastrimit.

Për sa i përket së voglës, ajo hyn në dispozitën e personit të ndotur me papastërtinë e vogël, siç është urinimi dhe dalja e gazrave, sepse, kur këto papastërti ndodhin, ato bëjnë farz vetëm marrjen e abdesit dhe nuk bëjnë farz bërjen e guslit. Mbështetur mbi këtë fakt, agjërimi i saj është i vlefshëm, gjithashtu, është hallall kryerja e marrëdhënieve intime me të, sepse këto dy të fundit nuk janë të kushtëzuara me marrjen abdes, kurse agjërimi i saj është i vlefshëm me marrjen abdes. Ashtu siç kemi thënë më sipër, kjo grua nuk mund të falë dy namaze të bashkuara me një abdes të vetëm.¹

Edhe gusli për shkak të metrarogjisë është plotësisht si gusli për shkak të menstruacioneve dhe për shkak të xhunubllëkut.

¹ Prej fjalës së Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!): “Kur gjaku nuk shpon tamponin e pambuktë”, bëhet e qartë se burri kryen marrëdhënie intime me të, me përjashtim të ditëve të menstruacioneve.” Nga fjalët e fukahave, të shprehura në librat e tyre, bëhet e qartë se kryerja e marrëdhënieve është veprim i neveritshëm (*mekruh*), por është hallall, kur ajo bën ato veprime që bën gruaja me metrarogji, sepse, derisa lejohet që ajo të falë namaz, lejohet edhe kryerja e marrëdhënieve intime me të. Kur ndalohet falja e namazit, ndalohet edhe kryerja e marrëdhënieve intime. Nga të gjitha këto, bëhet e qartë se nuk është hallall që me të voglën të kryhen marrëdhënie intime, derisa ajo të ndërrojë tamponin e pambuktë, të lajë vaginën dhe të marrë abdes. Padyshim që kështu realizohet veprimi më i mirë dhe është për rezervë.

Lehonat

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Lehonat lënë faljen e namazit gjatë ditëve të lehonisë, domethënë gjatë kohës që kanë hemorragji si të menstruacioneve. Pastaj ato bëjnë gusël dhe bëjnë veprimet që bën gruaja me metrarogji.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Lehonat, gjatë ditëve të lehonisë, nuk bëjnë ato punë që nuk bën edhe gruaja me menstruacione.”

Është pyetur babai i Imamit Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me lehonat dhe ai ka thënë: “Rri aq ditë sa i vazhdon hemorragjia.”

Janë të shumta transmetimet që shpjegojnë kuptimin e këtij transmetimi.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se, kur gruaja lind dhe nuk shikon gjak, me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë, ajo nuk ka kohë pritje, por nuk ka argument për të vërtetuar pastërtinë, kur ajo shikon gjak së bashku me lindjen, madje edhe kur dështon ose e nxjerr në formën e një copëze gjaku të ngjizur, prandaj ky gjak është hemorragji e lehonisë.

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se nuk ka kufi për ditët më të pakta të periudhës së lehonisë, sepse ligji i fesë nuk ka bërë një përcaktim të tillë, pasi kjo periudhë realizohet me pika. Por fukahatë kanë mendime të ndryshme për kohëzgjatjen e

lehonisë: Fjala më në zë e tyre është se kjo kohë është dhjetë ditë, plotësisht ashtu si është për menstruacionet. Bazuar në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) e në transmetime të shumta, kemi: “Ajo rri sa janë ditët e saj të hemorragjisë.”

Kur fëmija del me operacion, pra, jo nga vendi i zakonshëm, kjo grua nuk hyn në dispozitën e lehonave, por ajo kryen kohën e pritjes që kalojnë gratë e divorcuara (*id'detu t'talâk*).

Dispozita e lehonës dhe e gruas me menstruacione është e njëjtë në të gjitha veprimet që kemi përmendur, për shembull, ajo e ka rreptësisht (haram) të ndaluar të shkruajë Kur'an, të këndojë lutje, të qëndrojë në xhami, të kryejë marrëdhënie intime. Divorcimi i saj gjatë këtyre ditëve është i pavlefshëm, gjithashtu, është i pavlefshëm agjërimi dhe falja e namazit që ato bëjnë gjatë këtyre ditëve, por ato kryejnë agjërimin më vonë dhe nuk falin namazet e mbetura, etj.

Edhe gusli për shkak të lehonisë është plotësisht si gusli për shkak të menstruacioneve, të metrarogjisë dhe të xhunubllëkut.

* * *

I VDEKURI DHE PREKJA E TIJ

Kur njeriu vdes, të gjallët kanë detyra (*farze*) të shkallës “*kifajeh*”, që do të thotë, kur detyrat i kryejnë disa, ato konsiderohen të kryera prej të gjithëve, por, kur këto detyra nuk i kryejnë të gjithë, atëherë që të gjithë mbajnë përgjegjësi dhe të gjithë do të japin llogari. Këto detyra janë si vijon:

Vdekja

1- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur ndonjërit prej jush i vdes dikush prej pjesëtarëve të familjes, shtrijeni atë në drejtim të Kibles.” Në një transmetim tjetër ai ka thënë: “Shputat e këmbëve të tij të jenë në drejtim të Kibles.”

Të vdekurit i zhvishen rrobat dhe shtrihet në shpinë, kurse shputat e këmbëve shikojnë në drejtim të Kibles, në atë mënyrë sikur të ngrihet, ai të jetë në drejtim të Kibles me fytyrë dhe me pjesën e përparme të trupit të tij. Këtë veprim, shumica e dijetarëve e kanë konsideruar farz. Është *mustehab* që të vdekurit t’i mbyllen sytë, t’i lidhet fort mjekra, t’i shtrihen dy krahët e dy duart në të dyja anët e ijëve, t’i zbuten kyçet, t’i hiqen rrobat, të

vihet mbi një dërrasë ose mbi një krevat dhe të mbulohet më një rrobë.

Por veprimi më i pëlqyer, ndër të gjitha veprimet mustehab, që i bëhen të vdekurit, është shpejtimi i përgatitjes së tij, sepse nderimi i të vdekurit qëndron në shpejtimin e përgatitjes së tij dhe në mosvonimin e përgatitjes për varrim. Në një hadith thuhet: *“Nuk është dashuri nga ana e ndonjë burri prej jush, kur i vdes dikush prej njerëzve të tij natën dhe ai pret të zbardhë dita që ta varrosë, as për atë burrë që i vdes i afërmi ditën dhe ai pret natën që ta varrosë. Mos pritni për varrimin e të vdekurve tuaj as lindjen e diellit e as perëndimin e tij. Mëshira e Allahut qoftë për ju, shpejtoni t’i qetësoni ata sa më parë në varr.”*

Larja

2- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për fëmijën e dështuar, kur është plotësuar krijimi i tij, nëse është detyrë që ai të lahet, të varrosset e të qefinoset. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Po, të gjitha këto janë të detyrueshme (farz), kur është plotësuar krijimi i tij.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Të vdekurit i bëhen tri larje: një herë me ujë me sidr (bimë lotusi), një larje, duke i shtuar ujit kamfur, një larje tjetër me esencë dhe pastaj qefinoset.”*

Çdo njeri që ka thënë: **“Là ilàhe il’le-ll’làh Muham’medun resùlu-ll’làh”**, kur vdes, është farz të lahet, madje lahet edhe ai që ka mëkatuar sheshit, lahet edhe i linduri jashtë martese, si dhe fëmija i dështuar, kur ka plotësuar katër muaj, sepse çdo fëmijë i vdekur, i flakur në rrugë, në vendet e

Islamit, hyn në dispozitën e myslimanit. Natyrisht nuk lejohet larja e ekstremistit në punët e fesë, as e armikut të deklaruar e as renegatit.

Është farz që myslimani të lahet tri herë, herën e parë me ujë me pak sidr, herën e dytë me ujë me pak kamfur, përveç rastit kur i vdekuri ka veshur ihramin. Në këtë rast nuk i shtohet ujit kamfur, herën e tretë lahet vetëm me ujë, pa i shtuar ujit asgjë. Duhet të kihet kujdes që ujit të mos i shtohet shumë sidr ose kamfur, nga frika që uji të mos bëhet "ujë i shtuar", pasi me ujë të shtuar nuk arrihet të kryhet pastrimi.

Është farz që në të tria larjet të respektohet radha e sistemit të larjeve, ashtu siç është farz edhe radha e larjes së tri gjymtyrëve: fillohet me larjen e kokës së bashku me qafën, lahet dy herë ana e djathtë dhe lahet tri herë ana e majtë, plotësisht siç kryhet gusli për shkak të xhunubllëkut, të menstruacioneve, metraogjisë dhe hemorragjisë pas lindjes së fëmijës (*nifâs*). Gusli për të vdekurin qëndron në radhë të parë mbi të gjitha llojet e guslit, sepse për këtë gusël ka tekst dhe nuk ka tekst për llojet e tjera të guslit. Për këtë shkak, disa fukaha, ose shumica e tyre, i krahasojnë të gjitha llojet e guslit me guslin për të vdekurin. Është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me të vdekurin, ka thënë: *"Laje kokën e tij disa herë me ujë të ngrohtë, pastaj shtrihe në anën e djathtë dhe derdh ujë mbi gjysmën e kokës së tij deri te këmbët e tij, pastaj shtrihe në anën e majtë dhe bëj të njëjtin veprim."*

Patjetër që larja e të vdekurit bëhet me nijet për afrim te Allahu, sepse kjo larje është prej adhurimeve, me kusht që uji të jetë "ujë në përgjithësi", i pastër dhe i lejuar.

Në radhë të parë, zhduken papastërtitë prej trupit të të vdekurit dhe të mos ketë ndonjë mbulesë që pengon arritjen e ujit në lëkurën e tij. Është veprim i urryer (*kerahet*) larja e të vdekurit me ujë të nxehtë.

Burrat lajnë burrat dhe gratë lajnë gratë, bashkëshorti e bashkëshortja lajnë njëri-tjetrin. Edhe e divorcuara me kthim vazhdon të jetë në dispozitën e bashkëshortes, derisa është në kohën e pritjes (*id'det*).

Burri mund të lajë vajzën tre vjeçe, gjithashtu edhe gruaja mund të lajë djalin tre vjeç, por më mirë është që këto larje të bëhen vetëm në raste domosdoshmërie.

Të afërmit nga gjaku e nga qumështi (*el mehàrim* - ata që s'mund të marohen mes tyre), lajnë njëri-tjetrin, kur nuk gjenden të së njëjtës gjini, me kusht që larja të bëhet prapa rrobave.¹

Kur nuk gjenden as të së njëjtës gjini e as të afërm, atëherë larja e të vdekurit nuk është më detyrë, ashtu siç është transmetuar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Gruaja që vdes gjatë udhëtimit dhe nuk është e shoqëruar as me të afërm e as me gra, ajo varroset ashtu siç është, me rrobat e saj."

Kurse për rastet kur në udhëtim vdes burri dhe së bashku me të janë vetëm gra, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Ai varroset ashtu siç është, me rrobat e tij."

¹ Është pyetur Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) për një burrë që është në udhëtim së bashku me gruan e tij: "A e lan ai gruan e tij?" Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) i është përgjigjur: "Po, madje lan shërbyesën dhe motrën e tij, duke i hedhur një copë të trashë mbi organin e saj gjenital."

Shumica e fukahave kanë thënë se, kur vdes myslimani dhe së bashku me të nuk ka të ngjashëm, por gjendet një i ngjashëm prej ithtarëve të librit (kristianë, ose jehudi), në fillim ithtari i librit lan veten e pastaj lan të vdekurin mysliman. Për këtë thënie, fukahatë janë mbështetur në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë mysliman, kur bashkë me të nuk është asnjë burrë mysliman e as ndonjë grua myslimane prej të afërmeve të tij, por bashkë me të është një burrë kristian dhe gra myslimane që s'janë të afërme me të vdekurin. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *"Kristiani lahet vetë dhe pastaj lan myslimanin, sepse, në këtë rast, s'ka kush ta lajë këtë të vdekur, përveç këtij kristiani."*

Gjithashtu, edhe kur vdes një myslimane dhe bashkë me të s'ka gra të tjera myslimane e as ndonjë burrë mysliman prej të afërmeve të saj, por bashkë me të vdekurën, është një grua kristiane, kjo kristiane lahet vetë dhe pastaj lan të vdekurën myslimane.

Transmetimin e mësipërm, që urdhëron varrimin e të vdekurit pa e larë, fukahatë e kanë mbartur për rastin kur, në mënyrë absolute, nuk gjenden të ngjashëm, madje nuk gjenden të ngjashëm me të vdekurin as prej ithtarëve të librit.

Duhet të theksohet se transmetimi që flet për larjen e myslimanit prej kristianit ose prej jehuditit, tregon, me qartësinë më të madhe, për pastërtinë e ithtarëve të librit, tregon se ndyrësia e tyre është e rastësishme dhe jo identike. Është rastësi që domosdoshmëria nuk e bën ndyrësirën të pastër, por preferohet kalimi nga njëra gjendje në një gjendje tjetër, prandaj është detyrë e domosdoshme, e gradës së parë, që të vdekurin mysliman ta lajë

i ngjashmi mysliman, kur gjendet së bashku me të vdekurin. Kur nuk ka të ngjashëm mysliman, atëherë e lan i ngjashmi kristian ose jehudi, plotësisht në analogji me të afërmit e të vdekurit, për të cilët do të flitet më poshtë.

Dëshmori (esh shehijdu) dhe i ekzekutuari me gjuajtje me gur (el merxhùmu)

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Burri që vritet në rrugën e Allahut, varroset ashtu siç është, me veshjen e tij, përveç rastit kur ai është pjesëmarrës në këtë luftë, sepse ky njeri lahet, qefinoset dhe i falet namazi i xhenazes.”

Për të ekzekutuarin e për të ekzekutuarën me gjuajtje me gur (ekzekutimi për tradhti bashkëshortore), Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë: “Para ekzekutimit, ata lahen, parfumohen, vishen me qefin dhe pastaj ekzekutohen. Pas ekzekutimit, i falet edhe namazi i xhenazes.” Në këtë dispozitë hyn edhe i ekzekutuari me prerje koke (ekzekutimi për vrasësin), i cili varroset dhe i falet namazi i xhenazes.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Cilido që vritet në mbrojtje të Islamit, ai është dëshmor dhe dispozita e ligjit të fesë për dëshmorin është që ai të varroset me rrobat e veta të gjakosura, pasi i është falur namazi i xhenazes, me kusht që t’i ketë dalë shpirti në betejë ose jashtë betejës, kur beteja vazhdon dhe lufta

nuk ka përfunduar. Por nëse ai vdes pas përfundimit të betejës, atëherë është detyrë që ai të lahet.

Kur vrasja e një njeriu është bërë e detyrueshme me gjuajtje me gur (*rexhm*), ose me prerje koke (*kisàs*), paraprakisht, ai lahet siç lahen të vdekurit, parfumohet dhe i vishet qefini, pastaj ekzekutohet me gjuajtje me gur ose i pritët koka. Pas ekzekutimit, i falet namazi i xhenazes, pastaj varroset.

Qefini

3- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"I vdekuri qefinoset me tri copa, sepse edhe i Dërguari i Allahut është qefinosur me tri copa: dy copa saharije dhe një copë hubeh."* (Sipas emrave të vendit ku janë prodhuar në Jemen.)

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"I vdekuri qefinoset me tri copa, përveç çallmës dhe një rripi të gjerë që shtrëngon mesin e barkut të tij, me qëllim që të mos i zbulohet ndonjë pjesë e trupit. Çallma dhe rripi shtrëngues, duhet patjetër, por nuk janë pjesë të qefinit."*

Për sa i përket fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *"Çallma dhe rripi shtrëngues duhet patjetër."*, si dhe fjalës tjetër të tij: *"Por ato nuk janë pjesë të qefinit."* Këto dy thënie theksojnë se çallma dhe rripi shtrëngues janë *mustehab* t'i vihen të vdekurit.

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Është farz qefinosja e të vdekurit me tri copa, burrë ose grua qoftë: copa e parë (*mi'zereh*) mbulon prej kërthizës deri te gjunjët, por më mirë është të mbulojë prej gjoksit deri te këmbët. Copa e dytë është këmisha (*kamijs*), e cila mbulon pjesën prej supeve deri te kërcinjtë e këmbëve, por më mirë është që ajo të mbulojë deri te këmbët dhe copa e tretë (*izar*), mbulon të gjithë trupin.

Është *mustehab* (veprim i pëlqyer) që burrit t’i vihet në kokë çallma, dy anët e së cilës lëshohen deri në gjatësi të nofullave. Gjithashtu, është *mustehab* që mesi i burrit të shtrëngohet me rripin e gjerë lidhës, pa shtuar asgjë tjetër më shumë.

Kurse për gruan, është *mustehab* që në vend të çallmës, asaj t’i vihet një mbulesë në fytyrë, një lidhëse në mes dhe një lidhëse tjetër te kofshët.

Është kusht i domosdoshëm (*farz*) që qefini të mbulojë pjesët që mbulohen për faljen e namazit, gjithashtu, është kusht që qefini të jetë i pastër, i lejuar dhe jo i qëndisur me fije ari, madje as për gratë, të mos jetë punuar me lesh kafshësh që nuk u hahet mishi, ose me materiale të tjera, për të cilat, me lejen e Allahut, do të bëhet fjalë në kapitullin “Namazi”.

Edhe fëmija i dështuar (*es siktü*) hyn në dispozitën e të madhit, kur i dështuari ka mbushur katër muaj në barkun e nënës së tij, ndryshe pështillet me një copë dhe varroset.

Qefini i gruas është detyrë të paguhet prej burrit të saj, kurse qefini i grave të tjera blihet me pasurinë e lënë, duke i dhënë

përparësi blerjes së qefinit ndaj shlyerjes së borxhit dhe pjesëtimit të trashëgimisë.

Parfumimi (elhanùtu)

4- Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për parfumimin e të vdekurit dhe ai ka thënë: “*Parfumoni gjymtyrët me të cilat kryhet sexhdeja.*”

Fukahatë

Në librat e fik’hut, parfumimi është përmendur pas larjes, prandaj edhe ne ndoqëm rrugën e fukahave, megjithëse do të ishte më mirë që parfumimi të përmendej para larjes, sepse kështu është më lehtë e më thjeshtë. Në disa transmetime të ardhura prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) parfumimi është përmendur pas qefinosje. Ky është shembulli që duhet të ndiqet.

Duhet të theksohet se parfumimi i të vdekurit është farz, ashtu siç është farz edhe larja e tij. Parfumimi i të vdekurit realizohet duke i fërkuar me kamfur shtatë gjymtyrët me të cilat bën sexhden ai që fal namaz. Këto janë: balli, dy shputat e duarve, dy gjunjët dhe dy gishtat e mëdhenj të këmbëve. Gjithashtu, është mustehab të parfumohet edhe i dështuari, kur ka mbushur katër muaj.

Autori i librit “El Xhevàhir”, pasi citon fjalën e përbashkët të fukahave se parfumimi i të vdekurit është farz pas larjes së tij, citon edhe kundërshtimet që ata kanë mes tyre: Nëse parfumimi

duhet të bëhet para qefinosjes apo gjatë qefinosjes. Pas këtyre citimeve, tekstualisht, ai thotë: “Shpresoj se më e fortë është që të gjitha të jenë të lejuara për shkak të bazës, pasi shumica absolute është prej argumenteve, edhe pse është më mirë që parfumimi të bëhet para qefinosjes.”

Duhet të theksohet se nuk lejohet parfumimi i atij që ka veshur ihramin për të kryer Haxh, sepse vënia e erërave të mira për atë që është në ihram, është e ndaluar rreptësisht, qoftë parfumimi i tij me kamfur ose me lloje të tjera parfumeshe.

Namazi i xhenazes

5- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur falte namazin e xhenazes, thoshte tekbinin (Allahu Ekber), këndonte salavat dhe tesheh’hudin (“Là ilàhe il’le-llàh Muham’medun Resulu-ll’làh”, lutej për profetët, pastaj thoshte tekbinin dhe lutej duke kërkuar faljen e mëkateve për besimtarët e për besimtare. Pastaj thoshte tekbinin e katërt dhe lutej për të vdekurin. Thoshte tekbinin e pestë dhe mbaronte namazin. Por, kur Allahu i Gjithëpushtetshëm e ndaloi të falte namazin e xhenazes për munafikët dhe të lutej për ta, i Dërguari (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përfundonte namazin pas tekbitit të katërt dhe nuk lutej për të vdekurin.” Ky veprim i tij ishte në përputhje me urdhrin që i drejton Allahu i Lartësuar Profetit të Tij:

“وَلَا تُصَلِّ عَلَى أَحَدٍ مِّنْهُمْ مَّتَّ أَبَدًا وَلَا تُنْمِ عَلَى قَبْرِهِ...”^ط

“Dhe kurrë mos i fal namazin (e xhenazes) asnjërit prej tyre kur të vdesë dhe as mos qëndro pranë varrit të tij (për lutje e për vizitë)...”, (Sure “Et Teubeh” ajeti 84), domethënë mos u lut për të.

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“I Dërguari i Allahut, kur falte namaz xhenazeje, për disa thoshte pesë tekbire dhe për disa të tjerë thoshte katër tekbire. Kur ai thoshte katër tekbire, ky i vdekur akuzohej për hipokrizi (nifāk).”¹*

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Allahu ka bërë obligim faljen e pesë namazeve dhe prej çdo namazi ka bërë për të vdekurin një tekbir.”*

Midis të tjerave, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Fale namazin e xhenazes, nëse i vdekuri është prej atyre që u drejtohet Kibles, kur fal namaz, pastaj llogarinë e punëve ai do ta japë para Allahut.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se është farz falja e namazit të xhenazes për çdo mysliman, qoftë ai njeri i mirë ose njeri mëkatar, qoftë edhe kur ka vrrarë veten. Gjithashtu, është farz të falet namazi i xhenazes së dëshmorit, i cili as nuk lahet e as nuk qefinohet, ashtu siç ka thënë i Dërguari më i madh: *“Mos u lutni për ndonjërin prej umetit tim, pa i falur namazin e xhenazes.”*

¹ Ehli Suneti, me të katër medh’hebet e tyre, këndojnë për të vdekurin vetëm katër tekbire.

Shumica e fukahave kanë thënë se nuk është farz të falet namaz xhenazeje për të lindurin prej myslimanit, nëse nuk ka mbushur gjashtë vjeç.

Në lidhje me këtë çështje, ka edhe transmetime të tjera prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!). Mbështetur mbi këto transmetime, disa prej fukahave kanë thënë se namazi i xhenazes është farz të falet vetëm për atë që i është bërë farz falja e namazit.

Mënyra e faljes së namazit të xhenazes

I vdekuri vihet i shtrirë mbi shpinë, kurse ai që fal xhenazen, qëndron prapa të vdekurit jo larg tij, i kthyer në drejtim të Kibles. Koka e të vdekurit është në anën e djathtë të atij që fal namazin. Nuk duhet të ketë ndarës mes falësit të xhenazes dhe të vdekurit. Falësi qëndron më këmbë, përveç rastit kur ka ndonjë pengesë të justifikueshme në ligjin e fesë. Pastaj falësi i namazit të xhenazes bën nijetin dhe këndon pesë tekbire (thotë pesë herë “All’llàhu Ekber”), aq sa janë namazet farz të përditshme. Pas tekbirit të parë këndon dy dëshmitë: “Esh’hedu en là ilàhe il’le-ll’llàh ue esh’hedu en’ne Muham’meden abduhù ue resùluhù, pas tekbirit të dytë këndon slavatin për Profetin (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pas tekbirit të tretë këndohet lutja për besimtarët e për besimtare, pas tekbirit të katërt bëhet lutja (duaja) për të vdekurin. Në qoftë se i vdekuri nuk e ka arritur moshën e pjekurisë, lutja bëhet për të dy prindërit e tij. Pastaj këndon tekbirin e pestë dhe largohet.

Në namazin e xhenazes nuk është kusht pastrimi (abdesi), sepse ky namaz është thjesht një lutje për të vdekurin, që Allahu i

Lartësuar ta përfshijë në mëshirën e Tij, kur dihet se për lutjen nuk është kusht të merret abdes për shkak të jashtëqitjes. Për më tepër, ne nuk dimë të kenë ndonjë namaz pa ruku e pa sexhde.

Namazi i xhenazes falet me xhemat dhe vetëm nga një person, por imami në këtë namaz, në mënyrë absolute nuk mban ndonjë përgjegjësi të atyre që janë duke u falur prapa tij.

Është e njohur si domosdoshmëri e fesë që namazi i xhenazes të falet para varrimit. Nëse i vdekuri është varrosur para se të falet namazi i xhenazes, nuk lejohet hapja e varrit, me qëllim që të falet namazi i xhenazes. Në këtë rast, namazi i të vdekurit falet mbi varrin e tij.

Varrimi

6- Allahu i Lartësuar thotë:

“أَلَمْ يَجْعَلِ الْأَرْضَ كِفَاتًا. أَحْيَاءَ وَأَمْوَاتًا”

“A nuk e bëmë Ne tokën që në gjirin e vet mban, të gjallë e të vdekur?” (Sure “El Murselat”, ajetet 25-26)

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“... مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ”

“Prej asaj (tokës) Ne u kemi krijuar dhe në atë do t’ju kthejmë përsëri...” (Sure “Ta Ha”, ajeti 55). Imam Rizai, nipi i Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Në të vërtetë, Allahu ka urdhëruar varrimin e të vdekurit që njerëzit të mos shikojnë:

dekompozimin e trupit të tij, pamjen e shëmtuar, ndryshimin e erës së tij, që të gjallët të mos pështirosen prej erës së të vdekurit, përfshirë elementet e tjera të dekompozimit, që i vdekuri të jetë i mbuluar prej të dashurve e prej armiqve, që të vdekurin as të mos e shajë më armiku i tij e as të mos hidhërohet më shoku e miku i tij.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Thellësia e varrit bëhet nga fyti deri në mesin e trupit.”* Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në një transmetim tjetër, njofton se Profeti (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka ndaluar që varri të hapet më i thellë se tre krahë.

Imam Kadhim (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që e kanë ngrënë bishat ose shpendët dhe kockat e tij kanë mbetur pa mish. Si do të veprohet me këtë njeri? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Lahet dhe qefinuset, i falet namazi i xhenazes dhe varroset.”*

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kur i vdekuri është dy gjysma, falet namazi i xhenazes për gjysmën në të cilën është zemra.”*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se është farz që i vdekuri të varroset në tokë, në atë mënyrë që gropa të jetë pengesë që bishat të mos arrijnë kufomën dhe era e kufomës të mos arrijë te njerëzit. Nuk lejohet që i vdekuri të lihet mbi sipërfaqen e tokës dhe as të bëhen ndërtime mbi varr, qoftë edhe kur realizohen dy qëllimet: ruajtja e kufomës dhe mos përhapja e erës së saj. Është mustehab që varri

të bëhet i thellë një bojë burri, ose deri në fyt, gjithashtu, është mustehab që në varr të hapet xhepi anësor (*lahd*) ku futet i vdekuri.

Është farz të varrosen pjesët e shkëputura prej trupit të të vdekurit, deri dhëmbi, floku e thoi. Kurse pjesa e shkëputur prej të gjallit, ose prej të vdekurit, nëse është mish pa kockë, pështillet me një copë dhe varroset. Nëse copa e shkëputur ka kockë, por jo gjoksi, lahet, pështillet me një copë dhe varroset. Nëse pjesa e shkëputur është gjoksi, ose pjesa e gjoksit ku gjendet zemra, ajo lahet, qefinoset, i falet namazi i xhenazes dhe varroset.

Kur njeriu vdes në anije, i vdekuri mbështillet me një copë të trashë, mbështetet mirë në krye të mbështjellëses dhe lëshohet në ujë. Në lidhje me këtë çështje, ka një transmetim të gradës "Sahijh" prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Atij i lidhet një gur në këmbë dhe, së bashku me gurin, lëshohet në ujë." Autori i librit "El Medàrik" ka thënë se ndër transmetuesit e këtij njoftimi, ka edhe transmetues të gradës "Daijf" (jo qind për qind të besueshëm).

Kur njeriu vdes në pus dhe nuk ka mundësi të nxirret, pusi mbyllet dhe do të jetë varri i tij.

Është farz që i vdekuri në varr të vihet në brinjë, në anën e djathtë, me fytyrë drejt Kibles, koka nga perëndimi dhe këmbët nga lindja. Autori i librit "El Medàrik" ka thënë: "Si bazë për këtë merret veprimi i Profetit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe veprimi i Imamëve të pastër (*Paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi ta!*).

Gruan e fut në varr burri i saj, ose dikush prej të afërmve të saj, ose gratë. Në rast se nuk gjendet as burri, as të afërm dhe as gra, atëherë këtë grua e varrosin burra të mirë.

Nuk lejohet varrosja e të vdekurit në një vend të grabitur, as në vend vakuf, me përjashtim të varrezave. Gjithashtu, është haram ndërtimi i varrit me mur, përveçse kur dihet që i vdekuri do të bëhet pluhur, ose kur bërja e varrit me mure është për të mirën e të vdekurit, siç mund të jetë rasti kur varri është në një rrjedhë uji, ose është varrosur në një vend të grabitur dhe pronari i këtij vendi këmbëngul që varri të hiqet prej aty, ose është qefinosur me qefin të punuar me materiale me të cilat nuk lejohet qefinosja, ose kur është varrosur ka pasur para e sende me vlerë, qofshin këto para e sende të trashëgimtarëve të tij, ose të ndonjë tjetri.

Të afërmit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Të vdekurin e lan më i afërmi i tij.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Prin për Imam, në faljen e namazit të xhenazes, më i afërmi i të vdekurit, ose ai urdhëron atë që ai dëshiron.”*

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Burri meriton më shumë se kushdo tjetër të falë namazin e xhenazes së gruas së tij, derisa ta vërë atë në varr.”*

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Burri meriton më shumë se babai e fëmija?”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Larja dhe falja e namazit të xhenazes patjetër duhet të bëhet me lejen e njeriut më të afërt të të vdekurit. Nëse ai lahet, ose qefinoset pa lejen e më të afërmit, e gjithë puna ka shkuar kot.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ç’kuptim ka leja e të afërmit, kur dihet se obligimet e ligjit të fesë, nuk varen nga vullneti i asnjërit?”

Përgjigje:

Patjetër, por këtu leja e të afërmit nuk është kusht për bërjen farz të larjes dhe faljen e namazit të xhenazes, por është vetëm që veprimet të jenë të rregullta dhe të kryhen sipas kërkesave, ashtu siç është farz abdesi për faljen e namazit. Nëse personi i obliguar nuk është me abdes, ai menjëherë merr abdes në kohën e kryerjes së adhurimit, në përputhje të plotë me rregullin e ligjit të fesë.

Të afërmit e të vdekurit kanë përparësi ndaj njëri-tjetrit sipas renditjes së mëposhtme:

1- Burri i së vdekurës ka përparësi ndaj babait dhe djalit të saj.

2- Babai i të vdekurit ka përparësi ndaj nënës dhe djalit të tij.

3- Kur nuk është babai, nëna ka përparësi ndaj fëmijëve meshkuj të të vdekurit.

4- Meshkujt kanë përparësi ndaj femrave, sipas shkallës së afërsisë. Gjithashtu, ai që ka arritur moshën, kur obligohet me urdhrat e fesë, ka përparësi ndaj atij që nuk e ka arritur këtë moshë.

5- Vajzat e të vdekurit kanë përparësi ndaj djemve të djemve, gjyshërve dhe vëllezërve të tij.

6- Djemtë e djemve të të vdekurit kanë përparësi ndaj gjyshit të tij.

7- Gjyshi i të vdekurit ka përparësi ndaj vëllait të tij.

8- Vëllai i të vdekurit ka përparësi ndaj motrës së tij.

9- Motra e të vdekurit ka përparësi ndaj djemve të vëllait.

10- Xhaja i të vdekurit ka përparësi ndaj dajës.

11- Daja i të vdekurit ka përparësi ndaj sundimtarit ligjor.

12- Sundimtari ka përparësi ndaj myslimanëve të tjerë.

Prania e foshnjës, të çmendurit dhe atij që nuk është prezent, hyn në dispozitën e mospranisë; kur nëna e babai thonë së bashku për të vdekurin se është fëmija ynë, kanë më shumë përparësi se sa kur këtë pohim e bën njëri prej dy prindërve. Gjithashtu, ka më përparësi, kur pohimin për të vdekurin e bën

babai, në krahasim me pohimin e nënës. Në rast se të afërmit, sipas renditjes të së njëjtës shkallë, janë disa, si fëmijë, motra, xhaxhallarë e dajallarë, afërsia e tyre ndaj të vdekurit është e përbashkët për të gjithë në mënyrë të barabartë, sepse raporti i argumentit për të gjithë është një dhe pa asnjë diferencim. Praktika e njohur për të marrë leje prej djalit më të madh, në ligjin e fesë, nuk ka asnjë argument.

Kur i vdekuri i le porosi një burri, që ai ta përgatisë, kur të vdesë, përsëri leja e të afërmit nuk rrëzohet dhe, kur nuk ka asnjë pengesë prej të gjithëve, atëherë i afërmi e lejon dhe i porositiuri e përgatit të vdekurin. Me këtë mënyrë ne bashkojmë urdhrin e ligjit të fesë dhe dëshirën e të vdekurit.

Prekja e të vdekurit

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “A e ka farz të bëjë gusël ai që ka prekur të vdekurin?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse e ka prekur, kur ishte i ngrohtë, s’ka asnjë problem, por ai e ka farz të bëjë gusël, nëse e ka prekur të vdekurin, pasi ai ishte ftohur.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “S’ka asnjë problem, nëse i vdekuri preket ose puthet, pasi është larë.”

Përsëri Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur prej këmbës pritet një pjesë dhe ajo është e vdekur, nëse këtë copë këmbë të prerë e prek një njeri, në qoftë se copa e prerë ka kockë, kushdo që e prek, ka detyrë të bëjë gusël, sepse çdo pjesë e trupit të njeriut me kockë, e bën farz guslin për atë që e prek. Por nëse kjo copë e prerë nuk ka kockë, atëherë ai që e prek, nuk e ka farz të bëjë gusël.”

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se kush prek një të vdekur, pasi i është ftohur trupi dhe para se të lahet, ai ka detyrë të bëjë gusël për shkak të prekjes së të vdekurit.

Kur njeriu e prek të vdekurin, menjëherë pas vdekjes dhe para se trupi i tij të ftohet, ai nuk ka asnjë detyrim të bëjë gusël, gjithashtu, ai nuk ka detyrë të bëjë gusël, kur e prek të vdekurin, pasi ai është larë sipas rregullit të ligjit të fesë.

Nuk ka asnjë dallim, nëse i vdekuri është mysliman ose jomysliman, është i rritur apo i vogël, madje edhe fëmija i dështuar. Kur dikush prek një copë të shkëputur prej trupit të njeriut të gjallë ose të vdekur dhe në atë copë ka kockë, ai e ka farz të bëjë gusël për shkak të prekjes, por nëse copa nuk ka kockë, ai s'ka asnjë detyrim.

Mënyra e larjes së të vdekurit është plotësisht si mënyra e larjes për shkak të xhunublëkut, menstruacioneve, metrarogjisë dhe hemorragjisë pas lindjes.

* * *

GUSLET E PËLQYESHME (mustehab)

Guslet *mustehab* janë të shumta, madje disa fukaha, bazuar në argumentet e Sunetit, e kanë çuar numrin e këtyre gusleve deri në njëqind gusle. Thënia më e përhapur, në mesin e fukahave, është se numri i gusleve *mustehab* është tridhjetë e tetë. Të njëjtin mendim ka edhe autori i librit “Esh Sher’au”.

Nga këto gusle kemi: gusli për ditën e Xhuma. Koha e bërjes së këtij gusli është prej lindjes së diellit, derisa dielli të fillojë prirjen kah perëndimi. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Gusli për ditën e Xhuma është detyrim për burrat e për gratë që janë banorë të përhershëm në një vend të caktuar, si dhe për burrat kur janë në udhëtim, kurse gratë, kur janë në udhëtim, nuk bëjnë gusël *mustehab* për ditën e Xhuma.”

Pastaj Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdoi: “Çdo njëri prej jush le të zbukurohet ditën e Xhuma, të bëjë gusël e të parfumohet.”

Gjithashtu, nga këto gusle kemi: gusli për natën e parë të Muajit të bekuar të Ramazanit, gusli për natën e mesit të Ramazanit dhe natën 17, 19, 21 të Ramazanit, gusli për darkën e Bajramit të Ramazanit (*lejletul fitri*), gusli për dy ditët e Bajrameve,

gusli për Ditën e Arafatit, gusli për natën e gjysmës së muajit Rexheb dhe gusli për natën e 7 e të 20 të këtij muaji, gusli për natën e gjysmës së muajit Shaban dhe gusli për ditën e “Mubahales”, që i korrespondon dita e 24 e muajit Dhul Hixh`xheh.

Gjithashtu, nga guslet *mustehab* kemi: gusli kur vishet ihrami, gusli për vizitën te i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe te pjesëtarët e pastër të familjes së tij të uruar, gusli me rastin e bërjes teubeh, gusli për hyrjen në Qabe, si dhe shumë gusle të tjera.

Për të gjitha këto gusle, ka transmetime të shumta prej Ehli Bejtit (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!). Më sipër kemi thënë se, kur ndodh që të bashkohen disa gusle, mjafton të bëhet vetëm një gusël. Mënyra e bërjes së guslit *mustehab* është plotësisht e njëjtë me mënyrën e bërjes së guslit prej xhunubllëkut, krahas kushteve të njohura që uji të jetë i pastër, të jetë ujë në përgjithësi dhe ujë i lejuar.

Një grup prej fukahave të shi`ave kanë thënë se gushi, në vetvete, është veprim *mustehab*, pa pasur bërësi i guslit (elmugtesilu), ndonjërin prej qëllimeve që u përmendën. Për këtë mendim ata janë mbështetur te fjala e Allahut: “وَجِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ” - “...**Ai i do ata të pastruarit.**” (Sure “El Bekare, ajeti 222), si dhe te fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse ke mundësi të jesh i pastër në çdo ditë e në çdo natë, bëje.”

* * *

TEJEMUMI

Allahu i Lartësuar thotë:

”وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِّنَ الْعَائِطِ أَوْ لَامَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا“

“...nëse jeni sëmurë, ose në udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen nga vendi i kryerjes së nevojave, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë bëni tejemum me tokë të pastër...” (Sure “En Nisa, ajeti 43)

Gjithashtu, i Dërguari më i madh (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Për mua, toka është krijuar vend sexhdeje dhe e pastër.”

Edhe Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur udhëtari nuk gjen ujë, derisa vazhdon të jetë brenda kohës së faljes së namazit, le të kërkojë ujë dhe, nëse ka frikë se po i kalon koha e faljes së namazit, atëherë le të bëjë tejemum dhe të falë namazin.”

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që nuk ka ujë me vete, por uji gjendet në të djathtë ose në të majtë të rrugës në largësinë e dy gjuajtjeve me shigjetë, ose afërsisht kaq.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk e urdhëroj atë burrë të veprojë me mendjen e vet, sepse ka mundësi t’i dalë përpara ndonjë kusar ose ndonjë bishë.”

Gjithashtu, është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që kalon pranë një pusi, por s’ka kovë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai nuk e ka detyrë të hyjë brenda në pus, sepse ajo që duket si ujë, mund të jetë tokë, prandaj ai le të bëjë tejemum... sepse Allahu i Lartësuar tokën e ka bërë të pastër, ashtu siç ka bërë të pastër edhe ujin.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka çibanë e plagë dhe bëhet xhunub. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem që ai të bëjë tejemum dhe të mos bëjë gusël.” Transmetimet e kësaj kategorie janë të shumta.

Fukahatë

Fukahatë e kanë ndarë pastrimin në dy pjesë: pastrim me preferencë dhe pastrim për shkak të emergjencës. Pastrimi më i mirë, është pastrimi me ujë, kurse pastrimi i dytë është pastrimi me tokë, i cili tregon se këtë lloj pastrimi e paraprijnë shkaqe logjike dhe shkaqe të ligjit të fesë, që e bëjnë të detyrueshëm tejemumin. Këto shkaqe janë si vijon:

Mungesa e ujit

1- Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, është mungesa e ujit në sasi të mjaftueshme për të marrë abdes ose për të bërë gusël, qoftë në udhëtim, qoftë në vendbanim.

2- Shtrohet pyetja: Kur pranë ndonjërit nuk gjendet ujë, por ai nuk e përjashton mundësinë e gjetjes së ujit, nëse do të kërkojë, ose do të pyesë, a është detyrë për këtë njeri të kërkojë e të pyesë? Nëse ai bën tejemum për shkak të mungesës së ujit, a i prishet puna që ai ka bërë?

Përgjigje:

Patjetër që ai ka detyrë të kërkojë e te pyesë, në qoftë se ka kohë, sepse mungesa e ujit është kusht për vlefshmërinë e tejemumit dhe ai është i detyruar të presë arritjen e kushteve dhe të ketë dituri për to. Por kjo dituri nuk arrihet ndryshe veçse me anë të kërkimit dhe të vështrimit të imët, që natyrisht sjell edhe humbjen e shpresës. Sipas shprehjes së fukahave, humbja e shpresës për gjetjen e ujit, sjell dyshimin edhe për ligjshmërinë e tejemumit. Por ky dyshim, nga pikëpamja e logjikës, nuk mund të përjashtohet. Kjo gjë miratohet edhe me fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur udhëtari nuk gjen ujë, ai le të kërkojë, derisa të jetë brenda kohës për faljen e namazit.”

Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se udhëtari ka detyrë të kërkojë ujë deri në largësinë e një gjuajtje shigjete. Kur toka është e ashpër, ai ka detyrë të kërkojë deri në largësinë e dy gjuajtje të shigjetës, kur kërkimi nuk paraqit vështirësi, me kusht që kërkimi

të realizohet në të katër anët: djathtas, majtas, përpara dhe prapa, pa humbur shpresën për gjetjen e ujit, krahas sigurisë për jetën e vet dhe për mallin që ka me vete. Për këtë dispozitë, fukahatë janë bazuar në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): *“Ai kërkon ujë në udhëtim, nëse toka është e ashpër deri në largësinë e një gjuajtjeje shigjete dhe, nëse toka është e sheshtë, udhëtari kërkon ujë deri në largësinë e dy gjuajtjeve shigjete.”*

S’ka dyshim që këto dispozita janë vënë kur udhëtimi kryhej me këmbë, kurse në ditët tona, kur disponojmë makina dhe aeroplanë, kur s’ka as egërsira, është e kuptueshme që kjo temë nuk ka më bazë.

Gjithsesi, ne kemi detyrë të dimë fjalën e fukahave. Nisur nga kjo, del detyrë studimi e kërkimi i hollësishëm, si një rregull i përgjithshëm, i zbatueshëm në jetën e përditshme dhe që konsiston: Çdo detyrë që mbetet detyrim mbi njeriun, pasi ajo i është bërë atij obligim, është detyrë. Gjithashtu, për njeriun kurrë e asnjëherë nuk ka justifikim para Allahut, logjikës dhe njerëzve, që ai të neglizhojë një urdhër për të cilin ai e di mirë se neglizhimi i këtij urdhri patjetër çon në neglizhimin e një obligimi dhe lënien e tij.¹

Prej këtij rregulli për ne bëhet e qartë se ai që ka pak ujë, aq sa i mjafton për të marrë abdes, ose për të bërë gusël për shkak të

¹ Një grup fukahash prej këtij rregulli kanë dalë me një rregull të vetëm: Njeriu ka të drejtë të bëhet xhunub me dëshirën e tij, edhe kur e di se ai nuk do të gjejë ujë, pasi për këtë lejm të veçantë ka tekst. Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Ebu Dherrri ka thënë: “Njoftova të Dërguarin e Allahut se kam marrë fund, pa pasur ujë dhe Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: ‘O Ebu Dherr, ty të mjafton toka e pastër, edhe për dhjetë vjet.’”* Kuptohet se fjala e Ebu Dherrit, *“Kam marrë fund...”*, le të kuptohet se ai ka kryer marrëdhënie me gjuan dhe është i dëshpëruar nga mungesa e ujit.

xhunubllëkut, ai e ka të detyrueshme që këtë ujë ta ruajë për abdes që të falë namazin. Këtij njeriu nuk i lejohet ta përdorë këtë ujë për punë që nuk janë domosdoshmëri, edhe pse nuk ka hyrë koha për faljen e namazit, kur ai e di se nuk do të gjejë ujë kur të hyjë koha për faljen e namazit.

Në lidhje me fjalën se ruajtja e ujit është veprim paraprak dhe mjet për të falur namazin, kjo supozon se kjo ruajtje nuk është obligim para kohës së faljes së namazit dhe, kur nuk është obligim qëllimi, si mund të jetë obligim mjeti? Vallë, a mund të dalë degëzimi mbi bazën dhe vartësi mbi drejtuesin? Në fakt kjo është një lojë fjalësh, kur dihet padyshim se koha për faljen e namazit do të vijë.

Dihet se namazi nuk lejohet me tejemum, kur është mundësia të merret abdes. Për më tepër, ky burrë, logjikisht e zakonisht, ka mundësi e fuqi të marrë abdes. Bazuar mbi këto që u thanë, është obligim udhëtimi për të shkuar në Haxh dhe për adhurime të tjera përveç Haxhit, para se të vijë koha e Haxhit.

Gjithashtu, është obligim të mësohet para se të vijë koha për kryerjen e adhurimit, ose të bëhet gusël për agjërimin e Ramazanit para agimit, si dhe për obligime të tjera.

Dëmtimi

2- Nëse njeriu i shëndetshëm dëmtohet nga përdorimi i ujit, mjafton vetëm mendimi se dëmtohet, qoftë kur dëmtimi atij i vjen në mënyrë spontane, qoftë prej fjalës së mjekut, kur mjeku i thotë se përdorimi i ujit e dëmton, megjithëse ai e di se uji nuk e

dëmton. Veç kësaj, mjeku mund të gabojë në diagnostikimin e tij, atëherë ai vepron sipas praktikës së tij dhe jo sipas fjalës së mjekut. Në qoftë se ai nuk ka dijani as për dëmtimin e as për mosdëmtimin, por ai mëson për dëmtimin, ose e merr me mend, atëherë vepron sipas fjalës së mjekut, ose thënë më saktë, vepron sipas diturisë që ka, ose sipas mendimit të mjekut. Në rast se te ai nuk lind asgjë nga këto që u thanë dhe ai qëndron në dyshimin e në ngurrimin e tij, atëherë vepron sipas fjalës së mjekut, bazuar në sentencën: Njoftimi obligues është argument në subjektet, ndryshe atij nuk i lejohet të bazohet mbi këtë argument.

Sikur të supozohet se nga ana shëndetësore ai nuk do të dëmtohet prej përdorimit të ujit, por ai ndien dhembje prej të ftohtit të madh dhe për këtë shkak ai pëson vështirësi mbi ato të zakonshmet gjatë bërjes gusël ose gjatë marrjes abdes, por ai ka vendosmërinë se, kur këto vështirësi të marrin fund, ai do të rikthehet në natyrshmërinë e vet, por pa hequr dorë nga kujdesi për shëndetin e tij, në të drejtën e këtij njeriu, a duhet ta bëjë pastrimin me ujë, apo për atë lejohet edhe pastrimi me tokë, apo ai është i lirë të zgjedhë njërin prej dy llojeve të pastrimit?

Përgjigje:

Ai është i lirë të zgjedhë mes pastrimit me ujë dhe pastrimit me tokë. Nëse ai dëshiron, bën gusël, ose merr abdes dhe përsëri, nëse dëshiron, ai bën tejemum. Me të dyja llojet e pastrimit, adhurimi i tij është i vlefshëm. Për sa i përket rastit, kur përdorimi i ujit sjell dëmtimin e shëndetit, adhurimi i tij është i prishur. Dallimi kur dëmtimi është i ndaluar, gjendet në fjalën e Allahut:

“وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ”

“...dhe mos e hidhni veten në rrezik...” (Sure “El Bekare”, ajeti 195)

Ndalimi për kryerjen e adhurimit tregon prishjen e adhurimit, kurse përballimi me dhimbje, vështirësi e plagë, në mënyrë absolute, nuk është i ndalur për kryerjen e adhurimit. Prandaj nëse ai bën pastrimin me ujë dhe fal namaz, atëherë janë të vlefshme pastrimi që bëri dhe namazi që ai fali. Nisur nga kjo e vërtetë, thuhet: Mohimi i plagës, në ligjin e fesë, është për shkak lejimi, kurse mohimi i dëmtimit është për shkak të vendosmërisë.

Shtrohet pyetja: Pastrimi me ujë, krahas plagës dhe mundimit, nuk është i ndaluar, por as nuk urdhërohet, megjithëse edhe me mos urdhërimin, pastrimi me ujë, në këtë gjendje, në asnjë rast nuk është i vlefshëm, sepse vlefshmëria e pastrimit konsiston në bërjen e tij, pa qenë nevoja e përvetësimit të urdhrit. Ajo që supozohet është mos urdhërimi. Përfundimisht, kur gusli e abdesi me plagë sjellin mundim, është plotësisht si gusli e abdesi kur sjellin dëmtimin e shëndetit.

Përgjigje:

Pastrimi, në vetvete, si adhurim, ka përparësi, kurse me natyrën e tij ky adhurim është i dashur dhe i dëshiruar për Ligjvënësin (Allahun). Gjithashtu, pastrimi është mjet i mjaftueshëm për afrimin te Allahu, prandaj ky adhurim nuk duhet të ndalohet. Në fakt, nuk ka urdhër për ndalimin e këtij adhurimi, sepse as Ligjvënësi nuk e ka ndaluar pastrimin, kur

njeriu ka plagë dhe ndien mundim. Në të tilla raste, Ai e ka hequr urdhrin e obligimit. Kjo është bërë me qëllim lehtësimi, mirësie e mëshire nga ana e Allahut të Lartësuar. Kur njeriu zgjedh për veten e tij të vështirën e dhimbjen dhe, kur ai e angazhon veten me gjendjen e rënduar, ai është në këtë gjendje, madje numërohet njeri i bindur dhe i udhëzuar, por, kur krahas zgjedhjes së tij qëndron dëmtimi, ai është i detyruar dhe nxitet ta lërë vetë zgjedhjen, sepse, në një gjendje të tillë, në mënyrë absolute, nuk ka më vend për vetëzgjedhje, sepse dëmtimi, në vetvete, është veprim kategorikisht i ndaluar dhe nga natyra e tij, dëmtimi është i urryer e i papëlqyeshëm për Ligjvënësin, qoftë kur është i veshur me rrobën e adhurimit, qoftë me atë të kundërshtimit.

Ka pak ujë

3- Prej justifikuesve që lejojnë tejemumin është rasti kur njeriu ka me vete pak ujë që i nevojitet për nevojat e çastit, ose në një të ardhme të afërt, ose për një qëllim shumë më të rëndësishëm se marrja abdes dhe bërja gusël, pasi në atë ujë do të pijë vetë, ose një tjetër, ose kafsha, apo dikush tjetër që mund të ketë nevojë të ngutshme për ujë, mbase nevoja e ngutshme shkon deri aty sa të shkaktohet dëmtimi e të lindin ngatërresa për një pikë ujë. Në këtë rast, ai ka shpërblim. Prandaj në përdorimin e këtij uji për t'u pirë ka mirësi dhe dobi, sepse sprapset dëmtimi dhe e keqja.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një udhëtar që ka ujë me vete, por ka frikë se uji do t'i mbarohet, ngaqë ka pak ujë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është

përgjigjur: “Ai bën tejemum me tokë të pastër dhe nuk përdor ujin për pastrim.”

Kur ai e ruan ujin nga frika e etjes dhe bën tejemum, tejemumi dhe namazi që ai fal me këtë tejemum janë të vlefshëm, sepse vetë urdhri për tejemum tregon ndalimin për të marrë abdes ose për të bërë gusël, në raste domosdoshmërie, pasi supozohet që ai të mos dëmtohet dhe as të mos sëmuret nga përdorimi i ujit, kurse ai, në të vërtetë, ka frikë vetëm etjen. Mirëpo frika prej etjes është një gjë dhe dëmtimi i shëndetit prej përdorimit të ujit është një gjë tjetër, prandaj mbi atë njeri, marrja abdes e bërja gusël mbetet detyrë krahas frikës që ai ka prej etjes. Kjo çështje është plotësisht si çështja e atij që fal namaz, kur duhet të shpëtojë dikë që është duke u mbytur në ujë. Megjithëkëtë, namazi që ai fali, është i vlefshëm. Por ky falës namazi, në këtë rast, është mëkatar dhe do të dënohet për shkak të lënies së një veprimi shumë më të rëndësishëm.

Koha e paktë

4- Kohë e mjaftueshme për të marrë abdes dhe për të falur namazin, do të thotë, kur merr abdes. Koha është e mjaftueshme është të arrish të plotë faljen e namazit në kohën e caktuar. Nëse supozojmë se, kur ai merr abdes, i gjithë namazi ose edhe njëri rekat i namazit del jashtë kohës, por, nëse ai do të bëjë tejemum, i gjithë namazi kryhet brenda kohës së tij, atëherë është detyrë të bëhet tejemum. Nëse ai merr abdes, atëherë puna e tij është e prishur, prandaj ai ka detyrë të falë këtë namaz kaza (namaz i falur jashtë kohës së caktuar). Vlen të theksohet se, në pikëpamjen

e ligjit të fesë, rëndësia e kujdesit për faljen e namazit në kohën e caktuar, është shumë më e rëndësishme se kujdesi për të bërë pastrimin me ujë. Pa dyshim se me rëndësishmja e rrëzon të rëndësishmen dhe kryerja e adhurimit brenda kohës së caktuar, kalon me kalimin e kohës së caktuar për atë adhurim. Nga ky konkluzion dalin çështjet që vijojnë:

E para: Abdesi i tij, me qëllim faljen e këtij namazi, nuk është i vlefshëm, sepse në rastin e kalimit të kohës për faljen e namazit, është detyrë e domosdoshme që pastrimi për faljen e namazi të bëhet me tejemum dhe jo me abdes. Nëse ai ka ndonjë qëllim tjetër dhe, nëse është me pastrim, abdesi i dytë që merr, është i vlefshëm, sepse abdesi ka rëndësinë e vet, sepse urdhri për një gjë, nuk nënkupton ndalimin për të kundërtën. Në këtë rast, gjendja e abdesit të këtij njeriu është plotësisht si gjendja e namazit të falur para heqjes së papastërtisë prej xhamisë.

E dyta: Kur njeriu bën gusël, ose merr abdes, duke mos e ditur se koha nuk është e mjaftueshme, që ai krahas abdesit e guslit të arrijë edhe faljen e namazit brenda kohës, por më pas për atë bëhet e qartë se koha është e pamjaftueshme, pastrimi i tij është i vlefshëm vetëm nëse ka qëllim tjetër përveç faljes së namazit, pasi qëllimi i tij për faljen e namazit është prishur.

E treta: Tejemumi, për shkak të kohës së pamjaftueshme për të përdorur ujin, ka vlerë vetëm për të falur namazin e radhës, kurse për faljen e namazeve të tjera, si dhe për qëllime të tjera, nuk është më i vlefshëm, sepse në këtë rast ai gjen ujë në raport me namazin e mëparshëm.

Materialet me cilat tejemumi është i vlefshëm

Është pyetur Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që ka hyrë në pyll, por aty nuk ka ujë, por ka vetëm baltë. Ç'të bëjë ky njeri? Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: *"Ai bën tejemum, sepse edhe balta është tokë e pastër."*

Pyetësi tha: *"Ai ka hipur mbi kalë, është pa abdes dhe nga frika nuk zbret dot."* Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) është përgjigjur: *"Nëse ai ka frikë për veten e tij nga bishat ose nga ndonjë gjë tjetër, le të bëjë tejemum, të mbështesë dy duart e veta mbi mbulesën e shalës, ose mbi shalën, të bëjë tejemum dhe të falë namazin."*

Më pas Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tha: *"Nëse gjendesh në një gjendje të tillë, kur nuk ke mundësi të bësh tejemum me gjë tjetër, përveçse me baltë, atëherë bëje tejemumin me baltë, sepse Allahu meriton më shumë se kushdo t'i kërkohet ndjesë. Gjithashtu, kur me vete s'ke ndonjë rrobë të thatë, ose mbulesë shale që ke mundësi ta shkundësh, bëje tejemumin me atë."*

Gjithashtu, Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Kur toka është e lagur dhe në të nuk ka pluhur e as ujë, vështro të gjesh vendin që është më i thatë dhe aty bëj tejemum."*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë se është farz që tejemumi të bëhet me tokë të pastër, ashtu siç është fjala e Allahut: *"فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا"* - **"...bëni tejemum me tokë të pastër."** (Sure "En Nisa", ajeti 43) Fjala *"saijden"* e ajetit të nderuar, do të thotë *"sipërfaqja e tokës"*, qoftë dheu, qoftë rërë, qoftë gur, me kusht që të jetë e lejuar dhe jo

e grabitur dhe të jetë e pastër nga ndyrësitë, sepse tejemumi nuk është i vlefshëm as me pjesë metalike, as me pemët e as me hi.

Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se, kur burri s'ka mundësi të bëjë tejemum me ato që janë mbi sipërfaqen e tokës, nëse ka mundësi, le të mbledhë pluhur prej teshave dhe prej sendeve të tjera dhe le të bëjë tejemum me pluhurin e mbledhur, ose le të bëjë tejemum me pluhurin e rrobave, ose me jelet e kafshës e të ngjashme me këto që u thanë. Por nëse kjo është e pamundur për atë njeri, atëherë ai le të bëjë tejemum me baltë, sepse për atë s'ka mundësi tjetër, përveçse të bëjë tejemum me baltë.

Shtrohet pyetja: Kur njeriu burgoset, ose gjendet në një vend pa ujë dhe ku s'ka asnjë send që ai të bëjë tejemum, madje s'ka as baltë dhe është vërtetuar se ai i ka humbur të dy pastrimet, si do të veprojë ky njeri? A të falë namaz pa abdes e pa tejemum, ose për këtë njeri nuk është më farz që ai të falë namaz? Por, kur për këtë nuk qenka farz falja e namazit në kohën e vet, a është farz që ai të falë namazin kaza?

Përgjigje:

Shumica e fukahave janë të mendimit se për namazin që nuk mund të falet në kohën e vet, është farz që ai namaz të falet kaza. Argumenti për pamundësinë e faljes së namazit në kohën e vet është hadithi i mirënjohur: "S'ka namaz pa pastrim." Në lidhje me detyrimin për të falur namazin në kohën e vet, autori i librit

“El Medàrik” citon thënien e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*):
 “Kur të kujtohet namazi që të ka mbetur pa falur, fale menjëherë atë.”¹

Më pas, autori i librit “El Medàrik” shprehet: “Për sa i përket asaj që thuhet se rrëzimi i detyrimit për të falur namaz, e bën të detyrueshme edhe rrëzimin e detyrës për ta falur kaza namazin e prapambetur, është një pretendim i zhveshur nga të gjitha argumentet, kur dihet detyrimi për faljen e namazit kaza për atë që harron të falë namazin në kohën e vet, ose për atë që nuk e ka falur namazin për shkak se e ka zënë gjumi, është si detyrimi për gruan me menstruacione, që të kryejë agjërim kaza për ditët e Ramazanit që s’ka agjëruar.

Mënyra e bërjes tejemum

Në ajetin e nderuar 43 të sure “En Nisa” thuhet:

“...فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفُورًا عَفُورًا”

“...bëni tejemum me tokë të pastër, duke fërkuar (duke i dhënë mes’h) fytyrave e duarve tuaja; Allahu është shlyerës e falës mëkatesh.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Am’mari u bë xhunub dhe po zhgërryhej për tokë siç zhgërryhen kafshët. I

¹ Mund të thuhet: Kjo thënie vërteton faktin se atij që i mbetet pa falur një namaz farz, ai ka detyrë të falë namazin e mbetur. Por kjo fjalë, në asnjë rast, nuk përfshin personin, i cili, si rregull bazë, nuk e ka farz të falë namazin, ashtu siç po diskutojmë tani, por ai ka detyrë të kërkojë argumente jo në temën përkatëse.

Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “Po zhgërryesh për tokë siç zhgërryhen kafshët?”

Ata që e dëgjuan Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*), thanë: “Si bëhet tejemumi?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u tregoi se si merrej tejemumi: *Me dy duart e tij i ra tokës, pastaj i ngriti ato nga toka, i shkundi pak dhe pastaj me ato duar fërkoj vetëm nga një herë dy anët e fytyrës dhe duart.*

Fukahatë

Fukahatë kanë thënë: “Qëllimi me fytyrën, është një pjesë e fytyrës dhe jo e gjithë fytyra, sepse germa “b” në fjalën e Allahut të Lartësuar: “*يُجَاهِدُكُمْ فَأَسْحُوا*” - “**fërkoni fytyrat tuaja**”, nuk njofton tërësinë dhe është plotësisht si fjala e Tij: “*وَأَسْحُوا بُرُؤُسِكُمْ*” - “**jepuni mes’h kokave tuaja**” në raport me abdesin, sepse, sikur të mos tregonte disa, do të ishte shtesë. Mirëpo urdhri “jepni mes’h” është vetvetiu i numëruar, prandaj fukahatë kanë kufizuar pjesën e fytyrës që është farz t’i jepet mes’h në tejemum, duke filluar nga vendprerja e flokëve deri në anët e hundës nga lart, ku hyn balli dhe dy tëmthat.

Gjithashtu, fukahatë kanë thënë se qëllimi me dy duart është vetëm për dy shputat e duarve, sepse Allahu i Lartësuar në tejemun ka thënë duart dhe nuk i ka kushtëzuar me kufirin deri te dy bërrylat, ashtu siç urdhëroi për abdesin. Bazuar mbi fjalën e këtij ajeti, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i dha mes’h dy shputave dhe nuk shkoi më sipër, natyrisht, bazuar në komentin

dhe në shpjegimin e bërë për ajetin e nderuar. Ky fakt mbështetet plotësisht në rregullat e gramatikës së gjuhës arabe, siç është për shembull shprehja: “Atë punë e bëra me dy duart e mia.” Në këtë rast, me fjalën “dorë” kuptohet se punën e ka bërë vetëm shputa e dorës.

Në vijim, mënyra e bërjes tejemum te fukahatë është: Të mbështetësh mbi tokë dy shputat e duarve, të fërkosh fytyrën nga vendprerja e flokëve deri në majën e hundës nga sipër, pastaj i jep mes’h shpinës së dorës së djathtë me shputën e dorës së majtë dhe pastaj i jep mes’h shpinës së dorës së majtë me shputën e dorës së djathtë.

Pasi fukahatë ndanë një mendim të përbashkët për këtë çështje, ata shfaqën mendime të ndryshme, nëse në tejemumin është farz vetëm me një vënie e duarve mbi tokë, qoftë kur tejemumi është zëvendësues për abdesin, qoftë kur është zëvendësues për guslin prej xhunubllëkut, ose për guslin pas menstruacioneve, ose për guslin pas hemorragjisë së lindjes (*nifās*), ose për guslin për shkak të prekjes së të vdekurit, apo është farz të ketë një ndarje mes tejemumit që zëvendëson abdesin, farzi i të cilit kryhet vetëm me një prekje të tokës me duar dhe mes tejemumit që zëvendëson guslin, në të cilin është farz të vihen dy herë duart mbi tokë, njëra për t’i dhënë mes’h fytyrës dhe tjetra për t’i dhënë mes’h dy duarve.

Fukahatë, më të dëgjuar, kanë mbështetur mendimit e diferencimit, domethënë, mjafton vetëm një vënie e duarve mbi tokë për tejemumin që zëvendëson abdesin dhe dy vënie të duarve mbi tokë për tejemumin që zëvendëson guslin, çdo lloj gusli.

Pjesa më e madhe e studiuesve (muhak'kikùn) janë shprehur se nuk është detyrë që duart të vihen mbi tokë dy herë, në asnjë rast, pasi mjafton një vënie e vetme e duarve mbi tokë për çdo tejemum dhe është e barabartë, qoftë kur tejemumi është zëvendësues për abdesin, qoftë kur ai është zëvendësues për guslin. Ata e kanë argumentuar këtë thënie me veprimin e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili, kur bëri tejemum, i vuri duart mbi tokë vetëm një herë, atëherë kur shpjegoi të vërtetën e tejemumit dhe mënyrën si bëhet tejemumi, me qëllim që t'i mësonte njerëzit mënyrën farz të bërjes tejemum, qoftë kur tejemuni është zëvendësues i abdesit, qoftë kur ai është zëvendësues i guslit.

Nëse do të kishte ndonjë dallim në mënyrën e bërjes tejemum, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) patjetër që nuk do të kishte heshtur. Përfundimisht, lënia e diferencimit është argument për gjithëpërfshirjen. Veç kësaj, tejemumi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) e nxjerr në dritë më mirë faktin që tejemumi është zëvendësues edhe për guslin prej xhunubllëkut, pasi ai e demonstroi mënyrën e bërjes tejemum, kur pak më parë tregoi ngjarjen e Amarit që ishte xhunuyb.

Shejkh El Hamedanij, në librin “Misbàhul Fakijh”, thotë: “Mjaftimi vetëm me një vënie të duarve mbi tokë për tejemumin që është zëvendësues për guslin, është argument shumë i qartë dhe shumë i fortë, duke pasur në konsideratë njoftimet e shumta që tregojnë për vënien e duarve mbi tokë vetëm një herë. Përveç kësaj, të gjitha njoftimet që flasin për tejemumin e kanë vargun e transmetuesve të pashkëputur dhe të gjitha transmetimet kanë ardhur si përgjigje e pyetjes për mënyrën e bërjes tejemum në përgjithësi.”

Me këtë fakt bëhet e qartë se disa transmetime që flasin për dy vënie të duarve mbi tokë, në asnjë rast nuk shërbejnë për të kundërshtuar transmetimet që flasin për një vënie të vetme të duarve mbi tokë. Prandaj dilte detyrë që transmetimet që flasin për dy vënie të duarve mbi tokë, ose të injorohen, ose të mbarten në mënyrën *mustehab* të bërjes së tejemumit, sepse dihet se mbartja në mënyrën *mustehab* është e ngjashme me rregullat dhe është për rezervë.

Këtu kemi edhe një transmetim tjetër që tregon se është farz që duart të vihen mbi tokë tri herë: një herë për fytyrën, herën e dytë për shputën e dorës së djathtë dhe herën e tretë për shputën e dorës së majtë. Por duhet të theksohet se ky është transmetim jo i rregullt dhe për këtë shkak nuk veprohet sipas këtij transmetimi.

Kushtet e tejemumit dhe dispozitat e tij

1- Me fjalën e përbashkët të fukahave, tejemumi është i vlefshëm vetëm me nijet, sepse është prej adhurimeve dhe qëllimi është i mjaftueshëm për afrim te Allahu i Lartësuar, por nuk është detyrim bërja e nijetit, që të jetë e lejuar hyrja për të falur namaz farz, ose namaz të pëlqyeshëm (*mustehab*), as për heqjen e gjendjes pa abdes (*hadeth*) dhe as që tejemuni është zëvendësues i abdesit për faljen e namazit.

2- Njeriu e ka farz të fillojë bërjen tejemum vetë, sepse urdhri për këtë është i qartë dhe, kur thuhet bëje, do të thotë bëje ti vetë dhe jo një tjetër për ty, sepse, si bazë, është moslejimi i kryerjes së adhurimeve me përfaqësi. Megjithëkëtë, njeriu ka

detyrë të ndihmojë tjetrin në raste pamundësie e domosdoshmërie.

3- Është farz që tejemumi të behet njëherësh dhe veprimet të jenë njëri pas tjetrit, në mënyrë që dhënia mes`h shputës të dorës së djathtë të jetë menjëherë pas dhënies mes`h fytyrës dhe dhënia mes`h shputës së dorës së majtë të jetë pas dhënies mes`h dorës së djathtë, domethënë veprimet të jenë pa shkëputje, qoftë edhe atëherë kur tejemumi është zëvendësues për guslin, në të cilin (në gusël) lejohet ndarja e veprimeve. Argumenti për këtë çështje është fjala e përbashkët e fukahave.

4- Me vetëdashje, shputa e dorës që bën fërkimin të mos jetë e mbështjellë me copë, të mos ketë copë as mbi fytyrë e as mbi shpinën e duarve, sepse, duke qenë copa, nuk realizohet kuptimi i mes`hit për të cilin urdhëron Allahu në fjalën e Tij të nderuar:

“وَأَمْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ”

“...jepni mes`h fytyrave e duarve tuaja...”

Në qoftë se disa pjesë të trupit, mbi të cilat bëhet tejemumi janë të fashuara, është e mjaftueshme që mbi fashon të kalohet dora, pra, t`i jepet mes`h edhe fashos.

5- Është detyrë e domosdoshme pastrimi i gjymtyrëve të tejemumit, por jo se kjo është veprim i preferuar.

6- Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se tejemumi, para hyrjes së kohës për faljen e namazit, nuk është i vlefshëm, sepse tejemumi është i detyrueshëm vetëm atëherë kur koha është

tepër e ngushtë, domethënë, ka aq kohë vetëm sa për të bërë tejemum dhe për të arritur faljen e namazit në kohën e vet.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me faktin e faljes së namazit, kur koha mjafton për të bërë tejemum, për të falur namazin dhe përsëri mbetet një pjesë prej kësaj kohe. Në një gjendje të tillë, a duhet të shpejtojë njeriu apo jo për faljen e namazit?

Patjetër që ai duhet të shpejtojë, ashtu siç është transmetuar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në lidhje me një burrë, i cili bëri tejemum dhe fali namazin, por më pas ai gjeti ujë brenda kohës për faljen e namazit në fjalë. Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “*Namazi i tij është kryer.*” Nuk ka dyshim se namazi i atij njeriu është i vlefshëm dhe nuk është detyrë që ai të përsërisë faljen e namazit brenda kohës, edhe pse tani uji është i pranishëm. Ky është një argument i qartë për lejimin e shpejtit për të bërë tejemum, edhe kur koha është e mjaftueshme.

Gjithashtu, argumenti tregon se nuk është detyrim të pritet deri në fundin e kohës, madje edhe atëherë kur mund të mendohet se pengesa që justifikon bërjen tejemum, do të hiqet, pa qenë detyrë e domosdoshme të tregohet durim deri në çastin e fundit, me përjashtim të rastit kur dihet se eliminimi i shkakut që e bën farz tejemumin do të ndodhë patjetër.¹

7- Për atë që bën tejemun lejohet të falë disa namaze me një tejemum të vetëm. Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që me një tejemum të vetëm fal namazin e natës dhe

¹ Për atë që nuk gjen ujë ka tri situata: 1- E di se ka mundësi të gjejë ujë deri në fund të kohës së namazit. 2- E di se nuk ka mundësi të gjejë ujë. 3- Të ketë dyshim. Këtu nuk duhet të presë me përjashtim të situatës së parë.

të gjithë namazet e ditës, nëse lejohet një veprim i tillë. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i është përgjigjur: “Po.”

Fukahatë janë shprehur se ai që bën tejemum, është me abdes pas tejemumit, prandaj për atë janë të lejuara të gjitha punët që i lejohen atij që ka bërë pastrimin për faljen e namazit, për kryerjen e tavafit, për këndimin e ajeteve të Kur’anit, për prekjen e shkrimeve të Kur’anit, për prekjen e librit të Kur’anit. Atij i lejohen edhe veprime të tjera që i lejohen atij që ka bërë pastrimin me ujë. Në lidhje më këtë çështje, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Për ty është e mjaftueshme toka e pastër edhe për dhjetë vjet.” Ky veprim miratohet edhe nga fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Toka është njëra prej dy pastruesve dhe ajo është në pozitën e ujit.”

Nuk është e nevojshme sjellja e transmetimeve të tjera që tregojnë për gjithëpërfshirjen e pozitës së tokës si pastruese.

Fukahatë kanë përjashtuar prej këtij përgjithësimi vetëm atë që bën tejemum në vend që të marrë abdes për shkak të kohës tepër të ngushtë dhe pikërisht për shkak të kohës ai ka detyrim të domosdoshëm të bëjë tejemum për të kryer adhurimin e radhës, për të cilin koha nuk mjafton, derisa ai të marrë abdes, ose të bëjë gusël. Por, pasi ai e plotëson adhurimin, atëherë, si bazë, hiqet edhe objekti i detyrimit, që ishte marrja abdes. Në këtë rast, ai është në dispozitën e personit që nuk ka ujë, por më pas ai gjen ujë.

8- Në qoftë se ai bën tejemum për shkak se nuk ka ujë, por më vonë ai gjen ujë, për këtë gjendje ka disa çështje:

Çështja e parë: Në qoftë se ai gjen ujë, pasi bëri tejemum dhe para se të hyjë koha për faljen e namazit, tejemumi i tij është prishur vetvetiu, vetëm për faktin se u hoq justifikimi. Përveç

kësaj, tejemumi që ai bëri ishte një mjet për një qëllim, të cilin ai akoma nuk e ka kryer. Sikur të supozohet se ai e humbi ujin para namazit, megjithëse pati mundësi të kishte ujë, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai e përsërit tejemumin.

Çështja e dytë: Ai gjen ujë para se të përfundojë faljen e namazit. Ky njëri nuk e ka detyrim të përsërisë faljen e namazit, edhe atëherë kur ka kohë të mjaftueshme. Kjo miratohet edhe nga fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “*Namazi i tij është kryer.*” Madje ai nuk e ka detyrë të përsërisë namazin, edhe kur shikon ujë, pasi ka rënë në ruku. Padyshim, ai nuk e përsërit namazin kur ujin e gjen, pasi ka përfunduar faljen e namazit.

Çështja e tretë: Ai gjen ujë gjatë kohës që është duke falur namazin. Në këtë gjendje, fukahatë bëjnë dallim mes rastit kur e shikon ujin para se të bjerë në ruku, atëherë ai e le faljen e namazit, merr abdes dhe pastaj fal namazin dhe mes atij që e shikon ujin, pasi ka rënë në ruku, i cili, pavarësisht nga uji që pa, ka detyrë të vazhdojë faljen e namazit. Për këtë rast ai nuk ka asnjë detyrim të përsërisë namazin.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që nuk gjen ujë, prandaj ai bën tejemum dhe fal namazin, ndërkaq vjen shërbyesi dhe i thotë: “*Ja ku e ke ujin.*” Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Në qoftë se ai s’ka rënë në ruku, menjëherë të ndërpresë faljen e namazit dhe të marrë abdes. Por nëse ai ka rënë në ruku, atëherë le të vazhdojë faljen e namazit.*”

Meriton të theksohet se kjo dispozitë është e posaçme vetëm për namazin dhe nuk përfshin adhurimet e tjera, për kryerjen e të cilave është kusht të kryhen vetëm me pastrim me ujë. Nëse burri bën tejemum për shkak të mungesës së ujit dhe

fillon të kryejë tavafin, por më vonë ai gjen ujë, qoftë edhe nëse është në rrotullimin e fundit, tavafi i tij është i prishur dhe ai ka detyrim ta përsërisë pastrimin me ujë. E njëjta gjë është edhe kur i bën tejemum të vdekurit për shkak se nuk ka ujë për ta larë dhe me këtë pastrim me tejemum i fal edhe namazin e xhenazes. Por më pas, para varrimit gjendet uji, atëherë është farz që i vdekuri të lahet, të parfumohet dhe të falet namazi i xhenazes së tij. Sekretit qëndron në faktin se teksti që tregon për mos përsëritjen, është i posaçëm vetëm për namazin, prandaj nuk lejohet analogjia me adhurimet e tjera. Sipas mendimit të përbashkët të fukahave, kjo analogji është e pavlefshme.

9- Është pyetur Imam Kadhimi, djali i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): Tre vetë ishin në udhëtim, njëri prej tyre u bë xhunub, i dyti vdiq dhe i treti ishte pa abdes, ndërkaq hyri koha për faljen e namazit. Ata kishin ujë aq sa mjaftonte vetëm për njërin prej tyre. Cili do ta marrë këtë ujë? Si do të veprojnë ata? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “*Bën gusël ai që është xhunub, varroset i vdekuri me tejemum dhe bën tejemum ai që është pa abdes.*”

Veprohet sipas këtij transmetimi dhe kanë hequr dorë prej transmetimit tjetër që i jep përparësi larjes së të vdekurit, për shkak se ky transmetim është me përcjellës të gradës “*Daijf*”, si dhe për shkak se transmetimi ka shkëputje në vargun e përcjellësve. Në lidhje me këtë transmetim, autori i librit “*El Medarik*”, ka thënë: “*Ky transmetim nuk vlen, sepse bie në kundërshtim me tekstin që i jep përparësi përdorimit të ujit atij që është xhunub.*”

* * *

PËRMBAJTJA

FJALA E BOTUESIT.....	5
PARATHËNIE.....	8
UJËRAT.....	14
Uji në pëgjithësi (elmàul-mutlak):.....	14
Uji është i pastër dhe pastrues:.....	15
Uji i shtuar (elmàul-mudâf):.....	17
Ujë i pastërt por jopastrues (tàhirun gajru mutah'hirun):.....	17
Ndërmjet ujit të zakonshëm dhe ujit të shtuar:.....	18
Ujë i rrjedhshëm dhe ujë që nuk rrjedh:.....	20
Uji dhe kontakti me papastërtinë:.....	21
Uji i pakët në mes të rrjedhshmit e ujërëva të tjerë:.....	23
Uji i shiut:.....	24
Kontakti i papastërtisë me ujin e shtuar:.....	25
Pastrimi i ujërave të ndotur:.....	26
Për pastrimit e ujit të ndotur janë disa gjendje:.....	26
Dyshimi dhe ngurrimi:.....	28
Përgjasimi i ujit të pastërt me ujin e ndotur me papastrëti:.....	28
Shumimi:.....	29
Uji i përdorur për abdes e për gusl:.....	29
“Kurr’ rri” :.....	31
Dyshimi e ngurrimi:.....	32
LLOJET E PAPASTËRTIVE.....	35
Urina:.....	35

Feçet:.....	36
Shpendët:.....	36
Kafsha që han feçe dhe kafsha me të cilën njeriu ka kyer marrëdhënie.....	38
Sperma:.....	39
Sekrecioni uretral dhe sekrecioni prostatik:.....	39
Gjaku:.....	40
Në kafshët e therura:.....	41
Coftina:.....	42
Mullëza dhe qeska e miskut:.....	43
Dora e myslimanit:.....	44
Qelbi dhe të vjellat:.....	45
Qeni dhe derri:.....	46
Vera:.....	46
Rrushi kur valon:.....	47
Lëngu i elbit (el-fuk`kàu):.....	48
Djersa e njeriut xhynyb është prej gjërave haram:.....	49
Ithtarët e librit:.....	49
ÇESHTJE SPORADIKE.....	56
Mohuesi i domosdoshmërisë:.....	56
Fëmija i mohuesit:.....	56
Egzagjeruesi:.....	57
Shfaqësi i anmiqësisë:.....	57
Mbetja nga uji ku kanë pirë kafshët (es`suëru):.....	57
Dyshimi dhe ngurrimi:.....	58
DISPOZITAT E PAPASTËRTIVE.....	60
Rugët e vërtetimit të papastërtisë (nexhasetit):.....	60
Njoftimi i vetëm:.....	61
Bërësi i veprimit:.....	62
Papastërtia dhe e ndotura me papastërti:.....	62

Ç'farë i falet njeriut përkryerjen e namazit?.....	64
Papastërtitë me të cilat nuk mund të falet namaz:.....	65
Pastrimi i xhamive:.....	65
A bëhet i papastër sendi i ndotur me papastërti?.....	66
PASTËRTIA E TRUPIT DHE E RROBAVE PËR TË FALUR NAMAZ.....	69
Prej kushteve të namazit:.....	69
Falja namaz me papastërti pa e ditur:	70
I detyruari nga nevoja:.....	72
Përngjasimi i sendit të pastër me sendin e papastër:.....	73
A të eliminojë papastërtinë apo të marrë abdes:.....	74
PASTRUESËT.....	75
Uji:.....	75
Pastrimi prej qenit, derrit, miut dhe urinës:.....	76
Pastimi i enëve, rrobave dhe trupit:.....	77
Uji i shkëputur:.....	78
Qëndrimi në banjo:.....	78
Dheu:.....	80
Dielli:.....	80
Transformimi:.....	81
Shndrrimi:.....	81
Trupi i kafshës:.....	81
Regjja:.....	82
ABDESI.....	83
Shkaqet e abdesit:.....	84
Dyshimi e ngurrimi:.....	85
Qëllimet e abdesit:.....	85
Është veprim i preferimi për të qenë vazhdimisht me abdes....	88
Kushtet e abdesit dhe mënyra e marrjes abdes.....	90
Kushtet e abdesit:.....	90

Mënyra e marrjes abdes:.....	93
Një herë të vetme:.....	99
Ndërmjet shij`ave dhe Elhi Sun`netit:.....	102
Sun`netet e abdesit:.....	104
DISPOZITAT E ABDESIT.....	105
Rregulli i përfundimit dhe rregulli i shlyerjes:.....	105
Dyshimi dhe ngurrimi:.....	108
Dyshimi i shpeshtë:.....	111
FASHAT (el-xhebàir).....	112
Dyshimi në mbulesën:.....	117
Njeriu me probleme të urinimit dhe me probleme intensinale:..	118
Fukahatë:.....	119
LARJA PREJ XHYNIBLLËKUT.....	121
Xhynyblleku:.....	121
Fukahatë:.....	122
Forma:.....	123
Qëllimet guslit:.....	127
Agjërimi dhe xhynyblleku.....	127
Fukahatë:.....	128
Ç`është haram për njeriun xhynyb:.....	129
Fukahatë:.....	130
Degëzim mbi hyrjen në xhami:.....	131
Mënyra e bërjes gusl:.....	132
Fukahatë:.....	132
Sistemimi:.....	133
Zhytja në ujë:	135
Çeshtje:.....	135
MENSTRUACIONET (hajd), METRAROGJIA (isthàdah) DHE LEHONIA (nifàs).....	139
Fukahatë:.....	140

Fukahatë:.....	141
Pyetje-përgjigje:.....	142
Rregulli i mundësisë:.....	143
Llojet e menstruacioneve:.....	144
Fukahatë:.....	144
Tejkalimi i ditëve të zakonit:.....	146
Menstruacionet dhe gjaku:.....	147
Ato thonë të vërtetën:.....	147
Ç'është e ndaluar (haram) për gruan me menstruacione:.....	148
Gusli i gruas me menstruacione:.....	149
Kryerja e adhurime të prapambetura (kazà):.....	150
Metrarogjia (istihàdah):.....	150
Fukahatë:.....	151
Kategoritë e grave me metrarogji:	152
Lehonat:.....	155
Fukahatë:	155
I VDEKURI DHE PREKJA E TIJ.....	157
Vdekja:	157
Larja:.....	158
Dëshmori (esh'shehijdu) dhe i ekzekutuari me gjuajtje me gurë (el-merxhùmu):.....	162
Fukahatë:.....	162
Qefini:.....	163
Fukahatë:.....	164
Parfumimi (elhanùtu):.....	165
Fukahatë:.....	165
Namazi i xhenazes:.....	166
Fukahatë:.....	167
Mënyra e faljes së namazit të xhenazes:.....	168
Varrimi:.....	169

Fukahatë:.....	170
Të afërmit:.....	171
Fukahatë:.....	173
Prekja e të vdekurit:.....	175
Fukahatë:.....	176
GUSLET MUSTEHAB.....	177
TEJEM´MUMI.....	177
Fukahatë:.....	180
Mungesa e ujit:.....	181
Dëmtimi:.....	183
Ka pak ujë:.....	186
Koha e pakët:.....	187
Materialet me cilat tejem´mumi është i vlefshëm:.....	189
Fukahatë:.....	189
Mënyra e bërjes tejem´mum:.....	191
Fukahatë:.....	192
Kushtet e tejem´mumit dhe dispozitat e tij:.....	195

فقه الإمام جعفر الصادق عليه السلام

المؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء الاول

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

اسم الكتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء الاول

المؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

المشرف العام: شيخ وُلُنْتُ مِرْيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

المطبعة: انتشارات "البلو"

تيرانا: 2018